

ZGJIDHJA ALTERNATIVE E KONTESTEVE

Praktika dhe Qeverisja
për Shtetet



CLDP

COMMERCIAL LAW DEVELOPMENT PROGRAM

P Ë R M B A J T J A

KAPITULLI 1: Konteksti historik, përmbledhje e ZAK-së dhe çfarë ofron ky libër

5

Rëndësia e ZAK-së për palët private dhe publike dhe pse ka rëndësi	6
Zhvillimi i sistemeve të ZAK	8
Vështrim mbi Proceset e Zgjidhjes Alternative të Kontesteve	9
Veçoritë dhe përfitimet nga libri për përdoruesit dhe hisedarët kryesorë	13
Përbërja e kapitujve të librit	14
Burimet e dobishme	17

KAPITULLI 2: Hisedarët: Palët dhe Institucionet që Formësojnë ZAK-në

19

Palët në kontest	20
Palët e ndërlidhura	21
Ekspertët, Dëshmitarët, Miqtë (Amici)	22
Neutralet	23
Institucionet Ofruese të ZAK-së	24
Konsiderata të veçanta për shtetet në krijimin e kornizave të ZAK-së	26
Burimet e dobishme	32

KAPITULLI 3: Ndërmjetësimi

34

Përkufizimi i Ndërmjetëimit	35
Ndërmjetësimi nuk vendimmarrje në formë gjykimi	37
Procesi i Ndërmjetëimit	38
Akreditimi i ndërmjetësuesit	44
Vendet dhe kostot e ndërmjetëimit	46
Angazhimi i shteteve në ndërmjetësim	48
Ndërmjetësim për Kontestet e Investimeve	49
Burimet e dobishme	52

KAPITULLI 4: Përmbledhje e Arbitrazhit

54

Përkufizimi i Arbitrazhit	55
Burimet e dobishme	76

KAPITULLI 5: Procedura dhe Praktika e Arbitrazhit

79

Rolet praktike dhe fazat e hershme në arbitrazh	81
Procedura e Arbitrazhit	85
Burimet e dobishme	106

KAPITULLI 6: Procedurat pas vendimit, pas marrëveshjes

108

Hyrje	109
Kundërshtimi dhe anashkalimi	115
Zbatimi i marrëveshjeve të zgjidhura me ndërmjetësim:	
Konventa e Singaporit	121
Burimet e dobishme	125

KAPITULLI 7: Udhërrëfytyesi për hartimin e sistemeve efektive dhe efikase të ZAK-së

126

Hyrje	127
Forcimi i ekosistemeve të ndërmjetësimit	128
Fuqizimi i ekosistemeve të arbitrazhit	135
Burimet e dobishme	151

Përfundim

153

SHTOJCA A: Udhërrëfytyesi i CLDP-së për fuqizimin e mbështetjes gjyqësore për ZAK

156

SHTOJCA B: Udhërrëfytyesi i CLDP-së për projektimin e institucioneve efektive të pavarura të ZAK

159

Fjalorthi

164

Shkurtesat

176

Udhëzuesi për këtë libër

179

Rreth Autorëve

184

Ekipi i CLDP-së	185
Ekspertët Ndërkombëtarë	186

KAPITULLI 1: Konteksti historik, përmbledhje e ZAK-së dhe çfarë ofron ky libër

Rëndësia e ZAK-së për palët private dhe publike dhe pse ka rëndësi

Gjatë dekadës së fundit, bota është përballur dhe përshtatur ndaj ndryshimeve të konsiderueshme në dinamikën e tregtisë globale, duke përfshirë tronditjet gjeopolitike dhe ekonomike dhe një krizë globale shëndetësore. Në këtë mjedis, transaksionet, projektet dhe kontratat ndërkombëtare të biznesit janë rritur për nga numri dhe kompleksiteti, duke përfshirë sektorët shumë të rregulluar, siç janë energjia e ripërtërishme ose financat. Përfshirja e shteteve ose subjekteve shtetërore pashmangshëm implikon interesin publik dhe politikën publike të brendshme. Konflikti është një pasojë e natyrshme e këtyre ngjarjeve gjeopolitike dhe një veti e domosdoshme e çdo projekti njerëzor, qoftë në nivel individual, të korporatës apo shtetëror.

Cilido qoftë shkak, qoftë për bizneset, individët apo shtetet, kontestet pengojnë qëllimet dhe rritjen e shumicës së palëve në kontest, duke e bërë zgjidhjen efikase dhe efektive të kontesteve veçanërisht të rëndësishme. Në tregtinë ndërkombëtare, investitorët, kompanitë ose subjektet e ngjashme kërkojnë sa më shumë stabilitet të jetë e mundur për investimet e tyre. Shtetet, nga ana tjetër, konkurrojnë për investime nën kushte të rrepta, duke balancuar qëllimet e tyre rregullatore, presionet politike dhe detyrimet e brendshme dhe ndërkombëtare. Marrëdhëniet që lindin në mes të akterëve, politikave dhe interesave të shumta zakonisht testohen kur zbatimi i një kontratë ose projekti përballlet me një sfidë që rezulton në shkelje të të drejtave, dëme monetare ose dëme të tjera për njërën palë në transaksion.

Sfidues është përcaktimi i mënyrës së zgjidhjes së kontesteve pasi ato kanë lindur. Për shumicën, rrugëdalje e vetme është gjyqësori vendor. Sistemi gjyqësor, edhe pse ka personelin profesional i cili zbaton autoritin shtetëror, shpesh nuk është ideal për kontestet që kërkojnë zgjidhje të shpejtë dhe përfundimtare. Fokusi i tyre në gjetjen e fakteve dhe rregullat procedurale shpesh favorizon një hetim të hollësishëm kundrejt zgjidhjes së shpejtë. Për shumtën e transaksioneve biznesi, konflikti rezultues i nënshtrohen klauzolës së zgjidhjes së kontesteve të specifikuara në fillim të përfshirjes. Me kalimin e kohës, mekanizmat e zgjidhjes alternative të kontesteve (ZAK), më të njohur arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, kanë provuar

të jenë zgjedhjet e preferuara për bizneset ndërkombëtare, investitorët dhe shtetet që veprojnë si palë tregtare në tregti dhe zhvillim.

Palët e sofistikuar që parashikojnë konflikte të ardhshme, përfshijnë klauzola të ZAK-së në kontratat ose instrumentet e tyre ligjore ndërkombëtare, duke caktuar forumin e dëshiruar të palëve për zgjidhjen e kontesteve. Bizneset dhe investitorët e huaj që kërkojnë të mbrojnë interesat e tyre tregtare dhe ligjore kanë gjetur ngushëllim në standardet ndërkombëtare të njohura dhe të parashikueshme të zgjidhjes së kontesteve. Këto standarde shërbejnë si mbrojtje kundër padrejtësisë së perceptuar në proceset e brendshme gjyqësore ("avantazhit të gjykatës së vendit"), vonesave të zakonshme në gjykatat e mbingarkuara me çështje dhe një mosnjohjeje të përgjithshme të specifikave të sistemit ligjor të brendshëm. Në mesin e mekanizmave të ndryshëm të zgjidhjes së kontesteve që palët publike dhe private mund të zgjedhin në kontratat dhe traktatet e tyre, arbitrazhi ndërkombëtar është shfaqur si një forum i preferuar sepse është një alternativë me kosto efektive dhe efikase kundër procesit gjyqësor. Përveç fleksibilitetit në hartimin e rregullave dhe procedurave arbitrare, arbitrazhi ndërkombëtar u ofron palëve gjithashtu mundësinë për të rënë dakord për konfidencialitetin e procedurave, për të zgjedhur arbitra neutralë me ekspertizë në lëndën e arbitrazhit, si dhe mundësinë për një vendim përfundimtar dhe të zbatueshëm ndërkombëtarisht.

Në vazhden e rritjes së kostove dhe kompleksitetit të praktikës moderne të arbitrazhit, si palët private ashtu edhe shtetet po përdorin gjithnjë e më shumë ndërmjetësimin për të njëjtat avantazhe që arbitrazhi ofronte fillimisht: kontroll mbi palët, efektivitet të koston dhe efikasitet. Ndërmjetësimi ka gjetur përdorim të ri në sferat vendore, tregtare dhe ndërkombëtare. Gjatë 50 viteve të fundit, gjyqësorët vendas në të gjithë botën kanë provuar dhe testuar regjimet e ndërmjetësimit për një gamë të gjerë kontestesh (nga kontestet për tokën dhe ato familjare e deri te çështjet penale dhe tregtare të mëdha) për të rritur qasjen në drejtësi në sistemet gjyqësore të kufizuara dhe të mbingarkuara. Palët tregtare kanë përfshirë gjithnjë e më shumë klauzolat e ndërmjetësimit dhe të arbitrazhit ndërmjetësues në kontratat e tyre si praktika standarde. Po ashtu, siç diskutohet më vonë në këtë libër, shtetet e kanë përdorur gjithnjë e më shumë ndërmjetësimin për të zgjedhur kontestet, si vendore ashtu edhe ndërkombëtare. Pavarësisht këtyre sukseseve të fundit, proceset e bazuara në negociatë, si ndërmjetësimi, nuk janë universalisht të përshtatshme dhe,

siç diskutohet më poshtë, paraqesin sfida unike, të tilla si agjencia e palës dhe qëndrueshmëria e ndryshueshme e një marrëveshjeje të negociuar.

Zhvillimi i sistemeve të ZAK

Një sistem i qëndrueshëm për zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare varet nga një themel ligjor dhe institucional që zbaton me besueshmëri të drejtat dhe detyrimet përtej kufinjëve. Në dekadat e fundit, shtetet janë përballur me kufizimet e modeleve kundërshtarë dhe gjyqësore dhe kanë njohur nevojën për mekanizma që u japin palëve kontroll më të madh mbi procesin dhe rezultatin. Zgjerimi i metodave të disponueshme për të përfshirë proceset e bazuara në negociata, siç është ndërmjetësimi, u mundëson shteteve, bizneseve dhe palëve të interesuara publike të menaxhojnë konfliktin në mënyrë më efektive.

Për shumë shtete, përmirësimet në sistemin e ZAK-së mbështesin qëllimet e dyfishta të (1) rritjes së investimeve të huaja përmes uljes së rrezikut të proceseve gjyqësore dhe sqarimit të pritjeve tregtare dhe (2) përmirësimit të aftësisë së të gjithë përdoruesve për të përfituar nga shërbimet e zgjidhjes së kontesteve përmes rritjes së opsioneve për ndërmjetësim dhe arbitrazh dhe uljes së ngarkesës gjyqësore. Shumica e shteteve janë gjithashtu të vetëdijshme për rolin e tyre në ZAK, qoftë përmes mekanizmave vendas apo sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.

ZAK ka rezultuar gjithashtu i dobishëm për kontestet ndërkufitare të investimeve, ku investitorët paraqesin padi drejtpërdrejt kundër shteteve nikoqire për shkelje të kontratave investitor-shtet ose dispozitave të së drejtës ndërkombëtare të investimeve të përfshira në traktatet ndërkombëtare të investimeve (qofshin dypalëshe apo shumëpalëshe). Këto traktate ofrojnë mekanizma të ndryshëm për zgjidhjen e kontesteve investitor-shtet (ISDS). Arbitrazhi ndërkombëtar është vendi më i përdorur i ISDS-së, por përdorimi i ndërmjetësimit në një kontekst të tillë është në rritje. Pajtimi është gjithashtu një drejtim i zbatueshëm dhe i përdorur shpesh nga ISDS. Për shumë vite, këto instrumente tërhoqën pak padi, por rritja dramatike e kontesteve sipas këtyre marrëveshjeve i ka ekspozuar shtetet ndaj rreziqeve të konsiderueshme financiare, rregullatore dhe politike. Çmimet me vlerë të lartë, kostot në rritje dhe procedurat e zgjatura kanë nxitur një rivlerësim të ekuilibrit të sistemit. Ky libër e merr parasysh këtë diskurs, por në vend të kësaj përqendrohet në mundësitë

për efikasitet procedural përmes pjesëmarrjes më të informuar të shtetit në arbitrazh dhe ndërmjetësim.

Vështrim mbi Proceset e Zgjidhjes Alternative të Kontesteve




Fig 1.1: Procesi i Zgjidhjes Alternative të Kontesteve

Zgjidhja Alternative e Kontesteve (ZAK) i referohet një game të gjerë mekanizmesh dhe teknikash të përdorura për të zgjidhur kontestet pa u përfshirë në procedura gjyqësore. Karakteristika përcaktuese e ZAK-së është se ajo ekziston jashtë proceseve gjyqësore tradicionale. ZAK-ja mund të marrë forma të shumëfishta — secila e aftë të funksionojë në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me të tjerat.

Pëlqimi i palës është një karakteristikë përcaktuese e ZAK-së. Shprehet para se të lindë një kontest në një klauzolë për zgjidhjen e kontesteve (p.sh. përmes një kontrate, traktati, legjislacioni ose autorizimi investimi), ose pasi të lindë një kontest, si p.sh. përmes një marrëveshjeje të veçantë (*kompromis* ose marrëveshje me parashtresa). Shumë forma të ZAK-së mbështeten institucionalisht, me rregulla dhe procedura të dedikuara, si dhe disa përdoren në sektorë specifikë si ndërtimi, investimet e huaja direkte, sigurimet ose industria financiare. Përveç pëlqimit të individit ose të një subjekti të korporatës, shtetet sovranë mund të pajtohen gjithashtu të zgjidhin kontestet me investitorët nga një vend i huaj përmes një marrëveshjeje qeveri-me-qeveri, zakonisht një traktat dypalësh investimi.

Ky libër do të përqendrohet kryesisht në ndërmjetësim dhe arbitrazh, me referim në proceset tjera. Më poshtë përmbledhen proceset e negociatave, ndërmjetësimi, arbitrazhi dhe ato hibride, të cilat përfshijnë që të trija:

Negociimi

Negociatat janë diskutime të drejtpërdrejta në mes të palëve, pa përfshirjen e një pale të tretë. Ato ofrojnë një mënyrë fleksibile për zgjidhjen e kontesteve, me çdo strukturë që palët mund të imponojnë, ose pa një strukturë formale. Negociatat synojnë të prodhojnë një zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët dhe, në varësi të palëve dhe natyrës së kontestit, marrëveshjet e negociuara mund të materializohen ose jo në një marrëveshje të detyrueshme dhe të zbatueshme në mes të palëve. Negociatat janë përgjithësisht të përshtatshme për të gjitha llojet e kontesteve dhe shpesh konsiderohen si "vija e parë e mbrojtjes". Nëse nuk arrihet një marrëveshje domethënëse përmes negociatave, palët mund të pajtohen ta zgjidhin kontestin e tyre përmes mjeteve të tjera, siç janë ndërmjetësimi ose arbitrazhi.

Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi është një metodë për zgjidhjen e kontesteve me ndihmën e një pale të tretë neutrale e cila i ndihmon palët në kontest të arrijnë një zgjidhje të pranueshme reciprokisht. Ashtu si në negociata, edhe në ndërmjetësim, detajet e çdo zgjidhjeje përcaktohen nga vetë palët. Procesi i ndërmjetësimit shumë lehtë përshtatet me nevojat e palëve ose me përmbajtjen e kontestit. E përbashkët për të gjitha ndërmjetësimet është një formë konfidencialiteti, e cila garanton që palët mund të ndajnë atë që është thelbësore pa frikën se zbulime të tilla do t'i dëmtojnë ato nëse çështja nuk zgjidhet. Në varësi të forumit, marrëveshjet e ndërmjetësuar për zgjidhjen e kontesteve mund të mos jenë detyruese, përveç nëse shndërrohen në kontratë ose janë të zbatueshme sipas instrumenteve si Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare të Zgjidhjes që Rezultojnë nga Ndërmjetësimi (Konventa e Singaporit mbi Ndërmjetësimin), në të cilin rast zgjidhjet mund të zbatohen në forume lokale të ngjashme me vendimet e arbitrazhit.

Arbitrazhi

Arbitrazhi është një metodë private e zgjidhjes së kontesteve ku palët pajtohen t'ia paraqesin kontestet e tyre një gjykate private në vend të një gjykate kombëtare. Ndryshe nga ndërmjetësimi dhe pajtimi, ku një palë e tretë neutrale i ndihmon palët të arrijnë një zgjidhje të pajtuar reciprokisht, një gjykatë jep një vendim përfundimtar dhe detyrues që është i zbatueshëm ndërkombëtarisht. Arbitrazhi shërben si një alternativë neutrale ndaj gjyqimeve kombëtare dhe mund të përshtatet sipas nevojave të palëve dhe fushëveprimit dhe natyrës së kontests.

Proceset Hibride

Palët mund të pajtohen për procese hibride që përfshijnë ndërmjetësim dhe arbitrazh, të tilla si “Med-Arb” dhe “Arb-Med”. Në Med-Arb, palët kërkojnë ta zgjidhin kontestin e tyre përmes ndërmjetësimit. Nëse nuk kanë sukses, palët e zgjidhin kontestin e tyre me arbitrazh duke përdorur të njëjtin arbitër neutral ose një arbitër tjetër, duke rezultuar në një vendim detyrues. Në Arb-Med, një arbitër bën një vendim të ciin e vulos dhe mbyll në zarf dhe më pas kryen ndërmjetësim. Nëse ndërmjetësimi nuk ka sukses, vendimit i hiqet vula dhe hapet, duke rezultuar në një vendim të detyrueshëm. Disa palë gjithashtu mund të negociojnë ose ndërmjetësojnë gjatë një arbitrazhi në pritje, të arrijnë një zgjidhje, si dhe më pas t'i kërkojnë arbitrit të kodifikojë kushtet e marrëveshjes së negociuar në një vendim pëlqimi.

Fig 1.2: Përmbledhje e proceseve të zakonshme të ZAK-së

Më poshtë është përmbledhja e pajtimit, bordet e kontesteve, vlerësimi neutral dhe përcaktimi i ekspertëve, të cilat përdoren më rrallë ose anë specifike për industri të veçanta.

Pajtimi

Pajtimi është një metodë e specializuar për zgjidhjen e kontesteve përmes emërimit të një ose më shumë pajtuesve të cilët ofrojnë një shqyrtim të paanshëm të kontestit, përpiqen të përcaktojnë kushtet e një zgjidhjeje të pranueshme nga të dyja palët dhe u ofrojnë palëve çdo ndihmë tjetër të nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje. Është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e kontesteve investitor-shtet, dhe ofron një deklaratë autoritare, por jo detyruese, të meritave pa një vendim arbitrazhi detyrues.

Bordet e kontesteve

Palët mund të krijojnë borde të kontesteve (ose borde të përhershme të emëruara në fillim të një projekti ose borde ad-hoc të emëruara kur lind një kontest) për të nxjerrë vendime këshilluese ose detyruese mbi çështje teknike ose kontraktuale. Siç është e zakonshme në kontratat standarde të industrisë së ndërtimit (siç është FIDIC), bordet e kontesteve kanë synim të parandalojnë përshkallëzimin e kontesteve dhe vonesat e panevojshme, veçanërisht në projektet e mëdha ndërkombëtare të ndërtimit.

Vlerësimi neutral

Vlerësimi neutral është diagnostikues dhe këshillues më tepër sesa përcaktues. Një person neutral, shpesh me përvojë ligjore, rregullatore ose në zgjidhjen e kontesteve, vlerëson pikat e forta dhe të dobëta të rasteve përkatëse dhe parashikon rezultatet e mundshme nëse gjykohe. Vlerësimi nuk është detyrues. Vlerësimi neutral synon të krijojë një bazë të testuar nga realiteti për diskutimet e zgjidhjes, duke përfshirë edhe largimin e besimit të tepërt në lidhje me pozicionin ligjor të dikujt. Vlerësimi neutral ndihmon në shmangien dhe parandalimin e kontesteve, të cilat mund të jenë po aq të rëndësishme në një objektiv qeverisjeje sa zgjidhja e kontesteve pasi ato të kenë lindur.

Përcaktimi i ekspertit

Palët në kontest mund të pajtohen të emërojnë një ekspert të pavarur për të dhënë një mendim detyrues ose jo detyrues, ose për të zgjidhur një kontest që kërkon ekspertizë të specializuar ose teknike. Përcaktimet e ekspertëve janë veçanërisht të zakonshme në kontestet në lidhje me ndërtimin, energjinë dhe licencimet ndërkombëtare të pronave, edhe pse ato mund të përdoren më gjerësisht.

Fig. 1.3: Përmbledhje e proceseve shtesë të ZAK-së

Mekanizmat e ndryshëm të ZAK-së të përshkruar më sipër ofrojnë kritere dalluese në mënyrë që metoda më e përshtatshme, ose kombinimi i metodave, të mund të zbatohet në situatën specifike të një pale.

Disa klauzola për zgjidhjen e kontesteve ofrojnë një menu opsionesh, duke u lejuar palëve të zgjedhin në mes të mekanizmave ose forumeve të ZAK-së, si ndërmjetësimi, negociimi ose arbitrazhi. Klauzolat për zgjidhjen e kontesteve mund të jenë shumështresore (shpesh të quajtura klauzola përshkallëzimi), duke u lejuar ose duke kërkuar palëve të fillojnë me një proces jo-detyrues, konsensual (siç janë negociatat ose ndërmjetësimi) dhe më pas të vazhdojnë me mekanizmat detyrues të zgjidhjes së kontesteve (siç është arbitrazhi). Klauzolat shumështresore mund të jenë opsionale ose të detyrueshme. Nëse është opsionale, palët në kontest fillimisht *mund* të përpiqen të negociojnë ose të ndërmjetësojnë një kontest. Nëse është e detyrueshme, palët së pari *duhet* të provojnë këto proceseve përpara se të kenë autorizime për të paraqitur kërkesë për arbitrazh.

Në fakt, koha për të marrë në konsideratë parandalimin e kontesteve dhe zgjidhjen miqësore shtrihet shumë përtej dritares së ngushtë që i paraprin menjëherë arbitrazhit aktual. Në vend të kësaj, palët në kontest mund të aplikojnë metoda të agjile dhe rezponzive të ZAK-së për të zbutur kontestin, për të ruajtur marrëdhënien e palëve dhe për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Përtej zgjidhjes së kontestit në fjalë, mekanizmat e hershëm të koordinimit dhe reagimit mund të parandalojnë tërheqjen ose anulimin e projekteve ose investimeve në pritje dhe të planifikuara që përndryshe do të ishin të dobishme për palët ose shoqërinë në përgjithësi.

Veçoritë dhe përfitimet nga libri për përdoruesit dhe hisedarët kryesorë

Ky udhëzues, *Zgjidhja Alternative e Kontesteve: Praktika dhe Qeverisja për Shtetet*, ofron një kornizë të zgjidhjeve të përshtatura, të gjithanshme dhe të besueshme si për palët publike ashtu edhe për ato private në transaksionet ndërkufitare. Libri thekson veçoritë ligjore, procedurale dhe institucionale të arbitrazhit dhe ndërmjetësimit si mjete për mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave dhe interesave. Gjithashtu, ofron njohuri të vlefshme nga ekspertë mbi praktikat dhe modelet më të mira ekzistuese në mbarë botën, së bashku me rreziqet dhe metodat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e tyre. Më konkretisht, libri ofron një përmbledhje të detajuar të arbitrazhit dhe ndërmjetësimit — metodat më të spikatura të ZAK-së në kontestet tregtare dhe të investimeve — së bashku me referenca për mekanizma të tjerë të zgjidhjes së kontesteve dhe kornizat e tyre përkatëse. Është një burim i kohës aktuale, i prodhuar në prag të një dekade reformash ndërkombëtare dhe rajonale që do të përcaktojnë të drejtën dhe praktikën e ZAK-së në vitet që vijnë.

I hartuar nga ekspertë dhe praktikues me prejardhje të ndryshme ligjore dhe profesionale, ky libër ofron informata të qarta dhe të dobishme që do të jenë veçanërisht të vlefshme për rritjen e mirëkuptimit në mes të palëve publike dhe private në marrëdhëniet dhe kontestet tregtare dhe të investimeve. Si bizneset ashtu edhe qeveritë mund të përdorin njohuritë e dobishme në këtë libër për të frymëzuar ndryshime në politika që përqafojnë mekanizmat e ZAK-së dhe nxisin rritjen e qëndrueshme ekonomike.

Ky burim do të kontribuojë në balancimin gradual të pozicionit të palëve publike dhe private në ZAK. Kapitujt mbi ndërmjetësimin (*KAPITULLI 3: Ndërmjetësimi*) dhe arbitrazhin (*KAPITULLI 4: Përmbledhje e Arbitrazhit; KAPITULLI 5: Procedura dhe Praktika e Arbitrazhit*) ofrojnë një bazë të përbashkët për hisedarët kryesorë, duke i tejkaluar boshllëqet e informatave që shpesh pengojnë aftësinë dhe gatishmërinë e palëve në kontest për të eksploruar dhe angazhuar në ZAK për të zgjidhur kontestet e tyre. Libri mund t'u sjellë dobi si bizneseve ashtu edhe institucioneve qeveritare duke ofruar gurëthemel për planifikimin e tyre strategjik, duke i ndihmuar qeveritë të hartojnë dhe zbatojnë korniza ligjore moderne dhe të përgjegjshme për tregtinë dhe investimet, si dhe duke i bërë subjektet

e biznesit më të njohura dhe më të rehatshme me rastin e hyrjes në tregje të reja dhe ato në zhvillim. Analiza e thellë dhe gjithëpërfshirëse në libër do të shikoj rrafshin e kornizave ligjore dhe institucionale për ZAK-në, do të hartëzojë hisedarët kryesorë, do të vlerësojë fushëveprimin dhe cilësinë e modeleve të mundshme, si dhe do të mbështetet në përvojat e shteteve nga prejardhje të ndryshme rajonale dhe ekonomike. Do të mbështesë institucionet qeveritare dhe këshilltarët ligjorë që marrin pjesë në ZAK, të cilët do t'i zbatojnë modelët në praktikë.

Për shtetet, në veçanti, njohuritë dhe burimet e paraqitura në libër duhet të informojnë dhe rrisin aftësinë e tyre për të përfshirë ZAK-në në regjimet e brendshme dhe për të marrë pjesë në një mënyrë të informuar. Libri ofron një bazë për përmirësimin gradual të praktikave të qeverisjes së mirë, duke frymëzuar rritjen e koordinimit ndërmjet agjencive dhe komunikimin e hapur me bizneset dhe investitorët e huaj.

Organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë zhvillimore që punojnë në reformën ligjore dhe nismat për sundimin e ligjit mund ta përdorin librin si bazë për të zhvilluar kurrikula dhe programe për asistencë teknike dhe aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve. Një program i tillë mund të ofrohet bashkërisht ose të përshtatet veçmas për komunitetin e biznesit dhe sektorin publik, duke marr parasysh nevojat dhe prioritetet në secilin sektor ose juridiksion.

Libri nuk mbështet ndonjë qasje apo model të veçantë për zgjidhjen e kontesteve. Në vend të kësaj, avancon një sërë të gurthemeleve dhe konsideratave sistematike për ZAK-në që mund të udhëheqin krijimin e politikave dhe hartimin e klauzolave të ardhshme për zgjidhjen e kontesteve për kontestet tregtare dhe të investimeve (si substanciale ashtu edhe procedurale). Nuk synon të shërbejë si burim analizash teorike ose akademike, por përkundrazi ofron një pasqyrë të nivelit të lartë të elementeve kritike të politikave dhe atyre praktike, me referenca në burime primare dhe komente që ofrojnë analizë të thellë të secilës temë. Do të jetë i dobishëm për një spektër të gjerë përdoruesish.

Përbërja e kapitujve të librit

Çdo kapitull do të trajtojë temën përkatëse, duke paraqitur përgjigje dhe zgjidhje për shqetësimet e identifikuara nga hisedarët kryesorë. Kapitujt do të ofrojnë analiza nga ekspertë të kornizave ekzistuese ligjore dhe

institucionale, së bashku me perspektiva mbi zhvillimet dhe përmirësimet e mundshme në të ardhmen. Si të tilla, ato mund të ndihmojnë në frymëzimin dhe mbështetjen e reformave të synuara në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, siç trajtohen nga përdoruesit e librit.

- ➔ Kapitulli 2 thekson individët dhe institucionet kryesore të përfshira në ndërmjetësim dhe arbitrazh (drejtpërdrejt ose tërthorazi), kornizat e ndryshme brenda të cilave ata bashkëveprojnë reciprokisht, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse.
- ➔ Kapitulli 3 ofron një pasqyrë të plotë mbi qëllimin, parimet dhe praktikën e ndërmjetësimit si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve, që dallon nga arbitrazhi ose procesi gjyqësor.
- ➔ Kapitulli 4 trajton arbitrazhin ndërkombëtar, duke u përqendruar në dallimin në mes të arbitrazhit tregtar dhe atij të investimeve, instrumentet kryesore të pëlqimit për arbitrazhin ndërkombëtar dhe kornizën ligjore ndërkombëtare.
- ➔ Kapitulli 5 mbulon procedurën dhe praktikën e arbitrazhit. Në të diskutohen mjetet, arritjet kryesore dhe procedurat e menaxhimit të rasteve, së bashku me metodat e testuara për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin procedural.
- ➔ Kapitulli 6 trajton procedurat pas dhënies së kontratës dhe pas marrëveshjes. Ofron një analizë kyçe të mekanizmave ligjorë dhe proceduralë për njohjen dhe zbatimin e aktvendimeve dhe vendimeve ndërkombëtare që rrjedhin nga procedurat e ZAK-së.
- ➔ Kapitulli 7 ofron udhërrëfyesin e CLDP-së për hartimin dhe zbatimin e sistemeve efektive dhe efikase të ZAK-së, duke vënë në pah se ndërtimi i një sistemi efektiv të ZAK-së nuk është rezultat i një reforme të vetme, por i ndikimit kumulativ të veprimeve të koordinuara në të gjitha fushat ligjore, gjyqësore, institucionale, arsimore dhe kulturore.

Libri është parashikuar si një burim i qasshëm dhe miqësor për përdoruesit për hisedarët, duke shërbyer si pikë referimi për ZAK në kontestet tregtare dhe të investimeve. Si i tillë, nuk hynë më thellë në detajet historike të temave që trajton, por ofron një mori referencash, burimesh dhe vegëzash të vlefshme që i çojnë lexuesit te burime parësore dhe dytësore që i janë kushtuar tashmë një analize të tillë.

Në aspektin afatgjatë, libri duhet t'i ndihmojë përdoruesit e tij të krijojnë një kornizë të fuqishme dhe të adaptueshme të ZAK-së, i cili do të jetë i qëndrueshëm ndaj dinamikave të paparashikueshme të natyrshme në tregtinë ndërkombëtare, investimet dhe gjeopolitikën.

Burimet e dobishme

Konventat, ligjet model dhe rregullat kryesore

- Konventa mbi Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (1958): <https://www.newyorkconvention.org/english>
- Konventa mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare të Zgjidhjes që Rezultojnë nga Ndërmjetësimi (2018): https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/EN/Texts/UNCITRAL/Arbitration/mediation_convention_v1900316_eng.pdf
- Ligji Model mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar (1985) me ndryshimet e miratuara në vitin 2006: https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/19-09955_e_ebook.pdf
- Ligj Model mbi Ndërmjetësimin Ndërkombëtar Tregtar dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare të Zgjidhjes që Rezultojnë nga Ndërmjetësimi (2018): https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/22-01363_mediation_guide_e_ebook_rev.pdf
- Rregullat e Bordit të Kontesteve të ONT-së (2015): <https://iccwbo.org/dispute-resolution/dispute-resolution-services/ZAK/dispute-boards/dispute-board-rules/>
- Konventa mbi Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve në mes të Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera (1965): <https://treaties.un.org/pages/showDetails.aspx?objid=080000028012a925>
- UNCITRAL, Rregullat e Arbitrazhit (siç janë miratuar në vitin 2013, me rishikimet e vitit 2021): <https://uncitral.un.org/en/texts/arbitration/contractualtexts/arbitration>

Udhëzimet dhe komentet

- Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, A/RES/53/101, Parimet dhe udhëzimet për negociatat ndërkombëtare (1999): <https://digitallibrary.un.org/record/265687?ln=en&v=pdf>
- Përmbledhje e Pajtitimit sipas Konventës ICSID (2022): <https://icsid.worldbank.org/procedures/conciliation/convention/overview/2022>

- ➔ Enciklopedia Max Planck e së Drejtës Ndërkombëtare Publike, Kari Hakapää, Negocimi: <https://opil.ouplaw.com/abstract/10.1093/law:epil/9780199231690/law-9780199231690-e67>
- ➔ Enciklopedia Max Planck e së Drejtës Ndërkombëtare Publike, Jean-Pierre Cot, Pajtimi (2006): <https://opil.ouplaw.com/display/10.1093/law:epil/9780199231690/law-9780199231690-e20?prd=EPIL>

KAPITULLI 2: Hisedarët: Palët dhe Institucionet që Formësojnë ZAK-në

Kapitulli vijues nxjerr në pah individët dhe institucionet kryesore të përfshira në ndërmjetësim dhe arbitrazh (drejtpërdrejt ose tërthorazi); kornizat e ndryshme brenda të cilave ata bashkëveprojnë ndërmjet vete; dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse. Parashikueshmëria dhe qartësia në rolet e akterëve i ngrit proceset e ZAK-së në përgjithësi dhe është po aq e rëndësishme për vetë akterët, pasi i ndihmon ata të krijojnë pritje të arsyeshme në lidhje me akterët e tjerë në ZAK.

Palët në kontest

Akterët kryesorë në procesin e ZAK-së janë palët e përfshira drejtpërdrejt në kontest. Palët në kontest e drejtojnë procesin, i përcaktojnë pretendimet, zgjedhin forumin, paraqesin provat dhe në fund të fundit mbajnë pasojat ligjore dhe financiare të vendimit. Kontestet mund të lindin në mes të palëve private, në mes të palëve private dhe të shtetit, si dhe ndonjëherë, në mes të shteteve.

Privat-privat

Kontestet private përbëjnë shumicën e rasteve në mbarë botën, duke përfshirë edhe në ZAK ndërkombëtar, veçanërisht në arbitrazhin dhe ndërmjetësimin tregtar (shih Kapitujt 3, 4 dhe 5). Në kontest komplekse, kompanitë zakonisht angazhojnë avokatë të korporatave ose praktikues të specializuar në arbitrazh të cilët i kuptojnë çështjet specifike të industrisë.

Publik-publik

Në kontestet që përfshijnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të shteteve sovraane, ose që lidhen me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjeve të tyre, institucionet kompetente angazhohen në zgjidhjen e kontesteve në mes të njëra-tjetrës. Palët në kontest përfaqësohen kryesisht nga avokatë ose zyrtarë të lartë qeveritarë me ekspertizë të madhe në interpretimin e traktateve dhe të drejtën ndërkombëtare publike. Pjesëmarrja e tyre formësohet nga kufizimet kushtetuese, detyrimet për transparencë dhe nevoja për të balancuar konsideratat e komitetit ndërkombëtar me strategjinë ligjore. Ndryshe nga ZAK në sferën tregtare, procedura në këto konteste ndikohet gjithashtu nga protokollet dhe konsideratat diplomatike.

Publik-privat

Publik-Privat: Kontestet në mes të palëve private dhe të shtetit përbëjnë kategorinë e dytë më të përhapur të kontesteve. Historikisht të zgjidhura në mjedisë gjyqësore, shtetet i janë drejtuar gjithnjë e më shumë ZAK-së për të zgjidhur kontestet me palët private, duke përfshirë ato në sektorët e punësimit, mjedisor, investimeve dhe madje edhe prenale. Arbitrazhi dhe ndërmjetësimi në investime janë metodat më të zakonshme të ZAK-së që aplikohen për zgjidhjen e kontesteve investitor-shtet (shih Kapitullin 4). Këto konteste përfshijnë investitorë të mbrojtur nga traktate ose kontrata ndërkombëtare investimi, të cilat u lejojnë atyre të padisin drejtpërdrejt shtetin nikoqir për shkelje të të drejtave të tyre të garantuara. Ndryshe nga kontratat tregtare ku të dyja palët nënshkruajnë një klauzolë së bashku, në ISDS, shteti shpesh jep "pëlqimin e përhershëm" përmes një traktati. Pëlqimi bëhet i plotëfuqishëm vetëm kur investitori e pranon këtë ofertë të njëanshme duke paraqitur një njoftim/kërkesë për arbitrazh. Shtetet zakonisht përfaqësohen nga këshilltarë juridik qeveritarë dhe/ose firma ligjore ndërkombëtare, ndërsa subjektet private mbështeten në këshilltarë juridik të brendshëm dhe/ose firma ligjore të jashtme.

Fig 2.1: Bashkimet e kontesteve potenciale

Palët e ndërlidhura

Përveç palëve në kontest, të cilat kanë interesin më të drejtpërdrejtë në zgjidhjen e konteste përkatëse, ka edhe nga ato që nuk janë të përfshira drejtpërdrejt në kontestin themelor, të cilat mund të ndikohen nga procesi dhe rezultati i tij. Përderisa pjesëmarrja e tyre ndryshon në varësi të rregullave procedurale në fuqi, këto përfshijnë OJQ-të, grupet e interesit, organizatat ndërkombëtare, financuesit e palëve të treta, nënkontraktorët dhe komunitetet lokale të prekura nga kontesti. Ndryshe nga palët në kontest, palët e ndërlidhura nuk kanë një të drejtë të lindur për të marrë pjesë në procedurat e ZAK-së. Megjithatë, ato mund të përfshihen me marrëveshje të palëve ose ndryshe sipas rregullave procedurale në fuqi.

Amicus Curiae

Të quajtur edhe "miq të gjykatës", *amicus curiae* mund t'u ofrojnë gjykatave perspektiva përtej atyre të paraqitura nga palët në kontest. Ato shpesh janë OJQ-të, organizatat akademike ose shoqatat e industrisë që ofrojnë njohuri të specializuara për politikën ose interpretimet ligjore. Edhe pse ata nuk i kontrollojnë procedurat, parashtresat e tyre mund të ndikojnë në rezultate më të gjera sistemike.

Polët Jo-kontestuese në Traktat	Në arbitrazhin e bazuar në traktat, shteti i origjinës së investitorit paditës mund të ndërhyjë për të mbështetur ose për t'iu përgjigjur pyetjeve të interpretimit të traktatit që lidhen me zgjidhjen e kontestit. Këto shtete mund të paraqesin deklaratat e tyre interpretuese ose ta trajtojnë çështjen bashkërisht me shtetin në kontest. Përfshirja e tyre ndihmon në sigurimin e qëndrueshmërisë në zbatimin e detyrimeve të traktatit.
Jo nënshkrues të kontratës	Jo-nënshkruesit e kontratës janë hisedarë të cilët, megjithëse nuk janë palë formale në një marrëveshje arbitrazhi, implikohen përmes marrëdhënieve të korporatave, zinxhirëve të kontratave ose sjelljes së lidhur ngushtë me kontratën dhe kontestin. Ata mund të përfshihen në procedura sipas doktrinave si grupi i kompanive, pëlqimi i nënkuptuar ose parimet e barazisë. Pjesëmarrja e tyre ngre pyetje komplekse në lidhje me juridiksionin, pëlqimin për arbitrazh dhe fushëveprimin e marrëveshjeve të arbitrazhit.
Komunitetet e Prekura	Komunitetet e prekura nga kontestet që përfshijnë burimet natyrore, ndikimet mjedisore ose të drejtat e njeriut ose të popullatave autoktone. Përfshirja e tyre i ndihmon gjykatat të kuptojnë dimensionet sociale dhe kulturore të kontestit. Këto komunitete zakonisht nuk kanë të drejta formale procedurale, por perspektivat e tyre mund të formësojnë përgjegjësinë, mjetet juridike dhe masat zbutëse.
Organizatat Ndërkombëtare	Organizatat ndërkombëtare mund të kontribuojnë si vëzhgues, administratorë ose ekspertë teknikë. Pjesëmarrja e tyre shpesh rrit legjitimitetin procedural ose ofron udhëzime autoritare mbi çështjet speciale. Zyrtarët ligjorë brenda institucioneve të tilla sjellin përvojë të konsiderueshme në të drejtën ndërkombëtare dhe zhvillimin e politikave.
Financuesit Palë të Treta	Subjektet e speciale që financojnë shpenzimet ligjore të një pale (zakonisht paditësit) në këmbim të një pjese të shpërblimit përfundimtar. Financues të tillë janë bërë hisedarë të rëndësishëm në arbitrazhin ndërkombëtar, duke ndikuar në strategjinë e çështjeve dhe duke kërkuar zbulim specifik në lidhje me konfliktet e interesit.

Fig 2.2: Shembuj të Palëve të Ndërlidhura

Ekspertët, Dëshmitarët, Miqtë (Amici)

Palët në kontest ose tribunali i arbitrazhit mund të kërkojnë kontribut nga të tjerët për të dhënë dëshmi mbi çështje që lidhen me rastin. Dëshmitarët dhe ekspertët e lëndës ofrojnë njohuri dhe mund të ndihmojnë në plotësimin e mangësive të informave dhe në përmirësimin e kuptimit të përbashkët të fakteve të kontestuar ose çështjeve teknike. Amici janë individë me

interes në kontest dhe ndihmojnë në ofrimin e perspektivave përtej perspektivave të palëve. Si të tillë, ata përmirësojnë cilësinë e procesit të ZAK-së dhe rezultatet e tij.

Dëshmitarët Ekspertë	Dëshmitarët e Fakteve	Amicus Curiae
Këta ekspertë i ndihmojnë gjyqtarët të kuptojnë çështjet teknike ose speciale që janë thelbësore për një kontest. Neutraliteti i tyre është thelbësor, pasi gjetjet e tyre mund të ndikojnë ndjeshëm në rezultate. Raportet e tyre shpesh i thjeshtojnë temat komplekse për vendimmarrësit. Këta ekspertë mund të thirren nga një palë në kontest ose t'u kërkohet nga gjykata të bashkohen me një kontest.	Dëshmitarët ofrojnë rrëfime faktike që mbështesin çështjen e një pale. Dëshmitarët faktikë mund të jenë të punësuar ose zyrtarë publikë, përderisa dëshmitarët ekspertë ofrojnë analiza speciale. Ndryshe nga dëshmitarët ekspertë të cilët luajnë kryesisht një rol objektiv dhe shkencor, dëshmitarët e fakteve mbështesin argumentet e palës propozuese.	Të quajtur edhe “miq të gjykatës”, amicus curiae mund t'u ofrojnë gjykatave perspektiva përtej atyre të paraqitura nga palët në kontest. Ato shpesh janë OJQ-të, organizatat akademike ose shoqatat e industrisë që ofrojnë njohuri të specializuara për politikatat ose interpretimet ligjore. Edhe pse ata nuk i kontrollojnë procedurat, parashtrerasat e tyre mund të ndikojnë në rezultate më të gjera sistemike.

Fig 2.3: Pjesëmarrës të tjerë potencialë në kontest

Neutralet

ZAK mbështetet në një spektër të larmishëm palësh të treta neutrale të cilat kontribuojnë në zgjidhjen e kontesteve në mënyra të dallueshme, shpesh plotësuese, varësisht nga natyra e procesit. Disa ndihmojnë palët që të arrijnë zgjidhje të pranueshme reciprokisht përmes negociatave dhe dialogut të lehtësuar (p.sh. ndërmjetësuesit ose pajtorët). Në të kundërt, të tjerët janë të autorizuar të përcaktojnë rezultatin përmes vendimeve detyruese ose gjetjeve të ekspertëve (arbitra komerciale dhe të investimeve, anëtarë të bordit të ekspertëve). Të kuptuarit e dallimeve në mes të këtyre roleve është thelbësor, sepse zgjedhja e një neutrali, qoftë ndërmjetës, ekspert apo arbitër, mund të formësojë në mënyrë dramatike procedurën, afatet kohore, konfidencialitetin dhe zbatueshmërinë e rezultatit. Diferencimi i këtyre akterëve i ndihmon lexuesit të zgjedhin metodën e duhur të ZAK-së bazuar në natyrën e konfliktit dhe palët. Ky

libër përqendrohet te ndërmjetësuesit dhe arbitrat, por këtu përmbledhen shkurtimisht disa lloje të tjera neutralësh.

- ➔ **Ndërmjetësuesit dhe pajtuesit** ofrojnë secili mbështetje të fuqishme përderisa palët negociojnë kontestn e tyre, si dhe si në ndërmjetësim ashtu edhe në pajtim, vetë palët janë vendimmarrësit përfundimtarë. **Ndërmjetësuesit** përqendrohen në lehtësimin e diskutimit. Ata i ndihmojnë palët të kuptojnë gamën e interesave që ndikojnë në qëndrimet e tyre, si dhe ato të palës tjetër. Nuk përcaktojnë çështje faktike ose ligjore në kontest; përkundrazi, ata ndihmojnë palët të arrijnë një zgjidhje të informuar mirë dhe të bazuar në interesa. **Pajtuesit** dallojnë nga ndërmjetësuesit në sepse ata japin një deklaratë autoritare, por jo detyruese, të meritave. Rekomandimet e tyre, ndonëse nuk janë detyruese, shpesh ofrojnë një rrugë të strukturuar drejt kompromisit.
- ➔ **Arbitrat** janë vendimmarrësit në arbitrazh, duke lëshuar vendime detyruese që janë të zbatueshme ndërkombëtarisht. Edhe pse emërohen nga palët në kontest, arbitrat janë të obliguar sipas detyrave pavarësie dhe paanshmërie ngjashëm si gjyqtarët, për të ruajtur legjitimitetin dhe integritetin e procedurës.
- ➔ **Ekspertët e pavarur ose vlerësuesit neutralë** japin opinione jo-detyruese ose zgjidhin konteste që kërkojnë ekspertizë speciale ose teknike. Inxhinierët, analistët financiarë ose shkencëtarët mjedisorë mund të angazhohen për të vlerësuar rreziqet ose për të propozuar zgjidhje të realizueshme. Në disa sektorë, siç është ndërtimi ose inxhinieria, **bordet e kontesteve** mund të shërbejnë gjithashtu si gjyqtarë në kontestet përkatëse.

Institucionet Ofruese të ZAK-së

Një sistem i ZAK që funksionon mirë u siguron palëve në kontest qasje te ofruesit, proceset dhe kostot e të cilëve janë në përputhje me fushëveprimin dhe kompleksitetin e kontestit. Palët mund të zgjedhin ZAK-në sipas rregullave të një institucioni specifik (institucional) ose në një kuadër më fleksibël (ad hoc) duke u pajtuar shprehimisht për rregullat e dëshiruara të procedurës. Këto korniza variojnë nga marrëveshje shumë fleksibile ad hoc, ku palët ushtrojnë autonomi maksimale, deri te mekanizma institucionale të administruar plotësisht që ofrojnë rregulla procedurale, shërbime të menaxhimit të çështjeve dhe mbikëqyrje profesionale.

Qendrat e ZAK-së dhe institucionet e arbitrazhit mund të vazhdojnë të ofrojnë shërbime administrative për procedurat ad hoc me kërkesë të palëve. Në arbitrazh, palët zakonisht zgjedhin arbitrazhin institucional duke zgjedhur rregullat e një institucioni specifik, përveç nëse është dakorduar ndryshe në klauzolën e tyre për zgjidhjen e kontesteve. Ndërkohë, gjykatat vendase mund të luajnë gjithashtu role të konsiderueshme në zhvillimin e protokolleve të ZAK-së, mbikëqyrjen e procedurave dhe ushtrimin e përgjegjësisë pas dhënies së vendimeve/marrëveshjeve (shih *KAPITULLI 6: Procedurat pas vendimit, pas marrëveshjes*).

Zgjedhja në mes të përfshirjes ad hoc, institucionale ose gjyqësore ndikon thellësisht në koston, efikasitetin, transparencën, zbatueshmërinë dhe trajektoren e përgjithshme të një kontestit. Të kuptuarit të qartë të këtyre strukturave u mundëson përdoruesve të zgjedhin mekanizmin më të përshtatshëm për nevojat e tyre dhe të lëvizin me besim në kompleksitetin e zgjidhjes së kontesteve ndërkombëtare.

Ndërmjetësimi Institucional

Ndërmjetësimi institucional administrohet nga organizatat që ofrojnë rregulla të strukturuar dhe mbikëqyrje. Institucione si ONT-ja ose qendrat kombëtare të ndërmjetësimit emërojnë ndërmjetësues dhe sigurojnë transparencë procedurale. Mbështetja e tyre rrit efikasitetin dhe nxit besimin te përdoruesit.

Arbitrazhi Institucional

Arbitrazhi institucional përfiton nga rregullat e përcaktuara, menaxhimi i rasteve dhe mbikëqyrja administrative nga organe si ICSID, ONT ose SIAC. Institucionet sigurojnë procedura të rregullta, ndihmojnë në përzgjedhjen e arbitrit dhe ofrojnë mjete për zgjidhje të përshpejtuar të çështjeve. Përfshirja e tyre nxit parashikueshmërinë dhe zbatueshmërinë, por mund të çojë në një rritje të kostove të arbitrazhit.

Mjete juridike vendore	Ndërmjetësim ose Arbitrazh Ad Hoc
Në klauzolat shumështrësore të zgjidhjes së kontesteve, qasja në ZAK mund të kushtëzohet nga ndjekja e mjeteve vendore juridike administrative ose gjyqësore. Nëse një palë vazhdon me ZAK pa përbushur parakushte të tilla, kjo mund të ketë ndikim në juridiksionin e gjykatës ose të shkaktojë kundërshtime të vendimit që lëshohet. Edhe pavarësisht ose në mungesë të parakushteve të brendshme, gjykatat vendore vazhdojnë të luajnë një rol thelbësor mbështetës në ZAK duke ofruar masa të përkohshme, duke zbatuar vendime dhe duke siguruar pajtueshmëri me procesin e rregullt ligjor. Mbikëqyrja e tyre lidh mekanizmat e ZAK-së me sistemet ligjore kombëtare, duke përforcuar legjitimitetin dhe stabilitetin e rezultateve të kontesteve.	Proceset ad hoc funksionojnë pa një kornizë institucionale të përhershme, duke u dhënë palëve kontroll të plotë mbi dizajnin procedural. Edhe pse fleksibile, ato kërkojnë bashkëpunim të ngushtë në mes të palëve për të menaxhuar detyrat administrative në mënyrë të pavarur. Prandaj, ka më pak mbrojtje kundër një pale të pabindur kur ajo e pengon procesin e arbitrazhit (p.sh. duke mos emëruar një ndërmjetësues ose arbitër). Institucionet mund të vazhdojnë të ofrojnë shërbime të kufizuara, siç janë emërimet e ndërmjetësuesve ose arbitrave ose objekteve për seanca dëgjimore/takime, pa imponuar rregulla të plota institucionale.

Fig 2.4: Opsionet Institucionale kundrejt atyre Ad Hoc

Një pyetje e zakonshme është nëse duhet të zgjidhet ndërmjetësim apo arbitrazh ad hoc apo institucional. Siç vihet re në figurën më sipër, korniza procedurale e përzgjedhur përcakton nivelin e ndihmës për palët në lidhje me: (1) kushtet logjistike, (2) nivelet e formalitetit procedural, (3) menaxhimi efikas i çështjeve, (4) kostot procedurale, (5) shkalla e diskrecionit të palëve mbi çështjet procedurale, (6) transparenca dhe (7) zbatueshmëria e mundshme e vendimit. Ndërkohë që përdorimi i një institucioni sjell një kosto, një palë duhet të marrë në konsideratë edhe kostot shtesë logjistike dhe procedurale që do të duhej të përvetësonte nëse do të merrte përsipër të gjithë mbështetjen e ofruar nga institucionet.

Konsiderata të veçanta për shtetet në krijimin e kornizave të ZAK-së

Kontestet ndërkombëtare mund të krijojnë angazhime të mëdha financiare, ligjore dhe të politikave publike për shtetet. Qeveritë kërkojnë gjithnjë e më shumë të kuptojnë dhe përmirësojnë më mirë kornizën institucionale për parandalimin dhe menaxhimin e kontesteve të tilla. Nëse kjo bëhet përpara se të lindin kontestet, shtetet mund t'i shmangin kontestet dhe

t'i trajtojnë ato më mirë sapo të lindin, duke kursyer njëkohësisht kostot dhe duke mbrojtur interesat jetësore ligjore dhe politike.

Siç u diskutua në *KAPITULLI 1: Konteksti historik, përmbledhje e ZAK-së dhe çfarë ofron ky libër*, ZAK luan një rol thelbësor si në tërheqjen e investimeve të huaja direkte ashtu edhe në depolitizimin e kontesteve të investimeve kur ato lindin. Duke shmangur ZAK-në, politikëbërësit po humbasin një mundësi thelbësore për të formësuar paraprakisht rregulloret e zgjidhjes së kontesteve, në mënyrë që zbatimi të mbështesë objektivat e politikave.

Politikëbërësit duhet të hartojnë dhe propozojnë masa mbrojtëse ligjore dhe institucionale për të trajtuar ekspozimin e mundshëm civil, penal ose politik të zyrtarëve qeveritarë që rrjedh nga pjesëmarrja e tyre në ZAK (veçanërisht zgjidhje miqësore). Siç diskutohet më poshtë, kjo mund të arrihet duke krijuar organe koordinuese ndërminstrore dhe ndërmjet agjencive, udhërrëfyes komunikimi dhe udhërrëfyes standard procedural, të cilët mund të përcaktojnë qartë rolet e secilit institucion dhe autoritetin kolektiv të zgjidhjes së çështjeve të organeve të caktuara. Ky lloj kornize transparente dhe e koordinuar mirë mund të rrisë sigurinë juridike për palët në kontest dhe gjithashtu të mbrojë institucionet kompetente dhe zyrtarët qeveritarë nga pasojat ose përgjegjësitë e mëvonshme negative.

Hartimi i Legjislacionit për Reformën e ZAK-së

Për të mbështetur reformat e qëndrueshme dhe afatgjata në rregullimin e ZAK-së, politikëbërësit duhet të gjurmojnë dhe dokumentojnë qartë qëllimin legjislativ pas zgjedhjeve të tyre të politikave të ZAK-së, duke përfshirë motivimet dhe qëllimet themelore. Kur politikat përkatëse trajtojnë zgjidhjen e kontesteve në sektorë të veçantë ose kërkojnë standarde të ndryshme të zbatueshme për palë të ndryshme të interesuara, duhet të ketë një histori të qartë legjislative që përshkruan bazën e ekspertëve ose shkencore për rregullat përkatëse. Këto materiale plotësuese krijojnë një regjistër të drejtimit legjislativ dhe ofrojnë bazën për përpjekje të vazhdueshme në vend të shtytjeve sporadike. Do të jetë gjithashtu një mjet interpretues i pazëvendësueshëm për gjyqtarët dhe arbitrat që zgjidhin kontestet bazuar në politika të tilla.

Për më shumë detaje mbi zhvillimin e të gjithë ekosistemeve ZAK, shih diskutimin në *KAPITULLI 7: Udhërrëfyshi për hartimin e sistemeve efektive dhe efikase të ZAK-së*.

Politikëbërësit duhet të mbeten parimisht të vetëdijshëm për hierarkinë e duhur të normave në mes të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, të sigurojnë reciprocitetin e marrëveshjeve globale të tregtisë dhe investimeve, si dhe të krijojnë mekanizma institucionalë për të zbatuar të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet publike dhe private. Me fjalë të tjera, ZAK nuk është jashtë kontrollit të një shteti.

Për këtë qëllim, çdo shtet duhet të sigurojë që ka përcaktuar pesë parakushte për përfaqësim efektiv në mekanizmat ndërkombëtarë të ZAK-së për negociata, ndërmjetësim dhe arbitrazh:




Fig 2.5: Parakushtet që shtetet të sigurojnë përfaqësim efektiv në ZAK

Janë zhvilluar tre modele të përgjithshme për përfaqësimin e një shteti në kontestet ndërkombëtare: këshilltar juridik i jashtëm, këshilltar juridik i brendshëm dhe një model hibrid.

Këshilltar juridik i jashtëm	Këshilltar juridik i brendshëm	Hibrid
Shteti mund të punësojë këshilltarë juridik të jashtëm. Kontestet ndërkombëtare mund të shkaktojnë pretendime të konsiderueshme ligjore, të politikave publike dhe financiare për shtetin. Kontestet e tilla mund të jenë shumë të specializuara, duke kërkuar ekspertizë që nuk është lehtësisht e disponueshme për shtetin. Prandaj, shtetet mund të zgjedhin opsionin e angazhimit të avokatëve ndërkombëtarë me përvojë për të mbrojtur shtetin. Angazhimi i një këshilltari juridik të jashtëm duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së një indikacioni se një padi po ngrihet ose është ngritur.	Shtetet mund të mbështeten në këshilltarë juridik të brendshëm qeveritarë për kontestet e tyre. Ky model mund të jetë më efektiv nga ana e koston për padi më pak komplekse ose me vlerë më të vogël. Për më tepër, shtetet që parashikojnë ose përballen me padi të shumfishta mund ta konsiderojnë të nevojshme dhe të përshtatshme të investojnë fondet e konsiderueshme të nevojshme për të krijuar dhe mirëmbajtur një ekip të dedikuar këshilltarësh juridik.	Shteti mund të përfaqësojë veten, por të mbajë një grup të vogël avokatësh të jashtëm për ta ndihmuar atë. Një qasje e tillë hibride e ndihmon shtetin të kontrollojë kostot dhe të ruajë më mirë kontrollin mbi kontestet ndërkombëtare. Gjithashtu, kjo i lejon shtetit të shfrytëzojë përvojën dhe ekspertizën e avokatëve më të mirë ndërkombëtarë, duke zhvilluar ekspertizë të brendshme për raste të ardhshme (p.sh. shkatërrimi total i një biznesi ose reputacioni).

Fig 2.6: Llojet e këshilltarëve juridik

Modelet e koordinimit shtetëror për menaxhimin e rrezikut të investimeve të huaja

Shtetet po krijojnë gjithnjë e më shumë organe koordinuese të përhershme për të ndihmuar në parandalimin dhe zbutjen e kontesteve ndërkombëtare të investimeve. Organet e tilla pasqyrojnë struktura dhe funksione të ndryshme. Megjithatë, disa karakteristika standarde dhe praktikat më të mira janë të dukshme. Shtetet në përgjithësi kanë ndjekur tre qasje të ndryshme ndaj koordinimit: (1) një agjenci e vetme (2) agjenci të shumfishta ose (3) një qasje hibride:

Agjencia e vetme koordinuese

- Shtetet mund të krijojnë një agjenci të vetme koordinimi për shtetin, qoftë si një organ autonom ose brenda një ministrie ekzistuese ose një agjencie qeveritare. Për shembull, disa shtete e kanë caktuar avokatin e popullit për të shërbyer si organ koordinues (p.sh. Brazili, Gjeorgjia, Greqia, Kazakistani, Mongolia, Filipinet, Republika e Koresë, Federata Ruse dhe Ukraina).
- Shtetet e tjera u kanë ngarkuar agjencive të tyre të promovimit të investimeve të shërbejnë si organ koordinues (p.sh. "InvestChile" i Kilit, "Invest in Georgia" e Gjeorgjisë).
- Në shtete të tjera, organi koordinues është krijuar nën një ministri të vetme (p.sh. Drejtoria e Padive Civile e Ministrisë së Financave të Bullgarisë, Drejtoria e Investimeve dhe Shërbimeve të Huaja e Kolumbisë brenda Ministrisë së Tregtisë dhe Njësia e Mbrojtjes së Investimeve të Çekisë në Ministrinë e Financave).

Agjencitë e shumëfishta koordinuese

- Disa shtete shpërndajnë funksionet e parandalimit dhe zbutjes së kontesteve nëpër agjencitë qeveritare, secila prej të cilave luan një rol specifik ose trajton ankesa të veçanta.

Hibrid

- Disa shtete miratojnë një qasje hibride, duke krijuar një komitet ose komision që përfshin ministri dhe agjenci të specializuara ose agjenci të tjera përkatëse, me një agjenci që shërben si sekretariat (p.sh. Egjipti: komiteti ministror për zgjidhjen e kontesteve të kontratave të investimeve, brenda Kabinetit të Ministrave, ndihmon në zgjidhjen e kontesteve që rrjedhin nga kontratat e investimeve; Kina: Ministria e Tregtisë, me departamente të tjera përkatëse nën Këshillin e Shtetit, krijoi një sistem takimesh të përbashkëta ndërministrorë për të koordinuar dhe lehtësuar kontestet e investimeve).

Nuk ka një qasje të vetme që i përshtatet të gjitha shteteve që dëshirojnë të krijojnë një organ të tillë koordinimi. Siç është deklaruar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Tregtare Ndërkombëtare:

"Qoftë një organ i vetëm koordinues, agjenci të shumta apo një komitet ndërinstitucional, procedurat e brendshme të funksionimit

(përbërja e autoritetit, sistemet e monitorimit dhe vlerësimit dhe kujt i raporton autoriteti) do të duhet të përshtaten për secilin shtet për të siguruar efikasitetin e autoritetit dhe legjitimitetin e tij, si dhe për të shmangur konfliktet e interesit, mungesën e neutralitetit ose interesat e ngushta. Mënyra se si autoriteti perceptohet nga investitorët, zyrtarët qeveritarë dhe akterët e tjerë është thelbësore për suksesin e tij”.

Dy shembuj të platformave të krijuara nga shteti të specializuara në shërbimet ZAK përfshijnë Korenë e Jugut dhe Perunë.

“Avokati i Popullit për Investimet e Huaja” i Koresë së Jugut	“Sistemi i Koordinimit dhe Përgjigjes për Kontestet Ndërkombëtare të Investimeve” i Perusë
Ky organ për zgjidhjen e ankesave mbledh dhe analizon informatat në lidhje me problemet me të cilat ballafaqohen firmat e huaja. Ata gjithashtu kërkojnë bashkëpunim nga agjencitë përkatëse administrative dhe rekomandojnë zbatimin, propozojnë politika të reja për të përmirësuar sistemin e promovimit të investimeve të huaja dhe kryejnë detyra të tjera të nevojshme për të ndihmuar kompanitë me investime të huaja në zgjidhjen e ankesave të tyre.	Ky organ ndihmon në koordinimin dhe menaxhimin e kontesteve ndërkombëtare të investimeve që përfshijnë entitete publike në një mënyrë të shpejtë dhe efektive. Komisioni i Perusë i jep përparësi dhe promovon zgjidhjen përmes miqëve, duke përfshirë aty edhe negociatat e drejtpërdrejta me investitorët e huaj.

Fig 2.7: Shembuj të Platformave të Shërbimit të ZAK-së të krijuara nga shteti

Burimet e dobishme

Udhëzime për hisedarët

- IBA, Udhëzime mbi Konfliktet e Interesit në Arbitrazhin Ndërkombëtar (2024): <https://www.ibanet.org/document?id=guidelines-on-conflicts-of-interest-in-international-arbitration-2024>
- IBA, Udhëzime mbi Përfaqësimin e Palëve në Arbitrazhin Ndërkombëtar (2013): <https://www.ibanet.org/MediaHandler?id=6F0C57D7-E7A0-43AF-B76E-714D9FE74D7F>
- UNCITRAL dhe ICSID, Kodi i Sjelljes për Gjyqtarët në Kontestet Ndërkombëtare të Investimeve (2023): <https://icsid.worldbank.org/resources/code-of-conduct>
- UNCITRAL Shënime mbi Organizimin e Procedurave të Arbitrazhit (2016): <https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/arb-notes-2016-e.pdf>

Lista jopërfundimtare e institucioneve të arbitrazhit

- Oda Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)
- Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës (LCIA)
- Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Singapor (SIAC)
- Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Hong Kongut (HKIAC)
- Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit (PCA)
- Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID)
- Instituti Gjerman i Arbitrazhit (DIS)
- SCC Instituti i Arbitrazhit (SCC)
- Shoqata Amerikane e Arbitrazhit - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve (AAA-ICDR)
- Komisioni i Arbitrazhit Ndërkombëtar Ekonomik dhe Tregtar të Kinës (CIETAC)
- Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Vjenës (VIAC)
- Qendra Zvicerane e Arbitrazhit (Swiss Arbitration)

- ➔ Qendra Rajonale e Kajros për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar (CRCICA)
- ➔ Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Dubai (DIAC)
- ➔ Qendra Australiane për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar (ACICA)
- ➔ WIPO Qendra e Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit (WIPO)

Lista jopërfudimtare e ofruesve të ndërmjetësimit institucional

- ➔ Oda Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)
- ➔ Shërbimet e Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit Gjyqësor (JAMS)
- ➔ Shoqata Amerikane e Arbitrazhit - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve (AAA-ICDR)
- ➔ Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor (SIMC)

Lista jopërfudimtare e institucioneve për ndërmjetësim

- ➔ Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID)
- ➔ Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor (SIMC)
- ➔ Qendra për Zgjidhjen Efektive të Kontesteve (CEDR)
- ➔ Instituti i Arbitrazhit të Odës së Tregtisë së Stokholmit (SCC)
- ➔ Oda Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)

KAPITULLI 3:

Ndërmjetësimi




Fig 3.1: Procesi i Zgjidhjes Alternative të Kontesteve

Përkufizimi i Ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi është një proces i negocimit të lehtësuar në të cilin të gjitha palët takohen me një palë të tretë neutrale (ndërmjetësuesin). Karakteristikat kryesore të ndërmjetësimit janë vullnetarizmi, konfidencialiteti dhe vetëvendosja e palëve. Ndërmjetësimi është i dobishëm për zgjidhjen krijuese të problemeve dhe zgjidhjen efikase të kontesteve. Ndërmjetësimi mund të përshtatet sipas fushëveprimit dhe shkallës së të gjitha llojeve të kontesteve, nga paditë ndërpersonale ose të vogla deri te zhvillimi kompleks komercial dhe i politikave. Ndërmjetësimi mbështet parimet e autonomisë dhe pëlqimit të palëve në nivelin e tyre më të lartë dhe mbështetet në parimin e *vetëvendosjes*. Ndërmjetësuesi e udhëzon procesin dhe, në kontekste specifike, mund të ofrojë një vlerësim këshillues, por *nuk* vendos për çështjen.

Parimi i vetëvendosjes

Roli i ndërmjetësuesit është të lehtësojë një proces të drejtë që mbështet vendimarrjen e informuar, jo të imponojë rezultate ose të zëvendësojë vendimet e palëve me gjykimin e ndërmjetësuesit. Palët në kontest — me mbështetjen e ndërmjetësuesit — ruajnë autonominë për të zgjedhur nëse do të ndërmjetësojnë, si do të vazhdojë ndërmjetësimi, çfarë informata të paraqesin, nëse do të arrijnë një marrëveshje dhe me çfarë kushtesh; këto zgjedhje duhet të jenë vullnetare, të informuara dhe të lira nga shtrëngimi.

Ndërmjetësimi ndërtohet mbi idenë e thjeshtë, por të fuqishme, se njerëzit, kur u jepet struktura dhe mbështetja e duhur, mund të krijojnë zgjidhjet e tyre për konfliktin. Ndryshe nga zgjidhja e kontesteve me anë të gjyqimit, siç janë proceset gjyqësore ose arbitrazhi, ndërmjetësimi nuk i delegon autoritet një gjyqtari ose arbitri. Në vend të kësaj, krijon një platformë ku palët mund të flasin më hapur për interesat e tyre në një kontest, të shqyrtojnë shkaqet rrënjësore të kontestit dhe të eksplorojnë një gamë të gjerë rezultatesh përtej vetëm pozicioneve ligjore. Vlen të theksohet se palët mbeten arkitektët e çdo rezultati dhe rrjedhimisht, tendenca është që marrëveshjet e ndërmjetësuara të jenë të qëndrueshme.



Fig 3.2: Disa lloje kontestesh të vendosura në situatë ideale për ndërmjetësim

Ndërmjetësimi është më fleksibël sesa një proces gjyqësor formal ose arbitrazh dhe përshtatet me ndryshimet kulturore, realitetet tregtare, dinamikën emocionale dhe nevojën praktike për të ruajtur marrëdhëniet e vazhdueshme. Procesi është gjithashtu konfidencial, zakonisht më pak adversarial dhe mund të ecë më shpejt se shumica e proceseve gjyqësore. Ndërmjetësimi nuk është një version më i butë i vendimmarrjes në formë gjykimi; është një qasje thelbësisht e ndryshme, duke e riformuluar konfliktin si një problem të përbashkët që duhet zgjidhur me mundësi të gjera, në vend të një vendimi binar. Dallimet në mes të ndërmjetësimit dhe vendimmarrjes në formë gjykimi gjithashtu krijojnë disa shqetësime të përbashkëta në lidhje me procesin dhe çdo rezultat. Këto përfshijnë shqetësime se pjesëmarrësit mund të jenë të paarsyeshëm ose të mos kenë autoritet, konfidencialiteti mund të shkelet, nuk ka kornizë ligjore për ndërmjetësim, ekzekutimi i marrëveshjeve do të jetë sfidues dhe, për disa zyrtarë qeveritarë, ka një rrezik përgjegjësie personale.




Fig 3.3: Komponentët e përgjithshme të ndërmjetësimi

Ky kapitull prezanton parimet dhe strukturën thelbësore të ndërmjetësimi, duke përfshirë vendin e tij brenda spektrit të proceseve të zgjidhjes së kontesteve. Trason rrugën për një shqyrtim më të thellë të arsyeve dhe mënyrës se si ndërmjetësimi mund të përfshihet në praktikën shtetërore, si një sistem për përdoruesit privatë, por edhe si një mundësi për vetë hisedarët shtetërorë.

Ndërmjetësimi nuk vendimmarrje në formë gjykimi

Ndërmjetësimi mund të përmbushë shumë, por jo të gjitha nevojat. Në veçanti, ndërmjetësimi nuk mund të funksionojë në çështjet që kërkojnë gjykim për disa arsye. Ndërmjetësimi nuk:

- ➔ Gjykon ose mbron **të drejtat ligjore** të palëve ose shpall një palë fituese
- ➔ Prodhon interpretime detyruese të së drejtës ose fakteve, e me këtë rrallë krijon **precedentë** detyrues (edhe pse një rezultat i ndërmjetësuar që përfshin një subjekt shtetëror mund të nxisë ndryshime më të gjera në politika ose ato statute për qëndrueshmëri).
- ➔ Përcakton të “**vërtetën**” përmes mekanizmave të gjetjes së fakteve, siç është detyrimi i paraqitjes së provave ose intervistimit të tërthortë, duke kufizuar kështu dobinë e saj në zgjidhjen e pozicioneve të vështira të palëve
- ➔ Gjen faj ose imponon dënime, duke e kufizuar përdorimin e saj për palët që duan **ndëshkim**.

Procesi i Ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi karakterizohet nga një përshtatshmëri e jashtëzakonshme. Për sa kohë që ruhen vlerat specifike thelbësore të procesit (p.sh. konfidencialiteti, pëlqimi i vazhdueshëm, vetëvendosja e palëve dhe opsioni për ta zgjidhur ose jo), procesi mund të modifikohet për t'iu përshtatur nevojave të çdo kontestit, individi ose institucioni. Shumica e ndërmjetësimeve vazhdojnë me fazat në vijim.




Fig 3.4: Fazat e përgjithshme të ndërmjetësimit dhe zgjedhjet e procesit

Marrëveshje ndërmjetësimi para-kontestit

Palët mund të pajtohen t'i referojnë kontestet për ndërmjetësim para ose pasi ato të lindin. Për palët komerciale, është tipike të përfshijnë një klauzolë për zgjidhjen e kontesteve në kontratat e tyre. Klauzolat e tilla shpesh identifikojnë metodën kryesore për zgjidhjen e kontesteve, të cilat gjithnjë e më shumë përfshijnë marrëveshje për ndërmjetësim në një fazë të procesit të zgjidhjes së kontesteve.

Si dakordohet një palë për ndërmjetësim? Shembull i klauzolës së ndërmjetësimit-arbitrazhit nga ICC-ja

"Në rast të ndonjë kontesti që lind nga ose në lidhje me kontratën aktuale, palët së pari do ta referojnë kontestin në procedurat sipas Rregullave të Ndërmjetësimit të ICC-së. Nëse kontesti nuk është zgjidhur në përputhje me Rregullat e lartpërmendura brenda [45] ditëve pas paraqitjes së Kërkesës për Ndërmjetësim ose brenda një periudhe tjetër për të cilën palët mund të pajtohen me shkrim, një kontest e tillë do të zgjidhet përfundimisht sipas Rregullave të Arbitrazhit të Odës Ndërkombëtare të Tregtisë nga një ose më shumë arbitra të emëruar në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të lartpërmendura".

Qoftë ad hoc apo përmes një institucioni, përcaktimi i një sërë rregullash është thelbësor për të përcaktuar aspektet kryesore të procesit të ndërmjetësimit, duke përfshirë detyrat e ndërmjetësuesve, procesin e emërimit, natyrën jo-paragjyquese të ndërmjetësimit dhe konfidencialitetin.

Themelore për ndërmjetësimin është konfidencialiteti i procesit, i cili mund të diktohet nga rregullat e përcaktuara të një ofruesi të ZAK-së ose të një gjykate ose të zhvillohet nga palët dhe ndërmjetësuesi. Konfidencialiteti zakonisht zbatohet për bisedat e ndërmjetësimit dhe për çdo material të përgatitur veçanërisht për procesin e ndërmjetësimit. Shumica e rregullave institucionale, nëse jo të gjitha, përmbajnë detyrime të gjera konfidencialiteti që mbrojnë informatat e ndjeshme të palëve dhe parandalojnë përdorimin e çdo informate të fituar në ndërmjetësim në një kontest të lidhur. Këto dispozita mbrojnë integritetin e procesit të ndërmjetësimit dhe u lejojnë palëve të diskutojnë çështjet në mënyrë më të sigurtë me ndërmjetësuesin dhe madje edhe me palët e tjera në kontest. Çfarëdo informatë e fituar gjatë ndërmjetësimit vazhdon të mbetet "pa paragjykim", që do të thotë se diskutimet dhe informatat e shkëmbyera gjatë ndërmjetësimit nuk mund të paraqiten si prova në procedurat pasuese ligjore ose të arbitrazhit.

Palët, ofruesit e shërbimeve ose shtetet mund të krijojnë përjashtime nga konfidencialiteti i ndërmjetësimit, prandaj është thelbësore që të gjithë pjesëmarrësit në një ndërmjetësim të caktuar të dinë, të kuptojnë dhe të pajtohen për fushëveprimin e konfidencialitetit që zbatohet përpara se ai të fillojë.

Pyetjet paraprake kur merret në konsideratë ndërmjetësimi


- ➔ A janë palët të interesuara të ruajnë marrëdhënien e tyre?
- ➔ A kërkojnë palët një zgjidhje të shpejtë të kontestit së tyre?
- ➔ A preferojnë palët të mbajnë kontrollin mbi rezultatin?
- ➔ A kërkojnë palët zgjidhje të përshtatura për ata apo alternativa ndaj mjeteve juridike të zakonshme të ofruara përmes kompensimit monetar?
- ➔ A ka konflikte ose çështje të shumëfishta në kontest në mes të palëve, disa prej të cilave mund të negociohen/ndërmjetësohen?
- ➔ A përfshin kontesti palë të shumëfishta me interesa të ndryshme?

Fillimi i ndërmjetësimit dhe përzgjedhja e ndërmjetësuesit

Ndërmjetësimi inicohet ose nga palët ose me anë të referimit nga një subjekt (siç është një gjyqtar që e referon një rast në një qendër të lidhur me gjykatën ose në OJQ). Më pas, një ndërmjetësues caktohet në rast sipas zgjedhjes së palëve, rregullave të ofruesit të ndërmjetësimit ose subjektit referues. Ndërmjetësimi mund të kryhet si një proces kolektiv në të cilin të gjithë pjesëmarrësit janë së bashku, si një seri bisedash të ndara me ndërmjetësuesin (një i ashtuquajtur "caucus" [konsultim i ndarë]), ose si kombinim i të dyjave. Palët dhe ndërmjetësuesi në fund vendosin nëse fazat zhvillohen bashkërisht apo në caucus.

Fillimi i ndërmjetësimit

Seanca e Ndërmjetësimit




Fazat e hershme të ndërmjetësimit karakterizohen nga komunikimet me ndërmjetësuesin për të diskutuar informatat bazë, përfshirë: (1) kush duhet të marrë pjesë; (2) shkëmbimi i çdo dokumenti dhe informate në lidhje me kontestin; (3) hartimi i parashtrësive paraprake për ndërmjetësin dhe/ose palën kundërshtare; dhe (4) koha dhe vendi për seancën fillestare të ndërmjetësimit. Këto biseda të hershme ndihmojnë gjithashtu në ndërtimin e raportit në mes të ndërmjetësuesit dhe palëve.

Rregullat dhe procedurat e ndërmjetësimit duhet të dakordohen (ose të rishikohen nëse procedurat përcaktohen nga subjekti referues, siç është një qendër ndërmjetësimi e lidhur me gjykatën ose një qendër ndërmjetësimi private) përpara se të diskutohet informatat thelbësore. Në gjykata, palët mund të referohen për ndërmjetësim si pjesë e një konsultimi me gjyqtarin. Në këtë rast, nuk është e pazakontë që seanca fillestare ose e vetme e ndërmjetësimit të fillojë me një shkëmbim dhe diskutim të kësaj informate paraprake. Në mjediset e ndërmjetësimit ku ndërmjetësuesi caktohet/zgjidhet përpara seancës fillestare, ky shkëmbim bazë shpesh ndodh para seancës së parë.

Seanca e ndërmjetësimit

Takime Private



Ndërmjetësimi mund të zhvillohet në një takim të vetëm ose në disa seanca, varësisht nga palët dhe natyra e kontestit. Pasi ndërmjetësuesi dhe të gjithë pjesëmarrësit të jenë thirrur në një seancë fillestare, ndërmjetësuesi fillon procesin duke shqyrtuar procedurat e dakorduara për procesin, duke përfshirë cilindo konfidencialiteti (dhe përjashtim) dhe vetëvendosje, duke përshkruar rolin e tyre dhe rolet e të pranishmëve, dhe do të konfirmojë çdo detaj tjetër të nevojshëm,

siç është cilido proces për finalizimin e marrëveshjeve nëse arrihet një e tillë. Kjo informatë është thelbësore nëse ndonjë palë në këtë seancë ndërmjetësimi nuk ka marrë pjesë në thirrjet paraprake. Palët dhe këshilltarët juridik të tyre, nëse kanë përfaqësues, zakonisht fillojnë duke ndarë informatat e rëndësishme në lidhje me kontestin.

Vetë-përfaqësimi kundrejt përfaqësimit nga avokati në ndërmjetësim

Ndërmjetësimi shpesh mendohet si një procedurë palë-me-palë, por, në realitet, njëra ose të dyja palët mund të përfaqësohen nga një këshilltar juridik. Në konteste më të sofistikuara, ndërmjetësuesit mund të komunikojnë kryesisht me këshilltarin juridik ose drejtpërdrejt me palët, siç vendosin palët.

Ndërmjetësuesit përdorin bisedën dhe pyetjet për të avancuar kuptimin e palëve lidhur me çështjet kryesore (ligjore, të marrëdhënieve, informative dhe emocionale) që i pengojnë ata të zgjidhin çështjen. Në fazat e hershme të ndërmjetësimit, fokusi është në kuptimin e palëve për atë që duan (dhe pse) dhe atë që dëshiron pala tjetër (dhe pse). Nëse kontesti ka një aspekt ligjor, ky mirëkuptim do të integrojë paditë/mbrojtjet, provat dhe precedentin.

Në disa konflikte, informatat e tjera do të shfaqen dukshëm, duke përfshirë: ndikimet emocionale ose të tjera të kontest në komunitetin, biznesin, familjen ose vendin e punës në përgjithësi; krahasimet me çështje të ngjashme brenda të njëjtes kornizë ligjore ose rregullatore; ose aftësinë ose pamundësinë e një pale për të paguar për të zgjidhur ose vazhduar kontestin.

Në shumë çështje, aftësia e ndërmjetësuesit për të nxjerrë në pah një mirëkuptim të zgjeruar është e mjaftueshme që palët të përcaktojnë një zgjidhje. Nëse jo, ndërmjetësuesi mund të përdorë një sërë ndërhyrjesh të tjera për të ndihmuar palët të zgjidhin kontestin. Për shembull, kur pritjet e një pale në lidhje me zgjidhjen e një kontesti mund të mos jenë të arritshme, një ndërmjetësues mund të bëjë pyetje hulumtuese për të testuar pritjet dhe supozimet e një pale në lidhje me çështjet ligjore ose faktike. Ndërmjetësuesit mund të diskutojnë gjithashtu rreziqet (përfshirë

rezikun e procesit ligjor), të nxjerrin në pah alternativat e palëve ndaj një zgjidhjeje të negociuar, të shqyrtojnë qëllimet dhe interesat më të gjera të palëve, ose, me pëlqimin e palëve, të përdorin informatat e fituara nga palët për të bërë propozime për të kapërcyer bllokimin ose për të zgjidhur kontestin.

Përfundimi i ndërmjetësimit



Zakonisht, ndërmjetësuesit do të punojnë me palët derisa çështja të zgjidhet ose derisa njëra ose të dyja palët të jenë të sigurt se nuk mund të zgjidhet. Nëse ndërmjetësimi përfundon pa marrëveshje, ndërmjetësuesi mund të vihet në dispozicion në një datë të mëvonshme dhe/ose pasi palët të kenë ndërmarrë hapat e mëtejshëm të përcaktuar (si shkëmbimi i mëtejshëm i informatave ose një vendim të përkohshëm nga një gjyqtar ose arbitër).

Ndryshe nga rezultatet e vendimmarrjes në formë gjykimi në gjykatë ose në arbitrazh – të cilat mund të provokojnë rezistencë, kërkesa për anulim apo edhe ankimim – marrëveshjet e ndërmjetësuar mbështeten në miratimin e ndërsjellë dhe pasqyrojnë interesat, përparësitë dhe kufizimet praktike të palëve. Zgjidhjet e negociuara për këtë arsye quhen "të qëndrueshme" sepse palët zakonisht besojnë se marrëveshja është në interesin e tyre më të mirë.

Megjithatë, qëndrueshmëria varet nga integriteti i procesit, qartësia e detyrimeve dhe gatishmëria e vazhdueshme e palëve për t'iu përmbajtur kushteve të marrëveshjes së tyre. Në disa konteste, procesi joformal dhe natyra jodetyruese e zgjidhjes mund ta lënë zgjidhjen të cenueshme ndaj mospërmbushjes së saj, kështu që pjesëmarrësit duhet ta përfundojnë ndërmjetësimin duke marrë në konsideratë nëse dhe si ta regjistrojnë çdo rezultat.

Mënyra më e zakonshme dhe e natyrshme për të vënë në zbatim një marrëveshje të ndërmjetësuar është përmes pajtueshmërisë vullnetare ndaj saj nga palët në kontest. Megjithatë, nëse marrëveshja përfshin mjete

monetare ose kontraktuale, ose nëse ekziston një kërkesë ligjore, palët mund të kërkojnë që një tribunal arbitrazhi të vërtetojë kushtet e tyre të ujdisë si një vendim arbitrazhi të zbatueshëm ndërkombëtarisht. Palët gjithashtu mund të zbatojnë marrëveshjet e ndërmjetësuar të zgjidhjes sipas Konventës së Singaporit për Ndërmjetësim, kur është e zbatueshme. (Shih *KAPITULLI 6: Procedurat pas vendimit, pas marrëveshjes.*)

Akreditimi i ndërmjetësuesit

Çdo skemë ndërmjetësimi mbështetet shumë në cilësinë e ndërmjetësuesve të disponueshëm. Akreditimi mund të përcaktohet përmes një kombinimi të trajnimit, certifikimit/licencimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Zhvillimi i çdo kredencializimi duhet të jetë specifik për forumin dhe duhet të jetë në përputhje me natyrën e palëve dhe kontesteve. Certifikimi duhet të marrë në konsideratë nevojën për çdo diplomë ose licencë tjetër (p.sh. juridike, për punë sociale, biznes, kontabilitet), për trajnim fillestar dhe të avancuar në procesin e ndërmjetësimit, trajnim në lidhje me ndërmjetësimin e llojeve specifike të kontesteve ose kornizave ligjore, si dhe çdo kompetencë ose njohuri tjetër të nevojshme, duke përfshirë ato gjuhësore, teknike ose kulturore. Në mënyrë optimale, një sistem licencimi ose akreditimi do të përfshijë informata kthyesë të vazhdueshme dhe/ose zhvillim profesional për ndërmjetësuesit për të siguruar që aftësitë e tyre të vazhdojnë të evoluojnë së bashku me mjedisin e ndërmjetësimit.

Zhvillimi i akreditimit të ndërmjetësuesve lidhet drejtpërdrejt me modelin e lidhjes së ndërmjetësuesve me raste të veçanta. Kur palët zgjedhin ndërmjetësuesit e tyre, kërkesat në lidhje me kredencialet e ndërmjetësuesit mund të jenë më pak kushtshtëzuese. Në fund të fundit, në shumë komunitete lokale dhe ato të biznesit, ekziston një kulturë e "ndërmjetësuesve të komunitetit" (pleqnar, persona të njohur për statusin ose aftësitë e tyre) të cilët njihen si mjaft efektivë. Derisa institucionet përfshihen më shumë në krijimin e listave të ndërmjetësuesve dhe caktimin e ndërmjetësuesve, forcohet detyrimi për të vendosur standarde minimale të kompetencës.

Pavarësia dhe paanshmëria e ndërmjetësuesit

Lidhur me akreditimin dhe caktimin e ndërmjetësuesit është detyra e ndërmjetësuesit për të menaxhuar konfliktet aktuale, të mundshme dhe të perceptuara të interesit ose të animit. Në praktikën moderne të

ndërmjetësimit, veçanërisht në kontestet tregtare, ndërmjetësuesit duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Domethënë, i pavarur nga secila palë dhe i paanshëm ndaj pozicioneve dhe çështjeve të paraqitura të palëve. Kjo bëhet për qëllime të dyfishta: të ruajë integritetin e procesit të ndërmjetësimit dhe, në thelb, të sigurojë vetëvendosjen e palëve për kontest. Me fjalë të tjera, nuk duhet të ketë dyshim se rezultati i kontestit ndikon në mënyrë të favorshme në interesat e vetë ndërmjetësuesit.

Në shumë vende, ndërmjetësuesve do t'u kërkohet të marrin në konsideratë dhe të zbulojnë çdo konflikt të mundshëm interesi që mund të kenë me palët ose me çështjen e kontestuar. Ajo që përbën një konflikt përcaktohet nga normat kulturore që rrethojnë palët dhe kontestin. Thelbësore për identifikimin dhe zbulimin e konflikteve është të kuptuarit e normave lokale. Kur kanë dyshime, ndërmjetësuesit duhet t'u zbulojnë palëve çdo fakt ose marrëdhënie që mund të shkaktojë shqetësim në lidhje me neutralitetin e ndërmjetësuesit ose duhet të vet-përrjashtohen nëse nuk mund ose nuk do ta bëjnë një zbulim të tillë.

Pse ndërmjetësuesit jo vetëm që duhet të jenë të paanshëm, por edhe të duken si të paanshëm?

Në rastin CEATS kundër Continental Airlines, gjykata shqyrtoi nëse një ndërmjetës i caktuar nga gjykata kishte shkelur detyrën e tij të neutralitetit duke mos zbuluar lidhjet e tij komplekse profesionale dhe shoqërore me një zyrë avokatie të lidhur me një kontest të vazhdueshme dhe të profilit të lartë. Edhe pse ndërmjetësuesi nuk veptoi si gjyqtar dhe nuk kishte prova se ai kishte keqpërdorur informatat konfidenciale, gjykata e apelit konstatoi se ai kishte shkelur detyrimin e tij etik për të zbuluar marrëdhënie që mund ta bënin një vëzhgues të arsyeshëm të vinte në dyshim paanshmërinë e tij. Gjykata theksoi se detyra për të ruajtur neutralitetin si aktual ashtu edhe të perceptuar është thelbësore për të mbrojtur drejtësinë dhe besimin e publikut në ndërmjetësim.

Vendet dhe kostot e ndërmjetësimit

Ndërmjetësimi mund të jetë tërësisht ad hoc ose të ndjekë rregulla institucionale përshkruese. Prandaj, kostoja dhe struktura e secilit ndërmjetësim ndryshojnë ndjeshëm. Në sferën tërësisht private, të gjitha vendimet në lidhje me procesin e ndërmjetësimit janë nën kontrollin e palëve, duke përfshirë kostot, përzgjedhjen e ndërmjetësuesit, vendndodhjen dhe çdo marrëveshje konfidencialiteti. Ndërmjetësuesit privatë që nuk janë të lidhur me asnjë organizatë mund të kenë rregullat e tyre të praktikës, kontratat e ndërmjetësimit dhe shkallët e pagave për të cilat palët duhet të pajtohen. Për disa palë, ky proces privat ad hoc mund të jetë optimal.

Ofruesit privatë të shërbimeve të ndërmjetësimit, siç janë CPR, JAMS dhe SIMC, veprojnë sipas rregullave të tyre të përcaktuara për lloje specifike të rasteve. Organizata zakonisht merret me administrimin e rastit dhe mirëmban një listë të miratuar nga e cila palët mund të zgjedhin një ndërmjetësues. Palët i paguajnë ndërmjetësuesit një tarifë, të cilën e përcakton ofruesi. Kjo tarifë mund të jetë me orë ose me ditë dhe shpesh varet nga niveli i përvojës ose kërkesa e ndërmjetësuesit. Palët gjithashtu i paguajnë një tarifë organizatës për rolin e saj në administrimin e rasteve.

Organizatat jofitimprurëse janë gjithashtu ofrues të zakonshëm të shërbimeve të ndërmjetësimit dhe mund të funksionojnë, pjesërisht, përmes financimit shtetëror. Shërbimet e ndërmjetësimit të mbështetura nga shteti mund të zhvillohen për të adresuar çështje specifike, si kontestet familjare, kërkesat e vogla dhe kontestet tregtare. Organizatat jofitimprurëse punojnë me procedurat e tyre të ndërmjetësimit, trajnojnë dhe certifikojnë ndërmjetësuesit dhe ofrojnë shërbime të ndërmjetësimit me kosto të ulët ose pa kosto për palët. Ato përdoren shpesh për kontestet me kosto të ulët ose për raste kur paraja nuk janë çështja kryesore, siç janë familjare. Ato mund të jenë gjithashtu të dobishme për bizneset e vogla ose si pjesë e një fushate për të prezantuar ndërmjetësimin tek akterët kryesorë (shih *KAPITULLI 2: Hisedarët: Palët dhe Institucionet që Formësojnë ZAK-në*).

Shoqata e ndihmës juridike në Pakistan (LAS)

LAS është një organizatë jofitimprurëse që punon për të rritur qasjen në drejtësi duke i ndihmuar komunitetet të zgjidhin kontestet pa shkuar në gjykatë, duke zbutur mbingarkesën e gjykatave dhe duke ofruar zgjidhje më të shpejta për ata që kanë nevojë. Për këtë qëllim, LAS krijoi partneritet me gjyqësorin e Pakistanit për të pilotuar programe të ndërmjetësimit, për të ofruar trajnime për ndërmjetësim për 450 avokatë dhe gjyqtarë dhe për të ofruar shërbime të ndërmjetësimit drejtpërdrejt për përdoruesit. Që nga përfundimi i programit pilot, LAS ka vazhduar të zgjerojë rrjetin e vet të ndërmjetësve përmes programeve kombëtare të trajnimit.

Gjykatat janë gjithashtu vendet kryesore për ndërmjetësim dhe, në disa vende, ato kanë qenë të dobishme në zgjerimin e përdorimit të tyre. Shpesh, gjykatat iniciojnë protokolle të ndërmjetësimit për të zvogëluar grumbullimin e rasteve dhe për t'u ofruar palëve qasje më të shpejtë dhe më të lirë në zgjidhjen e kontesteve. Disa sisteme gjyqësore e mandatojnë ndërmjetësimin përpara se rasti të mund të kalojë në gjykatë. Sisteme tjera lejojnë referimin në ndërmjetësim nga gjyqtari i caktuar në çastet kritike gjatë ecursë së një rasti, ose vendosin referim të detyrueshëm të ndërmjetësimit për lloje specifike të rasteve ose në faza tëaktuara të procesit gjyqësor. Gjykatat mund të zhvillojnë procedura ndërmjetësimi, të trajnojnë dhe certifikojnë ndërmjetësuesit, ose thjesht t'i referojnë palët tek ofruesit e jashtëm të ndërmjetësimit me një udhëzim për të marrë pjesë.

Ndërmjetësimi i ofruar përmes gjykatave shpesh i nënshtrohet rregullave të ndërmjetësimit të krijuara nga gjykata. Rastet e ndërmjetësuara përmes një programi gjyqësor kanë një aktër kryesor shtesë – gjyqtarin e caktuar – dhe për këtë arsye mund të jenë më pak të sigurta për sa i përket konfidencialitetit sesa një proces privat. Palët duhet të njoftohen për çdo përjashtim nga konfidencialiteti përpara se të fillojnë. Ndërmjetësimi përmes gjykatës shpesh ofrohet me kosto të reduktuar për palët dhe ndonjëherë ofrohet falas.

Angazhimi i shteteve në ndërmjetësim

Shtetet dhe subjektet e tjera që kanë shumë rregulla shpesh pretendojnë se nuk mund t'i zgjidhin kontestet përmes një procesi konsensual, siç është ndërmjetësimi. Kjo është njëkohësisht një keqkuptim dhe një mundësi e humbur. Përderisa disa konflikte janë më të përshtatshme për gjykim, në shumë situata, ndërmjetësimi mund të japë një zgjidhje më të rafinuar, të përshtatur dhe të zbatueshme. Një shtet mund të ndërmjetësojë duke filluar nga kontestet administrative te riorganizimet transformuese të politikave njësoj siç bëjnë palët private.

Çelësi i pjesëmarrjes produktive të një entiteti shtetëror në ndërmjetësim është identifikimi dhe fuqizimi i aftësisë së vendimmarrësit për ta detyruar ligjërisht shtetin të pranojë marrëveshjet e negociuara. Këta individë duhet të kenë njohuri thelbësore për kontestin, të jenë në dijeni për individët dhe zyrat e ndryshme brenda shtetit, pëlqimi i të cilëve do të kërkohet për ta zgjidhur kontestin, dhe të jenë të autorizuar për të negociuar në emër të shtetit. Rrallë ndodh që këtë rol ta ketë vetëm një person. Në vend të kësaj, zyrat shtetërore duhet të synojnë të identifikojnë pozitat ose njerëzit që, së bashku, do të marrin vendime në emër të shtetit. Ky individ ose organ i koordinuar duhet të jetë i mbrojtur nga hakmarrjet politike.

Ndërmjetësuesit e caktuar për kontestet që përfshijnë shtetin duhet të përpiqen gjithashtu të kuptojnë strukturën vendimmarrëse të shtetit. Ata duhet ta dinë se shtetet nuk janë aq të shkathëta sa palët private dhe shpesh u duhet kohë shtesë për të shqyrtuar dhe për të dorëzuar propozimet. Ndryshimet në peizazhin politik mund të ndikojnë në rrjedhën e një ndërmjetësimi. Kjo mund të shkaktojë zhgënjim dhe gjithashtu mund të krijojë mundësi.

Kur shteti pranon të marrë pjesë në ndërmjetësim për të zgjidhur kontestet, vetë procesi mund të bëhet një mjet për hartimin e politikave komplekse. Individët dhe organizatat që mund të kundërshtojnë shtetin punojnë së bashku për të bërë hapat e mëtejshëm. Në vend se të arrihet një fitore ose humbje në një rast të gjykuar (i cili mund të zgjasë me vite ose dekada, varësisht nga çështjet), burimet kolektive të akterëve kryesorë të ndryshëm mund të shfrytëzohen për të gjetur një zgjidhje. Burimet e dedikuara për adresimin e dëmeve të së kaluarës mund të ripërdoren për të hartuar

sisteme të zhvilluara brenda një afati kohor dhe me një kosto që shteti mund ta përballojë.

RASTI STUDIMOR:

Lidhur me: Aktivitetet policore në Qytetin e Nju Jorkut gjatë demonstratave të verës 2020

Kontesti

Përgjigja e Departamentit të Policisë së Nju Jorkut ndaj protestave të vitit 2020 pas vdekjes së George Floyd në duart e ish zyrtarit policor të Minneapolisit, Derek Chauvin, rezultoi në ngritjen e një padie komplekse shumëpalëshe kundër qytetit. Rasti përfshinte Departamentin e Policisë së Qytetit të Nju Jorkut (NYPD), Prokuroren e Përgjithshme të Shtetit, Letitia James, Unionin për Liritë Civile të Nju Jorkut, Shoqatën e Ndihmës Juridike, tri sindikata të policisë dhe paditës individuale.

Zgjidhja

Palët ndërmjetësuan një sërë reformash gjithëpërfshirëse për të ndryshuar mënyrën se si policia e NYPD-së reagon ndaj protestave. Palët vendosën "nivele" të qarta të reagimit ndaj protestave, ndaluan praktika të caktuara policore, forcuan mbrojtjen e shtypit dhe krijuan mbikëqyrje të pavarur - reforma që adresuan shqetësimet e ngritura lidhur me qasjen e NYPD-së ndaj protestave të vitit 2020. Miratimi i gjyqtarës Colleen McMahon ka nxjerrë në pah se zgjidhja e ndërmjetësuar i shërbente interesit publik. Pjesëmarrja e gjerë dhe hartimi i negociuar i reformave e bënë marrëveshjen inovative dhe të qëndrueshme.

Ndërmjetësim për Kontestet e Investimeve

Siç u diskutua në *KAPITULLI 4: Përmbledhje e Arbitrazhit*, shtetet përballen gjithashtu me pretendime të drejtpërdrejta nga investitorët e huaj, siç është rasti sipas dispozitave për zgjidhjen e kontesteve të traktateve dypalëshe të investimeve (BIT) ose marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare për nxitjen e investimeve (IIA). Për shkak të kohës dhe kostos së madhe të arbitrazhit investitor-shtet, shtetet po i drejtohen gjithnjë e më shumë ndërmjetësimit për të zgjidhur kontestet e investimeve, para dhe pasi të jenë ngritur paditë. Shtetet hyjnë në ndërmjetësimin e kontesteve të investimeve në disa mënyra, duke përfshirë në mënyrë shprehimore si rregull, ndërmjetësimin e investimeve në marrëveshjet e tyre ndërkombëtare dhe duke dhënë pëlqimin post hoc për ndërmjetësim me investitorët e huaj.

Institucionet e ndërmjetësimit të investimeve

Disa institucione ofrojnë shërbime administrative për ndërmjetësimin e investimeve. Ndërmjetësimi institucional ofron disa përparësi krahasuar me ndërmjetësimin ad hoc, duke përfshirë uljen e pasigurisë, kostove të transaksioneve dhe barrës organizative për qeveritë që menaxhojnë kontest komplekse investitor-shtet. Shërbimet përfshijnë ndihmë në gjetjen e një ndërmjetësi, administrimin e çështjes, strukturimin e procesit dhe ofrimin e një vendi neutral për kontestet delikate.

Përparësitë e ndërmjetësimit për investime pasqyrojnë ato të ndërmjetësimit në kontekste të tjera, duke mundësuar krijimin e zgjidhjeve kreative, të nxitura nga partia, të cilat, ia mundësojnë shtetit të ruajë marrëdhëniet e veta me investitorët kryesorë të huaj. Ndërmjetësimi i investimeve ofron gjithashtu një zgjidhje me kosto të ulët për kontestet e investimeve që përndryshe mund të çonin në procedura të kushtueshme arbitrazhi dhe në rrezikun e dëmshpërblimeve të konsiderueshme monetare kundër shtetit.

Megjithatë, ndërmjetësimi në investime mund të paraqesë sfida strukturore që shtetet duhet t'i adresojnë. Shtetet shpesh hezitojnë të zgjidhin kontestet e investimeve ose të japin pëlqimin për procesin e ndërmjetësimit, përmes të cilëve mund të shqyrtohet mundësia e zgjidhjes. Shpesh ka një shkëputje operative midis agjencisë shtetërore ose ministrisë së përfshirë në investim dhe agjencisë së përfshirë në kontestin e investimit. Ministrinë shtetërore për prokurim, financa ose infrastrukturë që ndërveprojnë me investitorët e huaj shpesh kanë pak staf, që do të thotë se zyrtarët kanë kapacitet të kufizuar për të kontribuar në kontestet e vazhdueshme. Këto shkëputje praktike çojnë në asimetri në të kuptuarit e historikut të kontestit dhe qasjen në informacionin përkatës, dhe gjithashtu vështirësojnë aftësinë e shtetit për të vepruar si një entitet i unifikuar, duke cënuar parimin qendror të vetëvendosjes në ndërmjetësim.

Ngjashëm, stimujt e brendshëm të shteteve shpesh nuk janë të organizuar mirë për të zgjidhur kërkesat e investimeve përpara se të jetë lëshuar një vendim ose vendim gjyqësor kundër tyre. Edhe kur kontesti i një investitori ka njëfarë baze (dhe mund të zgjidhet në mënyrë të arsyeshme më herët për një shumë të negociuar), shumë zyrtarë publikë hezitojnë të raportojnë se kanë paguar me dëshirë për pretendimet e bëra në kontestet e investimeve, të cilat mund të jenë të profilit të lartë dhe shpesh të ndjeshme politikisht,

sepse ato financohen nga paratë e taksapaguesve. Këto sfida strukturore përkeqësohen nga ekspozimi ndaj përgjegjësisë politike apo edhe personale me të cilën përballen zyrtarët publikë për shkak se shihen sikur e kanë zgjidhur një kërkesë në vend që ta kenë luftuar atë.

Edhe pse ka sfida të konsiderueshme për pjesëmarrjen e shtetit në ndërmjetësimin e kontesteve të investimeve, ato duhet të marrin në konsideratë përfitimet e mundshme monetare dhe të dyanshme nga një zgjidhje e negociuar. Ndërmjetësimi mund të ndodhë në çdo kohë, para, gjatë ose edhe pasi një arbitrazh të ketë përfunduar zyrtarisht, dhe nuk kërkon një marrëveshje paraprake të shprehur mes palëve. Në shumë raste, edhe pasi të jetë lëshuar një vendim në favor të një investitori të huaj, palët mund të marrin në konsideratë mjete juridike alternative dhe të zvogëlojnë rrezikun e ekzekutimit. Çdo zbritje e detyrimit përfundimtar nga një shumë që do kishte qenë ndryshe më e lartë mund të shihet si një "fitore" nga perspektiva e shtetit.




Fig 3.5: Mundësi të përbashkëta për të filluar ndërmjetësimin

Burimet e dobishme

Konventat, Ligjet Model dhe Rregullat kryesore

- Procedurat e Ndërmjetësimit të Shoqatës Amerikane të Arbitrazhit (2009): <https://www.icdr.org/sites/default/files/Mediation%20Procedures%20of%20the%20American%20Arbitration%20Association%20Oct%2001%2C%202009.pdf>
- Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor, Rregullat Procedurale të Ndërmjetësimit (2025): <https://simc.com.sg/sites/default/files/content-files/SIMC%20Mediation%20Rules%202025.pdf>
- Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor, Protokolli (pa datë): [https://www.judiciary.gov.sg/docs/default-source/sicc-docs/lml-protocol-\(final\).pdf](https://www.judiciary.gov.sg/docs/default-source/sicc-docs/lml-protocol-(final).pdf)
- Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor, Klauzolat Model të SIMC-së për Ndërmjetësim (pa datë): <https://simc.com.sg/model-clause>
- Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor, Rregullat e Ndërmjetësimit (2025): <https://simc.com.sg/sites/default/files/content-files/SIMC%20Mediation%20Rules%202025.pdf>
- Protokolli JAMS, Ndërmjetësuesit dhe Shërbimet e Ndërmjetësimit (pa datë): <https://www.jamsadr.com/mediation?tab=overview>
- Protokolli i CPR-së, Ndërmjetësimi (pa datë): <https://drs.cpradr.org/rules/mediation>
- Qendrat Federale Gjyqësore, Udhëzuesi i Ndërmjetësimit të Patentave (2019): https://www.fjc.gov/sites/default/files/materials/05/Patent_Mediation_Guide.pdf

Udhëzimet dhe Komentet

- UNCITRAL, Udhëzime për Ndërmjetësim për Kontestet Ndërkombëtare të Investimeve (2024): https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/2401497e_mediation_guidelines_-ebook_eng.pdf
- Qendra Federale Juridike Amerikane, Njohuritë për Ndërmjetësuesin e Gjykatës Federale (2019)
- Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve, Dokument Njoftues për Ndërmjetësimin e Investimeve (2021):

Lista jopërfundimtare e ofruesve të ndërmjetësimit institucional

- ➔ Oda Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)
- ➔ Shërbimet e Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit Gjyqësor (JAMS)
- ➔ Shoqata Amerikane e Arbitrazhit - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve (AAA-ICDR)
- ➔ Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor (SIMC)

Lista jopërfundimtare e institucioneve për ndërmjetësim në investime

- ➔ Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID)
- ➔ Qendra Ndërkombëtare e Ndërmjetësimit në Singapor (SIMC)
- ➔ Qendra për Zgjidhjen Efektive të Kontesteve (CEDR)
- ➔ Instituti i Arbitrazhit të Odës së Tregtisë së Stokholmit (SCC)
- ➔ Oda Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)

KAPITULLI 4:

Përmbledhje e

Arbitrazhit




Fig 4.1: Procesi i Zgjidhjes Alternative të Kontesteve

Përkufizimi i Arbitrazhit

Arbitrazhi është një metodë private dhe konsensuale e zgjidhjes së kontesteve ku palët pajtohen t'ia paraqesin kontestet e tyre një gjykate private (p.sh. joqeveritare) në vend të një gjykate kombëtare. Arbitrazhi rrjedh nga një marrëveshje specifike midis palëve, qoftë një kontratë e pavarur (p.sh. një "marrëveshje për nënshtrim"), një klauzolë brenda një kontrate më të madhe (p.sh. një "klauzolë arbitrazhi"), një traktat investimi (p.sh. e ashtuquajtur "ofertë e përhershme për arbitrazh" ose "klauzolë unilaterale për arbitrazh") apo legjislacion kombëtar për investime.

Ndryshe nga ndërmjetësimi, në të cilin një palë e tretë neutrale lehtëson negociatat, një arbitër ka fuqinë të merrë një vendim përfundimtar, detyrues dhe të ekzekutueshëm. Në thelb, arbitrazhi shërben si një alternativë neutrale ndaj procesit gjyqësor, duke e shkëputur në mënyrë efektive kontestin nga sistemi ligjor kombëtar i secilës palë (shih *KAPITULLI 3: Ndërmjetësimi*).

Llojet e Arbitrazhit

Arbitrazhi është në thelb fleksibil dhe përshtatet lehtësisht me natyrën e palëve dhe industrinë e përfshirë. Ky kapitull përqendrohet në përkufizimin dhe njoftimin e lexuesit me dy kategoritë e rëndësishme të arbitrazhit: arbitrazhi tregtar, i bazuar në kontratë dhe arbitrazhi investor-shtet (ISDS). Ky dallim qëndron në thelb në bazën e pëlqimit:

Kontrata	Arbitrazhi Investitor-Shtet
Buron nga një kontratë specifike midis palëve (qofshin individë private, kompani dhe/ose shtete apo ndërmarrje shtetërore) që veprojnë në një kapacitet tregtar.	Buron nga një traktat dypalësh ose shumëpalësh, një kontratë investimi midis një investitori të huaj dhe një qeverie, ose nga ligji i investimeve të huaja ku një shtet sovran ofron pëlqimin e vet të palëkundur për të arbitruar kontestet me investitorët e huaj.

Fig 4.2: Bazat tipike të pëlqimit

Përtej këtij dallimi, procesi shpesh kategorizohet sipas mënyrës se si administrohet. Palët duhet të zgjedhin midis *Arbitrazhit Institucional* (në të cilin rasti administrohet nga qendrat e arbitrazhit që ofrojnë menaxhim dhe shqyrtim të rasteve) dhe *Arbitrazhit Ad Hoc* (shpesh duke përdorur Rregullat e UNCITRAL-it, në të cilat palët dhe tribunali e menaxhojnë vetë administrimin). Derisa arbitrazhi ad hoc ofron fleksibilitet maksimal, ai kërkon bashkëpunim dhe mund të devijohet nga palët jobashkëpunuese dhe rezistente, pa pasur një institucion për ta mbajtur procesin në rrugën e duhur. Prandaj, palët ndonjëherë caktojnë një institucion për të administruar arbitrazhin sipas rregullave të arbitrazhit ad hoc.

Një nga pikat më të forta të arbitrazhit është aftësia e palëve për ta përshtatur atë sipas nevojave të një industrie specifike. Industritë që kanë zhvilluar procedura të personalizuar për t'iu përshtatur realiteteve të tyre tregtare përfshijnë:




Fig 4.3: Industritë e përgjithshme me procedura të specializuara

Kur palët i referohen rregullave institucionale, një referencë e tillë shërben si kornizë bazë për procesin. Në arbitrazhin ndërkombëtar sot, palët zakonisht vazhdojnë me arbitrazh institucional. Procesi zakonisht zgjat 18-24 muaj dhe përfshin një shkëmbim të plotë të parashtresave me shkrim, paraqitjen e dokumenteve, dëshminë e dëshmitarëve dhe një seancë dëgjimore. Në përgjigje ndaj shqetësimeve në lidhje me rritjen e kohëzgjatjes dhe kostove të procedurave të arbitrazhit, shumë institucione të arbitrazhit kanë krijuar procedura të përshpejtuara për kontestet me vlerë të ulët ose me më pak dokumente. Në këto çështje, institucione të ndryshme të arbitrazhit ofrojnë një 'rrugë të përshpejtuar' ose si një zgjedhje me vullnet për pjesëmarrje *opt-in* (p.sh. si një zgjedhje e qëllimshme në marrëveshjen e arbitrazhit ose përmes parashtresave kur lind kontesti) ose si një zgjedhje me refuzim *opt-out* (p.sh. si pjesë e rregullave institucionale). Për shembull, Rregullat e Përshpejtuara të ICC-së zbatohen automatikisht për kontestet me vlerë 3 milionë dollarë amerikanë ose më pak (përveç nëse palët zgjedhin shprehimisht të mos marrin pjesë *opt out*), dhe kërkojnë që tribunali të japë vendimin e vet përfundimtar brenda gjashtë muajve. Ngjashëm, AAA-ICDR miraton sistemin e 'optout'(refuzimit për të marrë

pjesë) për çështje të caktuara 'me vlerë të ulët'. Sipas kornizës AAA-ICDR, "procedurat e përshpejtuara" zbatohen në çdo rast kur shumat në kontest nuk tejkalon 250.000 USD. Pavarësisht kësaj, palët janë të lira t'i referohen procedurave të përshpejtuara për çështje lidhur me kërkesa me çfarëdo shume (brenda kufijve të rregullave të detyrueshme, siç është procesi i rregullt ligjor).

Institucione të tjera, për shembull Oda Ekonomike e Stokholmit (SCC), miraton regjimin e 'opt-in' (pjesëmarrjes së vullnetshme), ku palët duhet të miratojnë shprehimisht rregullat e përshpejtuara ose në klauzolën e tyre të arbitrazhit ose përmes një marrëveshjeje me parashtresa.

Kontrata për Arbitrazh

Marrëveshja për arbitrazh është një metodë private dhe konfidenciale e zgjidhjes së kontesteve, e bazuar në marrëveshjen e palëve. Megjithatë, ajo nuk është tërësisht e shkëputur nga legjislacioni kombëtar. Për shembull, ajo mbështetet në "ligjin procedural" si ligj i zbatueshëm për procedurën e arbitrazhit. Kjo rezulton në një vendim të formës së prerë dhe detyrues, që do të thotë se në përgjithësi nuk ka të drejtë ankimi në themel, por vetëm arsye të kufizuara për anulim bazuar në defekte procedurale. Dy arsye shtesë për anulim janë mosarbitrabiliteti (*mungesë e kompetencës*) dhe politika publike, të cilat kërkojnë një nivel të caktuar të rishqyrtimit të argumenteve. Megjithatë, pragjet për sukses mbi baza të tilla janë qëllimisht shumë të larta.

Korniza ligjore

Derisa arbitrazhi ndërkombëtar është një krijesë nga pëlqimi i palëve, ai nuk ekziston në një vakum ligjor dhe grupet e mëposhtme të rregullave ligjore globale dhe kombëtare e rregullojnë atë:

- ➔ **Konventa e Nju Jorkut (1958):** Ky është themeli i sistemit. E ratifikuar nga më shumë se 170 vende, u kërkon gjykatave kombëtare të zbatojnë marrëveshjet e arbitrazhit (për shembull, duke i referuar palët në arbitrazh) dhe të ekzekutojnë vendimet e huaja sikur të ishin vendime të gjykatave vendase, me përjashtime shumë të ngushta.
- ➔ **Legjislacioni kombëtar:** Ky është zakonisht ligji i arbitrazhit në seli. Rregullon procedurën e arbitrazhit aty ku nuk janë zgjedhur rregullat e arbitrazhit, përcakton rregulla të detyrueshme për palët dhe

arbitrin (p.sh. proces i rregullt ligjor dhe neutraliteti) dhe rregullon marrëdhënien midis arbitrazhit dhe gjykatave (p.sh. anulimi, betimi, kërkesat e përkohshme). Shumë ligje kombëtare të arbitrazhit bazohen në shkallë të ndryshme në Ligjin Model të UNCITRAL-it (p.sh. Singapori dhe Gjermania). Ligjet e tjera kombëtare të arbitrazhit nuk bazohen (p.sh. Ligji Federal i Arbitrazhit i SHBA-së).

- ➔ **Rregullat e Arbitrazhit:** Këto janë rregullat që rregullojnë procedurën në mënyrë të nënkuptuar nga palët që ushtrojnë autonominë e tyre si palë (p.sh. Rregullat AAA-ICDR, JAMS, ICC ose LCIA). E tërë korniza e rregullave inkorporohet me referencë, përveç nëse përjashtohen dispozita të veçanta. Rregullat e Arbitrazhit janë më të detajuara se ato që parashikohen në ligjet kombëtare të arbitrazhit dhe për këtë arsye mund të trajtohen si një "manual i përdoruesit" që rregullon ecurinë e përditshëm të rastit, duke përfshirë afatet për paraqitjen e parashtresave, emërimin e arbitrave dhe lëshimin e vendimit të arbitrazhit.

Përveç këtyre “ligjeve të forta”, praktika udhëhiqet nga ligji i butë, i cili përfshin udhëzimet dhe praktikat më të mira jo-detyruese, por që janë të pranueshme gjerësisht. Për shembull, Rregullat e Odës Ndërkombëtare të Avokatëve (IBA) mbi Marrjen e Provave ndihmojnë në kapërcimin e hendekut midis zbulimit të provave në stilin amerikan dhe kufizimeve të së drejtës civile në procedurën e provave. Për më tepër, Udhëzimet e IBA-s për Konfliktin e Interesit shërbejnë si standard global për konfliktin e interesit; domethënë, vlerësimi i paanshmërisë dhe pavarësisë së arbitrit dhe hartimi i një liste të situatave me konflikt të mundshëm interesi dhe për këtë arsye ku dhe kur këshillohet ose urdhërohet zbulimi i provave.

Koncepte kryesore ligjore

Ndërveprimi i këtyre ligjeve krijon rregullat specifike që rregullojnë arbitrazhin ndërkombëtar:

- ➔ **Autonomia e palëve:** Palët kanë lirinë të përcaktojnë procesin e tyre, duke përfshirë rregullat e tyre të arbitrazhit dhe arbitrat e emëruar nga palët, gjuhën, selinë dhe ligjin në fuqi. Gjykatat në përgjithësi nuk ndërhyjnë përveç nëse procesi shkel ligjin për proces të rregullt ose ligjet e detyrueshme.
- ➔ **Konfidencialiteti:** Ndryshe nga gjykimet në gjykata, arbitrazhi është privat. Megjithatë, konfidencialiteti nuk është automatik në

të gjitha juridiksionet. Sipas së drejtës angleze, është një detyrim i nënkuptuar; sipas Rregullave të UNCITRAL-it ose së drejtës amerikane, shpesh duhet të bihet dakord në mënyrë të qartë nga palët. E mbulon ekzistencën e arbitrazhit, dokumentet e paraqitura dhe vendimin përfundimtar.

- ➔ **Kompetenz-Kompetenz:** Tribunali i arbitrazhit ka juridiksionin për të përcaktuar juridiksionin e vet. Nëse një palë pretendon se klauzola e arbitrazhit është e pavlefshme, vetë arbitrat janë të parët që vendosin për këtë çështje. Gjykatat në përgjithësi nuk do të ndërhyjnë derisa gjykata të ketë dhënë vendimin e saj. Në SHBA, shumë do t'i referoheshin çështjeve të juridiksionit si "arbitrabilitet procedural". Prandaj, gjykatat amerikane shpesh merren me të ashtuquajturat "portë hyrëse" ose "çështje të pragut" të juridiksionit nën termin ombrellë për arbitrabilitetin procedural.
- ➔ **Ndashmëria e marrëveshjes së arbitrazhit:** Ndashmëria e një marrëveshjeje të arbitrazhit do të thotë që marrëveshja për arbitrazh trajtohet si një kontratë e pavarur, e ndarë nga kontrata kryesore në të cilën është përfshirë. Edhe nëse kontrata kryesore kontestohet, anulohet ose pretendohet të jetë e pavlefshme, marrëveshja e arbitrazhit do të ekzistojë si dokument i pavarur. Kjo siguron që një arbitër, jo një gjykatë, do të vendosë për çështjet që kanë të bëjnë me vlefshmërinë e kontratës.
- ➔ **Selia e arbitrazhit:** Selia është selia ligjore e arbitrazhit, që do të thotë e drejta kombëtare që rregullon kornizën procedurale. E drejta e selisë gjithashtu i jep kompetenca gjykatës dhe, më e rëndësishmja, përcakton se cilat gjykata kombëtare mund të vërtetojnë, anulojnë ose ndërhyjnë në procedurat e arbitrazhit. Selia nuk është domosdoshmërisht sinonim i vendit gjeografik ku zhvillohen seancat dëgjimore. Për shembull, një arbitrazh me "seli" në Londër i nënshtrohet mbikëqyrjes së gjykatave angleze, edhe nëse seancat dëgjimore mbahen fizikisht në Paris ose Singapor.

Kufijtë e "Kompetenz-Kompetenz"

Dallah Real Estate kundër Ministrisë së Çështjeve Fetare të Pakistanit (2010)

Faktet	Rezultati
Dallah, një kompani saudite, nënshkroi një Memorandum mirëkuptimi me një Trust pakistanez të krijuar nga Qeveria për të ndërtuar banesa për pelegrinët. Qeveria vetë nuk e kishte nënshkruar kontratën. Kur lindi kontesti, Dallah nisi arbitrazh kundër Qeverisë së Pakistanit, duke pretenduar se Qeveria ishte pala e vërtetë. Tribunali zbatoi parimin kompetenz-kompetenz. Tribunali vendosi që kishte juridiksion ndaj Qeverisë dhe lëshoi një vendim për dëmshpërblim.	Kur Dallah u përpoq ta ekzekutonte vendimin në Angli, Gjykata Supreme e Mbretërisë së Bashkuar refuzoi. Derisa një gjykatë ka të drejtë të vendosë fillimisht në juridiksionin e vet, Gjykata konstatoi se vendimi i gjykatës nuk është i formës së prerë. Gjykata bëri një rishqyrtim të plotë të çështjes së juridiksionit, konstatoi se Qeveria nuk ishte palë në marrëveshjen e arbitrazhit dhe refuzoi ta ekzekutonte vendimin. Kjo tregon se derisa arbitrat kanë fjalën e parë mbi juridiksionin, gjykatat në selinë e gjykatës ose në fazën e ekzekutimit e kanë fjalën e fundit.

Arbitrazhi Ndërkombëtar

Arbitrazhi ndërkombëtar i ka tejkaluar proceset gjyqësore si metodë e preferuar për zgjidhjen e kontesteve ndërkufitare. Në anketat globale, përdoruesit e arbitrazhit kanë përmendur në mënyrë të përsëritur faktorët e mëposhtëm si nxitës të vendimit për të zgjidhur kontestet e tyre nëpërmjet arbitrazhit:

- ➔ **Zbatueshmëria:** Sipas Konventës së Nju Jorkut, një vendim i arbitrazhit është më i lehtë për t'u ekzekutuar jashtë vendit sesa një vendim gjykatë. Për shembull, një vendim i gjykatës së SHBA vështirë mund të ekzekutohet në Kinë për shkak të mungesës së një traktati të ndërsjellë; megjithatë, një vendim i arbitrazhit i SHBA-së është i ekzekutueshëm në Kinë sipas Konventës.
- ➔ **Neutraliteti:** Në ujdite ndërkufitare, asnjëra palë nuk dëshiron të zvarritet në gjykatat e brendshme të palës tjetër. Arbitrazhi shpesh ofron një vend neutral në një vend të tretë.
- ➔ **Ekspertiza:** Palët mund të zgjedhin arbitra me njohuri specifike të industrisë, siç janë inxhinierët për kontestet në ndërtim ose ekspertët e energjisë për shqyrtimet e çmimeve të gazit, duke u siguruar që vendimmarrësit ta kuptojnë kontekstin teknik.

- ➔ **Fleksibiliteti:** Palët mund ta organizojnë procedurën ashtu siç e konsiderojnë të përshtatshme. Me marrëveshjen e të dyja palëve, ato mund të përcaktojnë madhësinë dhe numrin e parashtresave me shkrim, formatin e seancës dëgjimore, nëse do të ketë, dhe të caktojnë afatet kohore procedurale. Ky fleksibilitet është një devijim i rëndësishëm nga shumica e kodeve të procedurës civile që zbatohen në sistemet e brendshme gjyqësore.
- ➔ **Plotëfuqishmëria:** Vendimet e arbitrazhit janë përgjithësisht të plotfuqishme. Ndryshe nga sistemet gjyqësore që lejojnë vite të tëra për ankesa, ligjet e arbitrazhit zakonisht lejojnë anulimin vetëm për arsye të ngushta procedurale (p.sh. mungesa e procesit të rregullt ligjor), por jo nëse gjykata ka bërë një gabim faktik ose ligjor (megjithëse disa juridiksione si Anglia lejojnë ankesa të kufizuara për çështje ligjore).
- ➔ **Kostoja dhe Shpejtësia:** Të dyja kanë qenë tradicionalisht të dobishme në arbitrazh i cili ishte i thjeshtë dhe joformal. Në ditët e sotme, me zhvillimin më formal të arbitrazhit ndërkombëtar dhe me procedura më rigorozë, përfitime të tilla, të qarta si në libra shkollor, tani po vihen në pikëpyetje. Arbitrazhi i përshpejtuar u krijua pjesërisht për t'iu përgjigjur çështjes. Për shumë konteste, nuk është e qartë nëse kostoja dhe shpejtësia mbeten karakteristika kryesore të arbitrazhit ndërkombëtar. Megjithatë, një arbitrazh i strukturuar mirë me siguri mund të çojë në efikasitet të koston dhe shpejtësisë. Veç kësaj, procedura mesatare e arbitrazhit ndërkombëtar është ende më e shpejtë dhe më pak e kushtueshme sesa një proces gjyqësor kompleks në shumicën e juridiksioneve.

Zgjidhja e Kontesteve Investitor-Shtet (ISDS)

ISDS është një mekanizëm i rrënjosur në të drejtën ndërkombëtare publike që u lejon investitorëve të huaj të ngrenë pretendime drejtpërdrejt kundër një shteti nikoqir. Historikisht, nëse një shtet sekuestronte fabrikën e një investitori të huaj, e vetmja rrugëdalje e investitorit ishte gjykata vendase e shtetit që ka bërë sekuestrimin ose, si alternativë, të kërkonte ndihmë nga qeveria e tij e origjinës për të zgjidhur kontestin (p.sh. mbrojtje diplomatike). Për arsye politike, shteti investitor nuk ishte gjithmonë i interesuar të angazhohej në një përballje të tillë. Kur ishte (p.sh. kur investitori ishte i rëndësishëm), kontesti mund të përshkallëzohej edhe në diplomaci të luftanijeve (p.sh. presion me kërcënim për veprim ekonomik ose ushtarak). ISDS e depolitizon këtë fërkim duke i lejuar investitorit të

padisë shtetin nikoqir para një gjykate neutrale. Sistemi shkon në dobi si të investitorëve ashtu edhe shteteteve importuese të kapitalit: Shtetet bien dakord t'i nënshtrojnë lloje të caktuara të kontesteve arbitrazhit të pavarur për të tërhequr Investime të Huaja Direkte, derisa investitorët fitojnë mbrojtje ndaj rrezikut politik.

Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID) zë një pozicion unik brenda ekosistemit ISDS dhe merret me shumicën e ISDS-ve. I themeluar nën patronatin e Bankës Botërore nëpërmjet Konventës ICSID të vitit 1965, ICSID është i vetmi institucion i dizajnuar ekskluzivisht për kontestet investitor-shtet. Ndryshe nga institucionet tregtare (si ICC ose LCIA), të cilat veprojnë sipas ligjit procedural të juridiksionit të tyre kombëtar, ICSID funksionon si një sistem i pavarur dhe i shkëputur nga sistemi vendas, ku gjykatat vendase kanë një rol të kufizuar në procedurat e ICSID-it. Në vend të kësaj, Konventa ICSID dhe rregullat e ICSID përmbajnë të gjitha dispozitat e kërkuara për arbitrimin e kontesteve, duke përfshirë ato që adresojnë fillimin e procedurave, juridiksionin, procedurën, vendimin që do të jepet nga tribunali, mjetet juridike pas vendimit dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimit. Prandaj, një vendim i ICSID-it nuk mund të "anashkalohet" nga një gjyqtar i një vendi; ai i nënshtrohet vetëm një mekanizmi të brendshëm të anulimit.

Korniza Ligjore

Sistemi mbështetet në një rrjet të gjerë të Traktateve Dypalëshe për Investime (BIT) dhe Traktateve Shumëpalëshe (MIT) (siç janë Marrëveshja Shtetet e Bashkuara-Meksikë-Kanada dhe Traktati i Kartës së Energjisë). Në raste të caktuara, shtetet gjithashtu ofrojnë mbrojtje të tilla për të gjithë investitorët dhe investimet e huaja që kualifikohen në ligjet e tyre kombëtare të investimeve, ose përmes një kontrate të investimit. Këto traktate në përgjithësi përmbajnë ofertën e përherëshme të pëlqimit të shteteve për të arbitruar kontestet e ardhshme.

Meqenëse korniza ligjore dhe ligji i zbatueshëm në ISDS është e drejta ndërkombëtare publike, Konventa e Vjenës për të Drejtën e Traktateve (VCLT) luan një rol të spikatur në interpretimin e BIT-ve dhe MIT-ve përkatëse. Dispozita më e rëndësishme është Neni 31 që përcakton rregullin e përgjithshëm të interpretimit, dhe në veçanti paragrafi (1) që thotë se "Një traktat do të interpretohet me mirëbesim në përputhje me kuptimin e zakonshëm që u jepet kushteve të traktatit në kontekstin e tyre dhe duke marrë parasysh objektin dhe qëllimin e tij". Paragrafët (2) dhe (3)

artikulojnë se çfarë është "konteksti". Nenet 32-33 kanë një funksion më të kufizuar. Neni 32 artikulon se kur dhe si mund të përdoren mjetet plotësuese të interpretimit. Neni 33 merret me interpretimin e traktateve që janë autentike në më shumë se një gjuhë (p.sh. Konventa e ICSID dhe e Nju Jorkut).




Fig 4.4: Korniza tipike e Traktatit dypalësh të investimeve dhe marrëdhënieve mes palëve

Kërkesat juridiksionale dhe atribrimi

Përpara se një gjykatë të dëgjojë bazën e një kontesti, parashtruesi i kërkesës duhet të përmbushë kërkesat juridiksionale. Ndryshe nga arbitrazhi i kontratës, ku kontrata është burimi kryesor i juridiksionit, ISDS kërkon që parashtruesi i kërkesës të përshtatet brenda përkufizimeve rigoroze të traktatit në fuqi. Katër parakushtet për juridiksionin e një Tribunali janë:

- ➔ ***Ratione Voluntatis***: Duhet të ketë pëlqim, d.m.th. shteti duhet të ketë ofruar të arbitrojë me investitorin, i cili duhet të ketë shprehur pranimin e tij ose të saj (p.sh. duke kërkuar arbitrazh sipas traktatit në fuqi).
- ➔ ***Ratione Materiae***: Duhet të ketë investim të kualifikuar. Përkufizimi gjendet kryesisht në traktatin ndërkombëtar të investimeve që është në fuqi. Konventa ICSID ka kërkesën e vet për investim, të cilën disa (jo të gjithë) e trajtojnë si një kërkesë shtesë (e quajtur "testi i bravës së dyfishtë" ose "testi i tytave të qiftës"). Jo çdo transaksion biznesi kualifikohet si "investim". Kontratat e thjeshta të shitjes ose

transaksionet tregtare të njehershme përjashtohen në përgjithësi. Shumë tribunale (por jo të gjitha) shpesh e zbatojnë Testin Salini (që rrjedhë nga *Salini kundër Morokut*), i cili kërkon që aktiviteti të demonstrojë: (1) një kontribut me para ose asete, (2) një kohëzgjatje specifike, (3) një element rreziku dhe (4) një kontribut në zhvillimin ekonomik të shtetit pritës.

- ➔ ***Ratione Personae***: Duhet të ketë investitor të kualifikuar. Përkufizimi gjendet kryesisht në traktatin ndërkombëtar të investimeve që është në fuqi. Parashtruesi i kërkesës duhet të jetë shtetas i shtetit të origjinës. Ekziston një dallim midis personave fizikë dhe personave juridikë, duke shkaktuar çështje të ndryshme. Një çështje e rëndësishme praktike këtu është shtetësia e dyfishtë. Sipas Konventës ICSID (Neni 25), një person me shtetësi të dyfishtë që mban edhe shtetësinë e shtetit nikoqir shpesh nuk mund të ngrit një kërkesë. Për më tepër, supozojmë se traktati përmban një klauzolë për Mohimin e Përfitimeve. Në atë rast, një parashtrues kërkesë korporativ duhet të dëshmojë se nuk është thjesht një kompani fiktive e themeluar në shtetin nikoqir, por se ka "aktivitete të konsiderueshme afariste" atje, duke i dhënë të drejtë të kërkojë përfitimet e traktatit.
- ➔ ***Ratione Temporis***: Traktati duhet të zbatohet në kohë. Një gjykatë ka juridiksion mbi kontestet që rrjedhin nga veprime ose mosveprime që kanë ndodhur brenda një periudhe të caktuar, zakonisht pas hyrjes në fuqi të një marrëveshjeje të arbitrazhit, traktati ose instrumenti ligjor përkatës. Megjithatë, përcaktimi i kohës kur lind ose kristalizohet një "kontest" aktual varet shumë nga faktet dhe shpesh është objekt i një debati të rëndësishëm.

Përveç juridiksionit, shpesh ka çështje të pranueshmërisë që manifestohen në ISDS. Çështjet e pranueshmërisë përfshijnë:

- ➔ ***Periudha e pritjes (cooling-off period)***: Për më tepër, shumë traktate përmbajnë një periudhë të detyrueshme për pritje (zakonisht 6 muaj) që i kërkon investitorit të përpiqet të zgjidhë çështjen përpara se të paraqesë kërkesë për arbitrazh. Derisa disa tribunale e shohin këtë si një çështje procedurale dhe të zgjidhshme, të tjerat e konsiderojnë atë një pengesë juridiksionale (shih *KAPITULLI 3: Ndërmjetësimi*).
- ➔ ***Zgjedhja e Pakthyeshme (Fork-in-the-Road)***: Parasheh që investitori duhet të zgjedhë midis procesit gjyqësor përmes gjykatave vendase ose ISDS-së, dhe se zgjedhja e bërë është përfundimtare. Prandaj, nëse

investitori ka zgjedhur gjykatën vendase, ai mund të ketë humbur të drejtën për ISDS edhe nëse gjykata do të kishte juridiksion.

- **Res Judicata/Litis Pendens:** Ndonjëherë çështja në fjalë (ose një pjesë e saj) veçse është përmbyllur përfundimisht ose është aktualisht objekt shqyrtimi në një vend tjetër (arbitrazh ose gjykatë). Çështje të tilla duhet ta shpallin kërkesën ose të pezulluar ose të hedhur poshtë (me ose pa paragjykim).

RAST STUDIMOR:

Çfarë përbën një "investim"?

Salini Costruttori S.p.A. kundër Mbretërisë së Marokut (2001)

Faktet	Rezultati
Një kompani italiane ndërtimi e kontraktuar për të ndërtuar një autostradë në Marok. Kur lindi një kontest për pagesat dhe vonesat, Maroku pretendoi se kjo ishte një kontest i thjeshtë për një kontratë ndërtimi që i përkiste gjykatave marokene, jo një "investim" sipas BIT-it.	Tribunali nuk u pajtua, duke përcaktuar të famshmin "Testin Salini". Ai vendosi që projekti i ndërtimit ishte një investim sepse përfshinte një kontribut të konsiderueshëm, shtrihej në një kohëzgjatje të gjatë, përfshinte rrezikun operacional dhe kontribuonte në zhvillimin e infrastrukturës së shtetit.

Atribuimi për veprime që shkelin detyrimet ligjore ndërkombëtare: Projekt-Nenet e Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë e Shteteve (ARSIWA)

ARSIWA rregullon rrethanat që përjashtojnë veprimet e paligjshme. Këto përfshijnë domosdoshmërinë, forcën madhore, vetëmbrojtjen dhe shqetësimin (shih nenet 20-27). Një pikë e shpeshtë e konfuzionit për zyrtarët qeveritar është koncepti i Atribuimit. Sipas Projekt-Neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare (ILC) mbi Përgjegjësinë e Shteteve, Shteti është përgjegjës për:

- **Organet e Shtetit (shih Nenin 4 ARSIWA):** Kjo përfshin degët ekzekutive, legjislative dhe gjyqësore në të gjitha nivelet e qeverisjes. Një shkelje e kryer nga një kryetar komune ose një gjyqtar i gjykatës së qarkut mund t'i atribuohet shtetit po aq sa një veprim i Presidentit ose Parlamentit.

- ➔ **Entitetet që ushtrojnë autoritet qeveritar (shih Nenin 5 ARSIWA):** Një entitet privat ose gjysmëprivat (si një kompani e privatizuar e komunalive) mund ta detyrojë shtetin, nëse është i autorizuar me ligj, për të ushtruar elementë të autoritetit qeveritar (p.sh. dhënia e licencave ose sekuestrimi i tokës).
- ➔ **Veprimi i drejtuar ose e kontrolluar nga shteti (shih Nenin 8 ARSIWA):** Veprimet e ndërmarrjeve shtetërore, si kompanitë kombëtare të naftës, në përgjithësi *nuk* i atribuohen shtetit kur ato veprojnë në fushën tregtare. Megjithatë, nëse qeveria e udhëzon ndërmarrjen shtetërore të shkelë një kontratë për arsye politike, ky veprim mund t'i atribuohet shtetit.

Planifikimi i Traktatit të Investimeve

Për juristët e korporatave, ISDS nuk është vetëm një mjet për zgjidhjen e kontesteve; është një mjet planifikimi që mund të përdoret për të zbutur rrezikun. Investitorët duhet të marrin në konsideratë "planifikimin e traktatit" në fillim të një projekti. Kjo përfshin strukturimin e investimit përmes një entiteti korporativ në një juridiksion që ka një BIT të favorshëm me shtetin nikoqir, për shembull, si më poshtë:




Fig 4.5: Opsionet e Mbrojtjes së Investimeve për një Investitor të Huaj Direkt Potencial

Megjithatë, koha është e rëndësishme. Ristrukturimi i një kompanie për të fituar mbrojtje nga traktati *pasi* të ketë lindur një ose mund të parashikohet kontest, konsiderohet abuzim i procesit që mund të çojë në hedhjen poshtë të kërkesës.

Mbrojtje Substanciale

Pasi të jenë përcaktuar juridiksioni dhe atribuiimi, tribunali vlerëson nëse veprimet e pretenduara të shtetit kanë shkelur standardet specifike të traktatit. Dispozitat më të përdorura kanë të bëjnë me mbrojtjet e mëposhtme të traktateve:

➔ **Shpronësimi:** E drejta ndërkombëtare nuk e ndalon shpronësimin; ajo ndalon shpronësimin pa kompensim. Kjo përfshin si shpronësimin *direkt* (një transferim i detyrueshëm ligjor i titullit ose sekuestrim të plotë të pasurisë) ashtu edhe shpronësimin *indirekt* (masa që nuk transferojnë titullin, por e privojnë në mënyrë të konsiderueshme

investitorin nga përdorimi ekonomik dhe gëzimi i investimit të tij, në mënyrë ekuivalente me një marrje direkte).

- ➔ **Trajtim i drejtë dhe i barabartë (FET):** Një mbrojtje e gjerë dhe gjithëpërfshirëse që kërkon që shteti nikoqir ta trajtojë investitorin në mënyrë të drejtë dhe të barabartë (domethënë, që nuk mund të diskriminojë investitorin ose të imponojë masa të paarsyeshme ose arbitrare). Shpesh e formuluar në mënyrë të përgjithshme, kjo mbrojtje e traktatit ka evoluar për të mbuluar pritshmëritë legjitime, mohimin e drejtësisë, arbitraritetin dhe diskriminimin.
- ➔ **Trajtimi kombëtar:** Shteti nuk duhet ta trajtojë investitorin ose investimin e huaj në mënyrë më pak të favorshme sesa investitorët ose investimet e vendase në rrethana të ngjashme.
- ➔ **Kombi më i favorizuar (MFN):** Shteti nuk duhet ta trajtojë investitorin ose investimin e huaj në mënyrë më pak të favorshme sesa investitorët ose investimet nga ndonjë vend i tretë. Klauzola e MFN-së është përdorur herë pas here për të zgjeruar përkufizimin e juridiksionit në traktatin në fuqi duke bërë huazime nga i ashtuquajtimi traktat "krahases". Ekziston pothuajse një pikëpamje e pandryshuar se një zgjerim i tillë nuk është i mundur. Të tjerë e kanë përdorur klauzolën MFN për të shtuar fushëveprimin e procedurave, d.m.th. kanë importuar dispozita më të favorshme ISDS nga traktatet krahasese (p.sh. klauzola arbitrazhi pa periudha të pritjes). Një përdorim i tillë i mbrojtjes MFN është kundërtshënës, me ndarje të barabartë midis arbitrave që konsiderojnë se kjo gjë është e mundur apo duhet të jetë e mundur. Përdorimi më i pakontestueshëm (deri kohët e fundit) është inkorporimi i një trajtimi më të favorshëm substancial (p.sh. mbrojtja FET). Në ditët e sotme, disa pretendojnë se mbrojtja e MFN është e kufizuar në mënyrën se si shteti nikoqir i trajton investitorët në vend.

Kuantifikimi i Dëmit

Nëse përcaktohet përgjegjësia, gjykata mund të detyrohet të përcaktojë dëmin. Kjo është shpesh faza më e diskutueshme dhe mund të përfshijë model ekonomik kompleks. Metodologjitë standarde të vlerësimit përfshijnë:

- ➔ **Rrjedha e parasë e skontuar (DCF):** Për të vlerësuar vijueshmërinë me shënime të dëshmuara të fitimit, gjykata mund të projektojë fitimet e ardhshme dhe t'i zbrësë ato në vlerën e tanishme. Një vlerësim DCF

mund të prodhojë vendime të rëndësishme arbitrazhi duke kapur vlerën e plotë ekonomike të rritjes së ardhshme.

- ➔ **Analiza e krahasueshmërisë:** Tribunali vlerëson investimin duke iu referuar transaksioneve të fundit të palëve të pavarura të aktiveve të ngjashme, ose vlerësimit të tregut të kompanive të krahasueshme.
- ➔ **Kostot e pakthyeshme (*sunk costs*):** Për projektet në fazë të hershme (p.sh. një minierë që ende nuk ka filluar nxjerrjen), gjykatat mund ta refuzojnë DCF-në si shumë spekulative dhe në vend të kësaj të vendos për kosto të pakthyeshme, duke rimbursuar vetëm paratë aktuale të shpenzuara nga investitori.

Mekanizmi i Anulimit i ICSID-it

Një tipar përcaktues i sistemit ICSID është mungesa e procesit të ankimimit. Një palë nuk mund të ankimojë një vendim të ICSID në gjykatat kombëtare. Në vend të kësaj, Konventa e ICSID-it parashikon një Mekanizëm të brendshëm të Anulimit në të cilin emërohet një komitet ad hoc (i përbërë nga tre arbitra të rinj) për të shqyrtuar vendimin.

Megjithatë, shqyrtimi i tij është i kufizuar në gabimet specifike të rënditura: (1) konstituim i gabuar i gjykatës, (2) tejkalimi i dukshëm i kompetencave, (3) korrupsioni, (4) shmangie serioze nga rregulli themelor i procedurës, ose (5) mosdeklarim i arsyeve për vendimin. Anulimi është hartuar qëllimisht për të dhënë një fushëveprim të kufizuar për shqyrtim për t'u mbrojtur nga shkelja e parimeve themelore të ligjit që rregullojnë procedurat themelore të arbitrazhit. Komiteti nuk mund të shqyrtojë nëse gjykata i ka vlerësuar saktë faktet ose ligjin, por vetëm nëse procesi është shkelur në thelb.

Në anën tjetër, vendimet që nuk merren nga ICSID (p.sh. ato të lëshuara në arbitrazhe me seli në Londër ose Paris sipas rregullave të UNCITRAL-it) i nënshtrohen të njëjtave procedurave të anulimit në selinë e gjykatave kombëtare si ato në arbitrazhin e kontesteve të kontratave. Derisa arsyet janë po aq të ngushta (zakonisht pasqyrojnë arsyet për zbatimin e vendimeve sipas Konventës së Nju Jorkut), përfshirja e një gjykate kombëtare paraqet një shtresë të mbikëqyrjes gjyqësore vendase që nuk ekziston në sistemin ICSID.

Përparësitë Kryesore dhe Potenciali për Perceptim Negativ

Motori kryesor që nxit miratimin e ISDS-së është inkurajimi i investimeve të huaja direkte. Duke ofruar një rrjet sigurie kundër rrezikut politik, traktatet e investimeve me klauzola ISDS historikisht kanë promovuar rrjedhën e kapitalit nga shtetet e zhvilluara tek shtetet e pazhvilluara ose në zhvillim. Mbrojtja e ofruar ka kapërcyer rreziqet dhe pasiguritë e qenësishme në investime të tilla. Megjithatë, kjo nuk është më një “rrugë njëkahore” e korporatave perëndimore që padisin shtetet në zhvillim. Ndërsa ekonomia globale ndryshon, ekziston një trend në rritje i investitorëve nga ekonomitë në zhvillim që iniciojnë kontest ndaj vendeve të zhvilluara, duke demokratizuar përdorimin e sistemit.

Përtej aspektit ekonomik, sistemi ofron avantazhe unike procedurale:

- ➔ **Neutraliteti:** Një investitor i huaj mund të ngurrojë t'i paraqesë kontestet me shtetin nikoqir gjykatave vendase të shtetit nikoqir, dhe shteti nikoqir gjykatave të një vendi tjetër. ISDS-ja e mbush këtë zbrazëti duke ofruar një vend neutral dhe të denacionalizuar që nuk cënon as dinjitetin e shtetit dhe as sigurinë e investitorit.
- ➔ **Mbrojtje e përshtatur:** ISDS është një krijim me pëlqimin e shtetit. Shtetet veprojnë si arkitektë të sistemit, duke përcaktuar nivelin e mbrojtjes, rregullat procedurale dhe përkufizimet e investimeve përmes traktateve që ato hartojnë. Ndërkohë që shtetet nuk mund t'i ndryshojnë rregullat në retrospektivë pasi të ketë filluar një kontest, ato mund të modernizojnë rrjetet e tyre të traktateve për të pasqyruar qëllimet e tyre aktuale të politikave.
- ➔ **Zbatueshmëria:** Ndryshe nga proceset gjyqësore të brendshme, të cilat mund të zvarriten me vite të tëra me ankimime, vendimet nga ISDS kanë për qëllim të jenë të formës së prerë. Sipas Konventës ICSID, procesi i ekzekutimit është i thjeshtë në teori, duke e trajtuar vendimin si një vendim të formës së prerë të gjykatës kombëtare dhe duke i kufizuar arsyet për anulim në bazë të gabimeve themelore procedurale në procesin e vendimarrjes.

Duke krijuar në mënyrë proaktive kornizën ligjore për ZAK në kontestet investitor-shtet (duke kombinuar ndërmjetësimin dhe arbitrazhin) dhe duke u angazhuar siç duhet në proces, shtetet forcojnë legjitimitetin e sistemit për palët publike dhe private dhe projektojnë një imazh pozitiv të një kornize të qëndrueshme dhe moderne për investimet e huaja. Dëshmia

më e mirë për këtë përfshin angazhimin në kohë dhe efikas në proces, si dhe njohjen dhe ekzekutimin e çdo zgjidhjeje ose vendimi që rrjedh prej tij, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Kriza e Legjitimitetit dhe Lëvizja e kundërreagimit

Pavarësisht këtyre avantazheve, ISDS është përballur me kundërreagime të konsiderueshme lidhur me legjitimitetin e tij dhe ndikimin në aftësinë e shteteve për të rregulluar çështjet në interes të publikut. Kritika më e fortë është potenciali për politizim të brendshëm dhe cënimi i sovranitetit. Kritikët pretendojnë se ISDS krijon një ngecje rregullatore, në të cilën shtetet hezitojnë të miratojnë ligjet e nevojshme në interes të publikut (siç është legjislacioni kundër pirjes së duhanit ose ndalimet mjedisore) nga frika se mos paditen për miliarda dollarë. Ky perceptim pretendon që ISDS u mundëson korporatave të anashkalojnë gjykatat kombëtare dhe të shkelin të drejtën themelore të një shteti për të rregulluar çështje. Megjithatë, ky rrezik zbutet gjithnjë e më shumë nga traktatet moderne, të cilat përcaktojnë në mënyrë të qartë të drejtën për të rregulluar çështje në interes të publikut, duke siguruar që masat legjitime shëndetësore dhe mjedisore nuk mund të trajtohen si shkelje të traktatit.

Kundërthënie të tjera lidhen me perceptimin se tribunalet favorizojnë investitorët. Pavarësisht aftësisë së palëve për të zgjedhur arbitrat e tyre (shtetet kanë të drejtë të barabartë për të emëruar një anëtar të tribunalit i cili i kupton nuancat e administratës publike dhe domosdoshmërinë rregullatore), ka pretendime se një grup i mbyllur i arbitrave i jep përparësi të drejtave të pronës së korporatave mbi të drejtat e njeriut ose shqetësimet mjedisore. Përkundrazi, statistikave dhe përgatitura nga organizatat kryesore të arbitrazhit, të tilla si UNCTAD dhe ICSID, sugjerojnë se shtetet në fakt fitojnë afërsisht gjysmën e të gjitha çështjeve të njohura.




Fig 4.6: Proceset gjyqësore të përfunduara në arbitrazh që nga 31 dhjetori 2024 Qendra e Politikave të Investimeve të UNCTAD

Kostoja e sistemit është një realitet i zyrtë. Mbrojtja e një padie ISDS mund të përfshijë tarifa të konsiderueshme ligjore dhe kosto gjyqësore, që shpesh tejkalojnë 5 deri në 10 milionë USD për një rast. Për disa shtete, këto kosto mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të buxhetit publik. Për t’iu kundërvënë kësaj, sistemi ka zhvilluar mekanizma të tillë si “siguria për kostot” (që kërkon që paditësit kontradiktorë të depozitojnë obligacione) dhe parimi “humbësi paguan”, sipas të cilit shtetet fituese kanë të drejtë të rikthejnë shpenzimet e tyre ligjore nga investitori kur ka padi të pabazuar.

Zhvillimet e fundit: Risitë në BE?

Peizazhi i arbitrazhit ndërkombëtar brenda Bashkimit Evropian ka pësuar një ndryshim të rëndësishëm pas aktgjykimit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian në rastin *Achmea* të vitit 2018, i cili e shpalli arbitrazhin investitor-shtet brenda BE-së të papajtueshëm me autonominë e rendit ligjor të BE-së.

Ky vendim nxiti një fushatë të koordinuar politike për të çmontuar regjimin ekzistues të ISDS, duke kulmuar me Marrëveshjen Plurilaterale të vitit 2020 për të përfunduar marrëdhënien brenda BE-së. BIT-et dhe tërheqja e fundit e BE-së dhe e disa shteteve anëtare nga Traktati i Kartës së Energjisë.

Pavarësisht qëndrimit të BE-së se këto zhvillime i bëjnë klauzolat e arbitrazhit të pavlefshme, shumica dërrmuese e tribunaleve të arbitrazhit i kanë hedhur poshtë vazhdimisht këto kundërshtime juridiksionale, duke pohuar se e drejta e BE-së nuk zëvendëson mandatin e tyre sipas të drejtës ndërkombëtare publike. Megjithatë, një ndryshim i rëndësishëm nga ky trend ndodhi në rastin *Green Power kundër Spanjës*, ku një gjykatë me seli në Stokholm pranoi kundërshtimin brenda BE-së dhe e refuzoi juridiksionin. Megjithatë, kjo ka të ngjarë të jetë për shkak të faktit se një vendim eventual do të anulohet në gjykatat suedeze dhe tribunali mund të ketë mbështetur idenë se ka detyrë të lëshojë vendime të ekzekutueshme.

Rregullat e zgjedhura të arbitrazhit dhe selia e arbitrazhit kanë një efekt të rëndësishëm në aftësinë e gjykatës për të mbështetur juridiksionin e saj dhe në zbatueshmërinë e vendimit të arbitrazhit - arbitrazhe ad hoc dhe institucionale me seli në një BE. Shtetet anëtare janë shumë më të cenueshme sesa ato nën kornizën e pavarur të ICSID.




Fig 4.7: Kronologjia e zhvillimeve kryesore të lidhura me Achmea

Burimet e dobishme

Konventat dhe Kornizat Ligjore

- Konventa e Kombeve të Bashkuara për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (1958): https://uncitral.un.org/en/texts/arbitration/conventions/foreign_arbitral_awards
- Konventa për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve në mes të Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera (1965): <https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/ICSID%20Convention%20English.pdf>
- Ligji Model UNCITRAL për Arbitrazhin e Tregtisë Ndërkombëtare (1985) (ndryshimet e miratuara në vitin 2006): https://uncitral.un.org/en/texts/arbitration/modellaw/commercial_arbitration
- Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare, Projekt nenet për Përgjegjësinë e Shteteve për Aktet Ndërkombëtarisht të Paligjshme (2001): https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/draft_articles/9_6_2001.pdf
- Konventa e Vjenës mbi të Drejtën e Traktateve (1969): https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/1_1_1969.pdf

Rregullat e Arbitrazhit dhe Ligji i Butë

- Oda Ndërkombëtare e Tregtisë, Rregullat e Arbitrazhit (2021): <https://iccwbo.org/dispute-resolution/dispute-resolution-services/arbitration/rules-procedure/2021-arbitration-rules/>
- Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar e Londrës, Rregullat e Arbitrazhit, (2020): https://www.lcia.org/Dispute_Resolution_Services/lcia-arbitration-rules-2020.aspx
- Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve, Rregullat e Arbitrazhit (2022): <https://icsid.worldbank.org/rules-regulations/convention/arbitration-rules/introductory-note>
- Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve, Rregullat mbi Marrjen e Provave në Arbitrazhin Ndërkombëtar (2020): <https://www.ibanet.org/resources>
- Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve, Udhëzime për Konfliktet e Interesit në Arbitrazhin Ndërkombëtar (2024): <https://www.ibanet.org/resources>
- Rregullar AAA-ICDR (2021): https://www.icdr.org/rules_forms_fees

Raportet dhe Statistikat

- Gjykata e Londrës për Arbitrazhin Ndërkombëtar, Analiza e Kostos dhe Kohëzgjatjes (2024): <https://www.lcia.org/>
- Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve, Statistikat mbi Ngarkesën me Raste (2025): <https://icsid.worldbank.org/resources/publications/icsid-case-load-statistics>
- OBK - Tregtia dhe Zhvillimi, Navigatori i Zgjidhjes së Kontesteve të Investimeve (2023): <https://investmentpolicy.unctad.org/investment-dispute-settlement>
- Universiteti Queen Mary i Londrës dhe White & Case LLP, Hulumtimi për Arbitrazhit Ndërkombëtar (2015, 2018, 2021, 2025): https://www.qmul.ac.uk/arbitration/research/2021-international-arbitration-survey/?utm_source=chatgpt.com
- Akademia Ndërkombëtare e Zgjidhjes së Kontesteve në Singapor, Hulumtimi mbi Zgjidhjen Ndërkombëtare të Kontesteve (2024): https://sidra.smu.edu.sg/sites/sidra.smu.edu.sg/files/survey-2024/SIDRA_Final_Report_2024.pdf?utm_source=chatgpt.com

Lista jopërfundimtare e institucioneve të arbitrazhit

- Oda Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC)
- Gjykata e Arbitrazhit Ndërkombëtar të Londrës (LCIA)
- Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Singapor (SIAC)
- Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Hong Kongut (HKIAC)
- Gjykata e Përhershme e Arbitrazhit (PCA)
- Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID)
- Instituti Gjerman i Arbitrazhit (DIS)
- SCC Instituti i Arbitrazhit (SCC)
- AAA-Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve (AAA-ICDR)
- Komisioni i Arbitrazhit Ndërkombëtar Ekonomik dhe Tregtar të Kinës (CIETAC)
- Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Vjenës (VIAC)
- Qendra Zvicerane e Arbitrazhit (Swiss Arbitration)

- Qendra Rajonale e Kajros për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar (CRCICA)
- Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit në Dubai (DIAC)
- Qendra Australiane për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar (ACICA)
- Qendra e Arbitrazhit dhe Ndërmjetësimit WIPO (WIPO)

KAPITULLI 5: Procedura dhe Praktika e Arbitrazhit




Fig 5.1: Procesi i Zgjidhjes Alternative të Kontesteve

Ky kapitull ofron një plan praktik për ciklin jetësor të një kontesti në arbitrazh, nga identifikimi i roleve kryesore dhe fazat e hershme të vlerësimit të një kontesti të mundshëm, deri në përmbylljen e seancës dëgjimore dhe lëshimin e një vendimi. Fillon duke identifikuar aktorët kryesorë dhe duke shqyrtuar fazën para-arbitrazhit. Pastaj përshkruan fillimin formal të kontestit dhe procesin e konstituimit të tribunalit të arbitrazhit, duke theksuar rëndësinë strategjike të përzgjedhjes së arbitrit dhe standardet për pavarësi dhe paanshmëri. Pastaj përshkruan praktikën më të mira për mbledhjen e provave, strukturimin e parashtrësave me shkrim dhe menaxhimin e dorëzimit të dokumenteve.

Kapitulli trajton gjithashtu opsionet procedurale, të tilla si masat e përkohshme dhe degëzimi i kontesteve. Në fund, kapitulli trajton fazën gojore të arbitrazhit, duke ofruar teknika të mbrojtjes për deklaratat hapëse, marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarëve dhe fjalën përfundimtare, përpara se të diskutojë shkurtimisht kulminacionin e kontestit në dhënien e një vendimi.

Këto faza tipike të një arbitrazhi mund të shihen të paraqitura në një format kronologjik në Figurën 5.2 më poshtë:




Fig 5.2: Afati kohor i procedurës tipike të arbitrazhit dhe komponentët kryesorë

Rolet praktike dhe fazat e hershme në arbitrazh

Parashtruesi i kërkesës

Si palë që inicion kontestin, parashtruesi i kërkesës mban barrën e provës. Prandaj, roli kryesor i parashtruesit të kërkesës fillon shumë kohë përpara se të paraqitet kërkesa për arbitrazh. Procesi i arbitrazhit shpesh vendoset bazuar në prova bashkëkohore, kështu që parashtruesi i kërkesës duhet të organizojë të dhënat e tij të brendshme, duke përfshirë email-et, procesverbalet e mbledhjeve dhe të bordit, si dhe dokumente të tjera të brendshme, për të vërtetuar çështjen e tij në bazë të fakteve. Arbitrazhi është një klasë e aseteve që kërkon financim të konsiderueshëm. Ekipi ligjor i parashtruesit të kërkesës duhet të vlerësojë forcën e çështjes së tij, shpesh duke përfshirë avokatë të jashtëm, për të përcaktuar koston e ndjekjes së rastit kundrejt suksesit të mundshëm në arbitrazh dhe mundësisë për zhdëmtim. Arbitrazhi mund të shërbejë si një levë në negociatë, veçanërisht kur palët duan të ruajnë marrëdhënien e tyre tregtare në të ardhmen. Në shumë raste, qëllimi nuk është vendimi si i tillë, por një zgjidhje e negociuar pasi palët të kenë një mundësi për të

shqyrtuar pikat e forta dhe të dobëta të çështjes së njëra-tjetrës (shih *KAPITULLI 4: Përmbledhje e Arbitrazhit*).

Pala kundërshtare

Në procesin e arbitrazhit, pala kundërshtare shpesh zihet në befasi dhe duhet të mobilizohet shpejt për të marrë këshilla ligjore në kohë për të përgatitur strategjinë e tij të mbrojtjes dhe për të marrë pjesë tërësisht në përcaktimin e rregullave të zbatueshme të arbitrazhit dhe emërimin e gjykatës. Për secilin prej këtyre hapave, fjalët magjike janë: koordinim, koordinim dhe koordinim — brenda qeverisë, me këshilltarë të jashtëm dhe me investitorin. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar mobilizim të menjëhershëm, njoftim rregullator, zhvillimin e kundërkërkesave dhe mesazheve (shih *KAPITULLI 7: Udhërrëfyeshi për hartimin e sistemeve efektive dhe efikase të ZAK-së*).

Pas marrjes së njoftimit për kontest (kur kontrata ose traktati përkatës kërkon një njoftim paraprak) ose një kërkesë për arbitrazh, detyra e parë e palës kundërshtare është ruajtja e provave dhe identifikimi i dëshmitarëve përkatëse. Kjo e parandalon gjykatën të nxjerrë përfundime të pafavorshme nga dosjet ose të dhënat që mungojnë. Kompanive të listuara në bursë shpesh u kërkohet të shpalosin kontestet e mundshme në parashtresat e tyre, dhe shumë polica të sigurimit kërkojnë njoftim të menjëhershëm për një kërkesë për të bërë mbulimin për kostot e mbrojtjes ligjore. Mosnjoftimi brenda disa ditësh mund të anulojë mbulimin.

Pala kundërshtare duhet gjithashtu të vlerësojë shpejt nëse mbrojtja më e mirë është ngritja e një kundërkërkesë. Në çështjet tregtare, kjo përfshin identifikimin mospërmbushjes së detyrimeve nga pala kundërshtare. Në ISDS, shtetet po ngrenë gjithnjë e më shumë kundërkërkesa për dëme mjedisore ose shkelje të të drejtave të njeriut të kryera nga investitori. Një kundërkërkesë e argumentuar mirë mund të rrisë mundësinë e arritjes së një rezultati të favorshëm në negociatat e ardhshme për gjetje të zgjidhjes. Për të parandaluar deklaratat publike jokonsistente nga institucione të ndryshme që mund ta rëndojnë kontestin ose të përdoren si prova kundër qeverisë, është thelbësore të krijohet dhe të projektohet një narrativë e unifikuar. Çdo komunikim publik duhet të jetë mjaftueshëm informues për të përmbushur nivelin e kërkuar të transparencës, por përndryshe duhet të jetë i kufizuar dhe i filtruar përmes një burimi të vetëm qeveritar.

Këshilltarët Ligjor

Detyra kryesore e këshilltarit ligjor është të përmbledhë mijëra dokumente dhe fakte teknike në një rrëfim bindës dhe koherent që e bind gjykatën. Ata shërbejnë në shumë role të tjera të rëndësishme. Këshilltari ligjor duhet t'i ofrojë klientit një shkallë realiste suksesi dhe një buxhet të detajuar. Kjo shpesh përfshin identifikimin e çështjeve juridiksionale (p.sh. afatet kohore, korrupsionin ose klauzolat e pavlefshme të arbitrazhit) dhe shqyrtimin me kujdes të bazës së kontestit përpara se pala të japë shuma të konsiderueshme për një gjë të tillë. Përzgjedhja e gjykatës është vendimi strategjik më i rëndësishëm në të gjithë procesin, dhe këshilltarët juridik me përvojë kanë përvojë të drejtpërdrejtë me shumë arbitra të shquar dhe qasje në analizat e të dhënave dhe rrjetet profesionale për të hulumtuar historikun e arbitrave të mundshëm. Ky informacion i vlefshëm u mundëson atyre të emërojnë një vendimmarrës i cili jo vetëm është neutral, por filozofia ligjore e të cilit përputhet me teorinë e rastit të klientit. Përveç në rastin e kontesteve të vogla ose të formës standarde, me bindje të plotë rekomandohet përfshirja e një këshilltari ligjor të jashtëm edhe kur ekipi i brendshëm i parashtruesit të kërkesës ose palës kundërshtare ka përvojë të konsiderueshme në arbitrazh.

Ekspertët

Palët në arbitrazh shpesh punësojnë ekspertë të pavarur për të orientuar tribunalin në çështje komplekse teknike ose çështje ligjore të huaja. Këta ekspertë duhet të jenë të paanshëm për tribunalin, si dhe për klientin që i paguan ata. Kjo përfshin:




Fig 5.3: Kategoritë e zakonshme të ekspertëve

Qeveria

Qeveritë luajnë një rol të dyfishtë unik në ekosistemin e arbitrazhit: ato janë të dyja, shpesh palë pala kundërshtare në kontest, ndonjëherë parashtrues kërkesë, si dhe politikëbërës që ndërtojnë sistemin.

Si palë kundërshtare, Qeveritë duhet të krijojnë një ekip (shpesh brenda Ministrisë së Drejtësisë, Financave ose Tregtisë, ose në koordinim me ministritë) për të menaxhuar kontestet në mënyrë të centralizuar. Kjo parandalon që ministritë e ndryshme brenda të njëjtës qeveri të marrin qëndrime kontradiktore në cilindo rast të caktuar (dhe përmes rasteve), dhe thjeshton mbledhjen e informatave dhe kontrollin e Qeverisë mbi ngarkesën e saj të çështjeve të arbitrazhit. Një ekip i tillë do të ishte gjithashtu përgjegjës për punësimin e avokatëve të jashtëm, shpesh përmes tenderëve publikë.

Ku e kërkon Pala A njohjen dhe zbatimin?

- Kinë
- Belize
- Maldive
- Juridiksione të tjera të mundshme "në rast se" zbulohen pasuri të tjera

Ku kërkon Pala B të bëhet anulimi?

- Nju Jork, NY

Fig. 6.2: Konsideratat gjeografike për njohjen dhe zbatimin kundrejt anashkalimit të një vendimi

Zbatimi i vendimit përfundimtar të arbitrazhi: Konventa e Nju Jorkut

Si Konventa e Nju Jorkut ashtu edhe Konventa ICSID synojnë të vendosin standarde të përbashkëta për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve. Korniza e ICSID është e pavarur për sa i përket anulimit. Për më tepër, Konventa ICSID ka rregullat e veta të zbatimit të ekzekutueshme për vendimet ISDS në nenet 53-55. Në dallim nga Konventa e Nju Jorkut me arsye të caktuara për refuzimin e ekzekutimit në nenin V, Konventa ICSID thotë se një vendim do të njihet nga shtetet anëtare si i detyrueshëm dhe se detyrimet financiare të vendosura nga ai vendim duhet të ekzekutohen sikur të ishte një vendim i formës së prerë i një gjykate në atë shtet. Megjithatë, Konventa ICSID merret vetëm me dëmshpërblimet financiare, dhe për më tepër, neni 55 thotë qartë se "[e]kzekutimi i vendimit do të rregullohet nga ligjet në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në fuqi në shtetin në territoret e të cilit kërkohet një ekzekutim i tillë".

Qëllimi kryesor i Konventës së Nju Jorkut është të sigurojë që vendimet e arbitrazhit të huaj të mos diskriminohen në zbatimin e tyre. Kështu, Konventa i detyron palët të njohin vendime të tilla në juridiksionin e tyre në të njëjtën mënyrë si vendimet e brendshme. Përderisa hartuesit e Konventës vendosën të mos e përkufizojnë termin "detyrues" në vetë Konventën, duke ua lënë gjykatave të përcaktojnë kushtet sipas të cilave një vendim duhet të konsiderohet detyrues, vendimeve u janë ofruar mbrojtje të tjera që krijojnë precedent për ekzekutimin nga gjykatat kombëtare. Për shembull, Konventa shfuqizoi kushtin e *exequatur* të dyfishtë, e cila kërkonte që një palë që kërkonte të zbatonte një vendim arbitrazhi të huaj të merrte njohjen e zbatueshmërisë së vendimit si në vendin ku është dhënë vendimi, ashtu edhe në vendin ku kërkohet ekzekutimi. Kjo do të thotë që natyra detyruese e vendimit nuk varet nëse vendimi është i zbatueshëm në vendin ku është lëshuar. Gjithashtu, nëse një palë humbëse nuk i përmbahet vendimit, pala fituese mund të kërkojë ta zbatojë atë përmes gjykatave shtetërore në çdo vend ku pala humbëse ka pasuri. Për më tepër, një vendim në seli për anashkalim të vendimit - d.m.th. ta bëjnë të pavlefshëm për shkak të parregullsive procedurale ose shkeljeve të rendit publik - mund të mos pengojë ekzekutimin e tij jashtë selisë.

Gjykatat kombëtare shpesh përmbahen nga zbatimi i kërkesave të së drejtës të selisë kur një gjë e tillë do të çonte në një rezultat në kundërshtim me qëllimin e Konventës së Nju Jorkut, siç është kushti që vendimi të marrë *exequatur* kombëtare për t'u bërë i detyrueshëm. Për më tepër, gjykatat që vlerësojnë natyrën detyruese të një vendimi shpesh kanë marrë në konsideratë qëllimet e palëve që rrjedhin nga marrëveshja e arbitrazhit ose rregullat e arbitrazhit. Një gjykatë spanjolle vendosi më parë se "natyra detyruese e vendimit duhet të shqyrtohet sipas rregullave që rregullojnë arbitrazhin [...] dhe jo sipas normave të shtetit ku u zhvillua arbitrazhi kur u dha vendimi". Konventa e Nju Jorkut, me miratimin e saj pothuajse universal të mundësuar nga ratifikimi i 172 vendeve, u ofron gjykatave kombëtare standarde të përforcuara kur vendosin për zbatimin e vendimeve dhe u siguron palëve përputhshmëri me aktgjykimet e gjykatave ndërkombëtare dhe vendase.

Konsistenca ligjore e Konventës kultivohet më tej nga përjashtimet e saj ekskluzive nga zbatueshmëria: në veçanti, nenet V(1)(a)-V(1)(e), të cilat u japin debitorëve të vendimeve bazë për të kërkuar dëmshpërblim për mospërputhjet procedurale, shkeljet e procesit të rregullt ligjor dhe autonomisë së palëve, si dhe aktvendimet jashtë autoritetit të tribunalit.

Nenet V(2)(a) dhe V(2)(b) u mundësojnë gjykatave që, me iniciativën e tyre, të refuzojnë të zbatojnë një vendim që nuk është i arbitrazhueshëm në juridiksionin e tyre, ose që shkel politikën e tyre publike.




Fig. 6.3: Bazat sipas Nenit V të Konventës së Nju Jorkut

Këto përjashtime u lejojnë shteteve të ruajnë vlerat, normat dhe perceptimin e tyre ligjor për drejtësinë, të cilat janë të natyrshme në jetën e tyre ekonomike dhe politike.

Kundërshtimi dhe anashkalimi

Përderisa procedurat e njohjes dhe zbatimit janë shpata e përdorur për të ekzekutuar një vendim, një Padi për anashkalim është mburoja përfundimtare. Është thelbësore të kuptohen kufijtë e juridiksionit këtu: ndryshe nga zbatimi, i cili mund të kërkohet në shumë vende njëkohësisht (kudo që të ndodhen pasuritë), një kundërshtim ndaj vlefshmërisë së një vendimi, duke kërkuar që ai të "anashkalohet", "anulohet" ose "lirohet", në përgjithësi mund të ngrihet vetëm në baza të kufizuara para gjykatave kombëtare të Selisë së Arbitrazhit (shih *KAPITULLI 5: Procedura dhe Praktika e Arbitrazhit*) në përputhje me ligjin që rregullon arbitrazhin (zakonisht ligji i selisë). Përderisa refuzimi i njohjes ose ekzekutimit

mund të ngrihet vetëm mbi baza të kufizuara para gjykatave kombëtare në përputhje me Konventën e Nju Jorkut ose Konventën ICSID, kur kreditori i vendimit kërkon njohje dhe/ose ekzekutim.

Është një parim themelor i arbitrazhit ndërkombëtar modern që gjykatat kombëtare nuk duhet të shqyrtojnë meritat e kontestit. Me fjalë të tjera, një palë humbëse nuk mund t'i kërkojë gjykatës të anashkalojë një vendim thjesht sepse beson se arbitrat kanë bërë një gabim faktik ose ligjor. Në vend të kësaj, shqyrtimi është rreptësisht procedural.

Bazat për kundërshtim dhe anashkalim (Jo-ICSID)

Nëse një palë identifikon një pretendim me procesin që ndikon në vlefshmërinë ose integritetin e vendimit, atëherë ajo duhet ta formulojë kundërshtimin brenda bazave të ngushta të parashikuara nga ligji kombëtar i vendit (shpesh i modeluar sipas Ligjit Model të UNCITRAL-it). Këto baza pasqyrojnë mbrojtjet e Konventës së Nju Jorkut.

RAST STUDIMOR:

RAV Bahamas Ltd and another kundër Therapy Beach Club Incorporated (2021)

Kontesti	Zgjidhja
Në një kontest mbi qiranë e një klubi plazhi, arbitri i dha paditësit miliona dollarë dëmshpërblim për fitimet e humbura. Megjithatë, gjatë llogaritjes së shumës përfundimtare, arbitri i zbriti në mënyrë të njëanshme ato humbje mbi një bazë që nuk mbështetej nga provat dhe nuk ishte diskutuar, ose nuk ishte trajtuar nga palët.	Gjykata e anashkaloi pjesërisht vendimin. Gjykata vendosi se ishte thelbësisht e padrejtë që një gjykatë të miratonte një metodologji vlerësimi që nuk ishte ngritur nga palët pa u dhënë atyre një mundësi për të komentuar mbi të. Gjykata nuk e anuloi të gjithë vendimin mbi përgjegjësinë; ajo vetëm e anashkaloi pjesën e bazuar në llogaritjen e gabuar të dëmeve, e cila i u dërgua gjykatës për rishqyrtim.

Nëse kundërshtimi është i suksesshëm, vendimi shpallet i pavlefshëm në vend. Në shumicën e juridiksioneve, kjo e bën vendimin kryesisht të pazbatueshëm në nivel global. Gjykatat e disa juridiksioneve, si Franca dhe Holanda, mund të zbatojnë një vendim të anuluar bazuar në të meta në procesin gjyqësor në gjykatat e selisë. Kjo ndodh sepse Neni V i Konventës së Nju Jorkut thotë se një vendim “mund” të refuzohet nëse

“është anashkaluar ose pezulluar nga një autoritet kompetent i vendit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit, është dhënë ai vendim”.

Për më tepër, kundërshtimi nuk çon gjithmonë në anulimin e të gjithë vendimit. Kur defekti procedural lidhet vetëm me një pjesë specifike të vendimit (p.sh. një pjesë e veçantë e dëmeve ose një çështje e dallueshme juridiksionale që mund të ndahet nga pjesa tjetër), gjykatat në shumë juridiksione kanë fuqinë të japin një anashkalim të pjesshëm, duke anuluar vetëm pjesën me të meta, ndërsa duke lënë në fuqi pjesën tjetër të vendimit.

Pala e suksesshme	Pala e pasuksesshme
✓ Përcaktoni se cilat vende përmbajnë pasuritë e palës humbëse ✓ Nëse pasuritë ndodhen në vende të ndryshme, shqyrtoni se në cilin vend ka gjasa që zbatimi të jetë më i shpejtë dhe më efektiv (përzgjedhje vendi)? ✓ Meqenëse e drejta vendore zbatohet për procedurat e ekzekutimit, merrni këshilla vendase nga avokatë me përvojë në vendin përkatës	✓ Merrni iniciativën duke kundërshtuar vendimin në gjykatat e vendit ku është dhënë vendimi ✓ Përdoreni vendimin si pikënisje për një proces negociues

Fig. 6.4: Lista kontrolluese e hapave që palët duhet të konsiderojnë pas marrjes së vendimit

Regjimi autonom i ICSID-it

Regjimi i zbatimit dhe kundërshtimit sipas Konventës ICSID ndryshon nga ai i arbitrazhit komercial. ICSID ofron një sistem të pavarur në të cilin gjykatat vendase nuk luajnë asnjë rol në procesin e anulimit dhe një rol të kufizuar në njohjen dhe zbatimin e vendimeve.

Konventa ICSID i detyron Shtetet Anëtare të “përmbahen dhe të zbatojnë” vendimet (Neni 53). Nëse një palë nuk i përmbahet vendimeve, pala tjetër mund të zbatojë detyrimet financiare të vendimit në gjykatat e çdo Shteti Anëtar të ICSID-it sikur të ishte një vendim i formës së prerë i gjykatës më të lartë të atij shteti (Neni 54). Gjykatave kombëtare u ndalohej rreptësisht të shqyrtojnë vlefshmërinë e vendimit.

Meqenëse gjykatat kombëtare nuk mund të anashkalojnë një vendim të ICSID-it, Konventa krijoi një mekanizëm të brendshëm të kontrollit të cilësisë: Komitetin Ad Hoc të Anulimit. Ky është një panel prej tre arbitrash të rinj të emëruar nga Kryetari i Këshillit Administrativ (Presidenti i Bankës Botërore). Ata mund ta anulojnë një vendim vetëm për pesë arsye të kufizuara (Neni 52):

1. Tribunali nuk u themelua siç duhet
2. Tribunali i tejkaloi qartë kompetencat e veta (p.sh. duke zbatuar të drejtën e gabuar)
3. Pati korrupsion nga një anëtar i tribunalit
4. Kishte një shmangie serioze nga një rregull themelor procedural (p.sh. e drejta për t'u dëgjuar)
5. Vendimi nuk arriti të deklarojë arsyet mbi të cilat bazohet

Historikisht, rastet e suksesshme të anulimit janë sporadike, por nëse anulohen, vendimet nuk mund të zbatohen nga gjykatat kombëtare të vendeve që janë palë në Konventën ICSID. Nëse një vendim anulohet plotësisht, kontesti nuk ka “mbaruar”; palët kthehen në pikën zero dhe mund ta riparaqesin kontestin në një tribunal të ri të ICSID-it.

RAST STUDIMOR:

Eiser Infrastructure Ltd kundër Mbretërisë së Spanjës (2020)

Faktet	Rezultati
Eiser fitoi një dëmshpërblim prej 128 milionë UD nga ICSID kundër Spanjës në lidhje me reformat e energjisë së ripërtëritshme. Pas dhënies së shpërblimit, Spanja zbuloi se arbitri i emëruar nga parashtruesi i kërkesës kishte një marrëdhënie profesionale të gjatë me ekspertin e dëmeve të parashtruesi i kërkesës (ata punonin në të njëjtin grup konsulence), dhe kjo gjë nuk ishte publikuar më parë.	Komiteti Ad Hoc i ICSID-it e anuloi vendimin në tërësi. Përcaktoi se marrëdhënia e papublikuar krijonte një “mungesë të dukshme pavarësie” dhe përbënte një “devijim serioz nga një rregull themelor i procedurës”. Kjo tregon se derisa vendimet e ICSID janë të formës së prerë, integriteti i tribunalit është i panegociueshëm.

Konventa e Nju Jorkut (1958) dhe Konventa ICSID standardizojnë ekosistemin e arbitrazhit duke siguruar qëndrueshmëri procedurale, duke përfshirë kundërshtimet dhe zbatimin e vendimeve të formës së prerë. Shumë nga këto dispozita janë përfshirë në të drejtën vendore,

megjithëse ka ende hapësirë për dallime të vogla. Megjithatë, këto Konventa përkatëse krijojnë pritshmëri që përkthehen në rritje të besimit kur trajtohen kontestet tregtare.

Pengesa e Fundit: Imuniteti Sovran

Edhe nëse një vendim njihet dhe/ose zbatohet në favor të kreditorit të vendimit, arsyetimi me imunitet sovran lidhur me ekzekutimin përfaqëson një pengesë të fundit kur debitori i vendimit është një shtet.

E drejta ndërkombëtare bën dallimin midis:

- ➔ **Imunitetit nga Juridiksioni:** E drejta për të mos u paditur. Shumica e shteteve heqin dorë nga kjo duke nënshkruar marrëveshjen e arbitrazhit (BIT ose Kontratë).
- ➔ **Imuniteti nga Ekzekutimi:** E drejta për të mos u sekuestruar pasuritë shtetërore. Rrallëherë hiqet dorë nga kjo e drejtë.

Prandaj, një parashtrues kërkesë që zotëron një vendim të vlefshëm nuk mund të sekuestrojë ambasadën e shtetit ose rezervat e bankës qendrore. Sipas ligjeve të shumicës së shteteve zbatuese (siç është Ligji i Imuniteteve të Huaja Sovrane i SHBA-së ose Ligji i Imunitetit i Mbretërisë së Bashkuar), zbatimi në përgjithësi kufizohet në pasuritë e përdorura për qëllime tregtare. Pasuri të tilla mund të përfshijnë llogari bankare të përdorura për transaksione tregtare, të ardhura nga shitjet tregtare ose në rrethana të jashtëzakonshme, aeroplanë komercialë në pronësi shtetërore. Pasuritë sovrane që në përgjithësi mbrohen nga ekzekutimi përfshijnë pronën diplomatike, asetet ushtarake, rezervat e bankës qendrore dhe trashëgiminë kulturore.

Shumica e shteteve nuk kanë legjislacion për imunitetin sovran. Megjithatë, meqenëse e drejta e imunitetit sovran është e drejtë ndërkombëtare publike, gjykatat e këtyre shteteve zakonisht shqyrtojnë të drejtën ndërkombëtare zakonore. Duke vepruar kështu, gjykatat udhëhiqen nga Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe të Pronave të Tyre e vitit 2004 (UNCIS), e cila konsiderohet pjesërisht si pasqyrim i së drejtës ndërkombëtare zakonore, edhe pse ende nuk ka hyrë në fuqi. Ato udhëhiqen gjithashtu nga jurisprudenca e GJND-së dhe vendime të tjera të gjykatave të huaja. Neni 19 i UNCIS-artikulon qartë se pasuritë shtetërore nuk mund të sekuestrohen përveç nëse “prona

është në veçanti në përdorim ose është menduar të përdoret nga shteti për qëllime të tjera nga qëllimet jokomerciale qeveritare dhe ndodhet në territorin e shtetit ku zhvillohet procedura” (domethënë, përjashtimi i “qëllimit komercial”). Neni gjithashtu rendit pëlqimin dhe dedikimin e posaçëm të pasurisë (*earmarking*) si përjashtime nga imuniteti. Për më tepër, neni 21 i konventës përcakton pasuritë që janë absolutisht immune nga vetë natyra e tyre (p.sh. ushtria, banka qendrore, prona diplomatike dhe e trashëgimisë kulturore). Së fundmi, në praktikë, një problem i madh ka qenë se shtetet shpesh e kanë organizuar aktivitetin e tyre tregtar përmes subjekteve në pronësi shtetërore ose të kontrolluara nga shteti. Rregulli është që këto pasuri janë të paqasshme për një kreditor që ka fituar një vendim gjyqësor kundër shtetit. Megjithatë, ka përjashtime të kufizuara nga prezumimi i ndashmërisë (p.sh. kur subjekti përdoret për të kryer mashtrim ose është aq i kontrolluar dhe i lidhur me shtetin saqë është në të vërtetë alter egoja ose agjenti i tij).

Praktikat më të mira për të siguruar zbatueshmërinë

Derisa konventat ndërkombëtare kanë krijuar një ekosistem në të cilin arbitrazhi mund të lulëzojë, palët e përfshira vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e sistemit. Për të siguruar që sistemi funksionon siç duhet, palët:

- ➔ Duhet të sigurojnë që marrëveshjet e arbitrazhit të hartohen qartë, të mbeten të vlefshme ligjërisht dhe të jenë mjaftueshëm gjithëpërfshirëse. Klauzolat e paqarta duhet të shmangen pasi ato mund të shfrytëzohen më vonë.
- ➔ Pritet që të zbatojnë vullnetarisht marrëveshjet, pajtimin dhe ndërmjetësimin, për të arritur tek një rezultat miqësor.
- ➔ Zgjedhin një vend në një juridiksion pro-arbitrazhit për të siguruar një kornizë të fortë ligjore dhe për të zvogëluar rrezikun e pranimit të kërkesave për anulim të vendimit gjyqësor.
- ➔ Duhet të fillojnë identifikimin e hershëm të objektivave të mundshëm të zbatimit në mënyrë që veprimet të mund të ndërmerren shpejt sapo të nxjerret vendimi.

Sa i përket tribunaleve të arbitrazhit, ato duhet të punojnë:

- ➔ Të qëndrojnë brenda mandatit sipas marrëveshjes së arbitrazhit
- ➔ Të sigurojnë një proces të rregullt ligjor
- ➔ T'u jepin palëve mundësi të plota për të paraqitur rastin e tyre
- ➔ Të shmangin vonesat, kostot ose devijimet e panevojshme nga rregullat e zgjedhura nga pala
- ➔ T'u përmbahen konventave ndërkombëtare sipas të cilave veprojnë
- ➔ Të mundohen të jenë të vetëdijshëm për çështjet e politikave publike në juridiksionet përkatëse

Pavarësisht kornizave të forta të Konventës së Nju Jorkut dhe Konventës ICSID, zbatimi mbetet pika më e rëndësishme e kontesteve në arbitrazhin ndërkombëtar. Sfidat zakonisht rrjedhin nga zbatimi jokonsistent i politikave publike nga gjykatat vendase në juridiksione më pak miqësore ndaj arbitrazhit, dhe vështirësia praktike e depërtimit përtej mburojes korporative të subjekteve shtetërore për të sekuestruar pasuritë. Megjithatë, me mbi 170 vende të angazhuara në Konventën e Nju Jorkut, sistemi mbetet mekanizmi më efektiv i disponueshëm për zgjidhjen e kontesteve ndërkufitare tregtare dhe të investimeve.

Zbatimi i marrëveshjeve të zgjidhura me ndërmjetësim: Konventa e Singaporit

Konventa e Singaporit për Ndërmjetësimin është një kornizë e unifikuar dhe efikase që rregullon njohjen dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të zgjidhjes së arritur përmes ndërmjetësimit (iMSA). Meqenëse një iMSA është kontraktuale nga natyra, ajo përcakton mirëkuptimin e palëve se si t'i zgjidhin kontestet e tyre dhe specifikon të drejtat dhe detyrimet e tyre. Termi "ndërkombëtar" i referohet rrethanave kur dy palë në marrëveshjen e ndërmjetësuar kanë vendet e tyre të biznesit në shtete të ndryshme. Gjithashtu ka të bëjë me rastin kur Shteti në të cilin palët në marrëveshjen e ndërmjetësuar kanë vendet e tyre të biznesit është i ndryshëm nga shteti në të cilin kryhen detyrimet thelbësore sipas iMSA-së ose nga shteti me të cilin objekti i shqyrtimit i iMSA-së është i lidhur më ngushtë. Sipas këtij regjimi të ri të zbatimit, një palë mund ta zbatojë iMSA-në drejtpërdrejt nëse pala tjetër nuk i përmbahet kushteve të saj,

pasi vendimet e arbitrazhit mund të zbatohen drejtpërdrejt. Zbatimi në ndonjë shtet ose palë kontraktuese bëhet sipas rregullores së punë së vet dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në Konventën e Singaporit.




Fig 6.5: Procesi tipik për zbatimin e zgjidhjeve të ndërmjetësuar sipas Konventës së Singaporit

Konventa e Singaporit u ofron palëve ndërmjetësuese mjetet për të mbrojtur veten në kontest. Një palë mund të zbatojë drejtpërdrejt një iMSA nëse pala tjetër nuk i përmbahet kushteve të saj. Ndryshe, një palë fillon procedurat formale për një çështje që është zgjidhur me ndërmjetësim dhe është regjistruar si një iMSA. Në atë rast, pala tjetër mund të përdorë iMSA-në për të provuar se çështja ndërmjet palëve tashmë është zgjidhur.

Kërkesat kryesore për marrëveshjet për zgjidhjen e kontesteve që janë të zbatueshme sipas Konventës së Singaporit për Ndërmjetësim

Origjina: Marrëveshja duhet të arrihet nga ndërmjetësimi me një ndërmjetës që është palë e tretë neutrale.

Forumi: Duhet të jetë me shkrim; pranohen të dhëna elektronike.

Fushëveprimi: Mbulon kontestet **tregtare** me element **ndërkombëtar**; përjashton çështjet e konsumatorve, familjare, të trashëgimisë dhe punësimit.

Provat: Pala që kërkon zbatimin duhet të dëshmojë se marrëveshja ka rrjedhë nga ndërmjetësimi (p.sh. nënshkrimi i ndërmjetësuesit, vërtetim institucional ose prova të tjera).

Ndërkombëtariteti: Të paktën dy palë nga shtete të ndryshme ose një lidhje me shtete të ndryshme përmes performancës ose objektivit të shqyrtimit.

Arsyet e Refuzimit: Mungesa e aftësisë, pavlefshmëria, detyrime jo të plota/të paqarta, shkelje serioze e ndërmjetësimit ose zbatim në kundërshtim me politikën publike.

Efekti: Marrëveshjet e kualifikuara janë të zbatueshme drejtpërdrejt përtej kufijve pa proces gjyqësor, të ngjashme me vendimet e arbitrazhit ose vendimet gjyqësore.

Procesi i zbatimit të një vendimi të arbitrazhit ose marrëveshjes së ndërmjetësuar për zgjidhjen e kontestit

Derisa Konventat e Nju Jorkut dhe Singaporit ofrojnë autoritetin e zbatimit ligjor, procedura konkrete rregullohet nga rregullat kombëtare të procedurës civile të vendit ku ndodhen pasuritë. Ky proces përgjithësisht përfshin hapat në vijim:

1. **Gjurmimi i pasurive:** Përpara paraqitjes së ndonjë dokument ligjor, pala që kërkon zbatimin duhet t'i përgjigjet pyetjes: Ku janë paratë? Një vendim monetar ka vlerë vetëm aq sa kanë pasuritë e disponueshme për ta shlyer atë. Kjo përfshin identifikimin e llogarive bankare, pasurive

të paluajtshme, filialeve ose pagesave në zinxhirin e furnizimit (p.sh. kapjen e pagesave që palët e treta i detyrohen debitorit). Në rastin e shteteve sovraane, është gjithashtu e nevojshme të identifikohen pasuritë që nuk përdoren ose nuk janë të destinuara për qëllime qeveritare jo-komerciale, si funksionet diplomatike dhe ato të bankës qendrore. Siç përmendet më poshtë, shumica e juridiksioneve lejojnë zbatimin vetëm kundër pasurive shtetërore të përdorura për qëllime tregtare.

2. **Kërkesa:** Pasi zgjidhet juridiksioni, pala fituese paraqet kërkesë në gjykatën kombëtare kompetente. Sipas Nenit IV të Konventës së Nju Jorkut, barra mbi palën që bënë kërkesën është qëllimisht e lehtë. Për të aktivizuar kompetencën e gjykatës, parashtruesi i kërkesës në përgjithësi duhet të paraqesë vetëm: (1) vendimin origjinal të vërtetuar siç duhet ose një kopje të vërtetuar siç duhet; (2) marrëveshjen origjinale të arbitrazhit ose një kopje të vërtetuar siç duhet; dhe (3) një përkthim të certifikuar të këtyre dokumenteve nëse ato nuk janë në gjuhën zyrtare të vendit ku kërkohet zbatimi.
3. **Exequatur:** Nëse përmbushen kërkesat formale, gjykata kombëtare lëshon një urdhër që shpesh quhet *exequatur* (nga latinishtja "të ekzekutohet"). Ky urdhër gjyqësor në fakt e transformon vendimin ndërkombëtar, duke e transformuar atë në një vendim të gjykatës vendase. Në shumë juridiksione, ky hap fillestar është *ex parte* (pa praninë e palës tjetër) për të parandaluar debitorin të zhvendosë pasuritë përpara se të jepet urdhri. Pasi të jepet urdhri, ai i dorëzohet debitorit, i cili më pas ka një afat të kufizuar për të kundërshtuar bazuar në arsyet e parapara në Nenin V.
4. **Ekzekutimi:** Kur *exequatur* të jetë përfundimtar (ose nëse gjykata lejon ekzekutimin e menjëhershëm në pritje të ankesës), vendimi trajtohet si një vendim i gjykatës vendase. Pala fituese tani mund të ushtrojë fuqinë e shtetit për të sekuestruar pasuritë.

Qoftë në hartimin e ZAK apo në pjesëmarrjen në të, është thelbësore të kuptohet se besueshmëria e sistemit të zgjidhjes së kontesteve varet nga konsistenca, sepse një proces i zgjidhjes së kontestit që prodhon rezultate të paparashikueshme do të humbasë besimin e përdoruesve në planin afatgjatë dhe do të dështojë në përmbushjen e qëllimit të vet.

Burimet e dobishme

Konventat dhe Kornizat Ligjore

- Kombet e Bashkuara, Konventa mbi Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (1958): (1958): <https://www.newyorkconvention.org/english>
- Kombet e Bashkuara, Konventa mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve që Rezultojnë nga Ndërmjetësimi (2018): https://uncitral.un.org/en/texts/mediation/conventions/international_settlement_agreements
- ICSID, Konventa për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve në mes të Shteteve dhe Shtetasve të Shteteve të Tjera (1965): https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/ICSID_Convention_EN.pdf
- Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Imunitetet Juridiksionale të Shteteve dhe Pronave së Tyre (UNCIS) (2004): https://legal.un.org/ilc/texts/instruments/english/conventions/4_1_2004.pdf

Udhëzime, Manuale dhe Komete

- UNCITRAL, Udhëzues mbi Konventën për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (1958): https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/2016_guide_on_the_convention.pdf
- Akademia Ndërkombëtare e Singaporit për Zgjidhjen e Kontesteve, Një Manual për Konventën e Singaporit për Ndërmjetësim (2021): <https://www.singaporeconvention.org/sites/singaporeconvention.org/files/SMU%20SOL%20Singapore%20Convention%20Mediation%20Handbook.pdf>
- Rishikimi Global i Arbitrazhit, Zbatimi sipas Konventës së Nju Jorkut (2023): <https://globalarbitrationreview.com/guide/the-guide-challenging-and-enforcing-arbitration-awards/4th-edition/article/enforcement-under-the-new-york-convention>
- Aceris Law, Si funksionon Zbatimi: Shndërrimi i Vendimeve të Arbitrazhit në Rezultate në Botën Reale (2025): <https://www.acerislaw.com/how-enforcement-works-turning-arbitral-awards-into-real-world-results/>

KAPITULLI 7:

Udhërrëfyesi për hartimin e sistemeve efektive dhe efikase të ZAK-së

Hyrje

Puna e CLDP-së në të gjithë Evropën, Lindjen e Mesme, Afrikën dhe Azinë tregon se ndërtimi i një ekosistemi të fortë të ZAK-s është thelbësor për çdo shtet që kërkon të forcojë mjedisin e tij tregtar dhe të tërheqë investime të huaja direkte shitesë.

Një juridiksion që përqafon ZAK-në u dërgon një sinjal të qartë bizneseve: kontestet do të zgjidhen në mënyrë të drejtë, efikase dhe në përputhje me marrëveshjen e palëve dhe standardet ndërkombëtare. Ky besim nxit investimet e huaja direkte, mbështet rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe përforcon sundimin e ligjit. Në të kundërtën, mangësitë në legjislacion, praktikën gjyqësore, kapacitetin institucional, mundësitë arsimore, mjedisin për biznes ose ndërgjegjësimin publik mund të dëmtojnë besueshmërinë e ekosistemit dhe të kufizojnë potencialin e tij ekonomik.

Si mund ta forcojë një shtet në mënyrë thelbësore ekosistemin e vet të ZAK-së?

Përvoja tregon se asnjë intervenim i vetëm nuk e transformon një juridiksion të caktuar në një vend tërheqës për arbitrazh ose ndërmjetësim. Në vend të kësaj, është ndikimi kumulativ i reformave të koordinuara legjislative, ligjore, gjyqësore, institucionale, arsimore dhe kulturore që në fund të fundit nxit një mjedis ku ZAK mund të lulëzojë.

Ky kapitull paraqet kornizën praktike të CLDP-së për zhvillimin e një ekosistemi modern, të qëndrueshëm dhe tërheqës të ZAK-së. Identifikon shtyllat kryesore që mbështesin ndërmjetësimin dhe arbitrazhin në nivel global, duke përfshirë kornizat ligjore, gjyqësorin, përdoruesit fundorë komercialë, universitetet, odat e avokatëve dhe qendrat e pavarura të ZAK-së dhe nënvizon se si përmirësimet në secilën fushë, dhe kolektivisht, mund ta transformojnë një juridiksion në një vend konkurrues, të besueshëm dhe tërheqës për zgjidhjen e kontesteve që promovon investimet dhe tërheq bizneset.

Diskutimi së pari shqyrton mënyrat për të forcuar ekosistemet e ndërmjetësimit, pastaj kthehet në forcimin e ekosistemeve të arbitrazhit.

Forcimi i ekosistemeve të ndërmjetësimit

Një ekosistem funksional i ndërmjetësimit kërkon, në thelbin e tij, një kornizë ligjore që (1) u mundëson palëve të japin pëlqimin për ndërmjetësim dhe të marrin pjesë në mënyrë kuptimplote në të, dhe (2) siguron që gjyqësori të respektojë dhe zbatojë marrëveshjet e negociuara të zgjidhjes së kontestit që rezultojnë nga ai proces.

Megjithatë, një ekosistem që *lulëzon* varet nga një konstelacion i gjerë aktorësh, si agjenci qeveritare, gjykata, ndërmjetësues, avokatë, institucione dhe përdorues fundorë komercialë që punojnë në mënyrë të harmonizuar për të mbështetur këto parime thelbësore. Kur këta elementë veprojnë në mënyrë kohezive, ndërmjetësimi bëhet një mekanizëm i besueshëm dhe efikas për zgjidhjen e kontesteve dhe një burim besimi për investitorët ndërkombëtarë që kërkojnë rrugë të parashikueshme dhe jo-kontradiktore për të zgjidhur kontestet e tyre.

Roli i Qeverisë

Qeveritë dhe politikëbërësit luajnë një rol thelbësor në formësimin e peizazhit të ndërmjetësimit. Duke krijuar korniza të qarta institucionale dhe ligjore, ato dërgojnë sinjale si për palët e interesuara vendase ashtu edhe për investitorët e huaj se ndërmjetësimi është një metodë legjitime, e qëndrueshme dhe e zbatueshme për zgjidhjen e kontesteve.

Pjesëmarrja e qeverisë gjithashtu ka rëndësi sepse ndërmjetësimi nuk mund të rritet vetëm organikisht; ai kërkon një sinjal të qartë të vullnetit politik dhe sigurisë ligjore përpara se bizneset t'i besojnë atij. Veprimet efektive të qeverisë përfshijnë:

- ➔ Krijimi i infrastrukturës ligjore që autorizon ndërmjetësimin, mbron autonominë e palëve dhe siguron zbatueshmërinë e marrëveshjeve të ndërmjetësuar.
- ➔ Duke vendosur angazhime politike që e ngrenë ndërmjetësimin si një mekanizëm qendror për zgjidhjen e kontesteve, për shembull, si Ligji i Kosovës për Investime të Qëndrueshme që e përcakton ndërmjetësimin si mjetin kryesor për zgjidhjen e kontesteve, duke u ofruar investitorëve parashikueshmëri më të madhe.

- ➔ Mbështetja e zhvillimit të institucioneve ndërmjetësuese që janë përgjegjëse për trajnimin e praktikuesve, akreditimin dhe mbikëqyrjen.
- ➔ Promovimi i qeverisjes së mirë dhe stabilitetit duke siguruar që rezultatet e ndërmjetësuar nuk mund të përmbysen lehtësisht nga ndryshimet politike ose ndryshimi i prioritetëve administrative.

Angazhimi i qeverisë gjithashtu forcon besimin e investitorëve. Prania e një mekanizmi të parashikueshëm dhe jo të politizuar për menaxhimin e konfliktit ndihmon në stabilizimin e horizonteve të investimeve dhe zvogëlon rreziqet e perceptuara që lidhen me kontestet tregtare.

Korniza Ligjore

Një ekosistem ndërmjetësimi i besueshëm dhe efektiv mbështetet jo vetëm në institucione të afta, por edhe në një kornizë të qëndrueshme ligjore që u jep siguri përdoruesve, palëve neutrale dhe gjykatave. Ligje të qarta dhe standarde të harmonizuara ndërkombëtarisht sigurojnë që rezultatet e ndërmjetësuar të respektohen, të zbatohen dhe të mbrohen nga ndërhyrjet e panevojshme. Duke forcuar si angazhimet ndërkombëtare ashtu edhe legjislacionin vendas që rregullon ndërmjetësimin, shtetet mund të krijojnë një mjedis të favorshëm që nxit besimin në ZAK dhe inkurajon përdorimin e tij në praktikën tregtare.

Komponentët e mëposhtëm përshkruajnë themelet kryesore ligjore të nevojshme për të mbështetur një ekosistem modern të ndërmjetësimit, duke filluar me kornizat ligjore ndërkombëtare dhe më pas duke diskutuar kornizat e brendshme.

Miratimi i Konventës së Singaporit për Ndërmjetësim

Një ekosistem modern i ndërmjetësimit do të përfitonte ndjeshëm kur një shtet të miratojë Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve që Rezultojnë nga Ndërmjetësimi (2018) — e njohur zakonisht si Konventa e Singaporit për Ndërmjetësim, e cila:

- ➔ Ofron një kornizë të unifikuar dhe të njohur ndërkombëtarisht për zbatimin e marrëveshjeve të ndërmjetësuar përtej kufijve.

- ➔ I lejon një pale në një marrëveshje tregtare të arritur përmes ndërmjetësimit të kërkojë drejtpërdrejt zbatimin e saj në një shtet tjetër nënshkrues, pa pasur nevojë të ripërsërisë procesin për kontestin.
- ➔ Rrit sigurinë tregtare duke siguruar që ndërmjetësimi nuk është thjesht një ushtrim vullnetar, por një proces që jep rezultate të detyrueshme dhe të zbatueshme.

Miratimi i Konventës së Singaporit i çon sinjal komunitetit global të biznesit se juridiksioni mbështet zgjidhjen efikase të kontesteve dhe është në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Për politikëbërësit, efekti praktik është i thjeshtë: miratimi i Konventës i ndihmon bizneset të besojnë se marrëveshjet e arritura në ndërmjetësim do të respektohen në të vërtetë, madje edhe përtej kufijve. Kjo parashikueshmëri është një stimulim i rëndësishëm për investitorët e huaj.

Inkorporimi i Ndërmjetësimit në Traktatet e Investimeve

Që nga viti 2015 është shënuar rritje e dukshme e traktateve që përmbajnë referenca të shprehura për ndërmjetësimin në klauzolat e tyre për zgjidhjen e kontesteve. Për shembull, gjenerata e fundit e traktateve model dypalëshe të investimeve (BIT) për Holandën, Tajlandën, Malin e Zi dhe Bosnjë-Hercegovinën përfshijnë të gjitha referenca për ndërmjetësimin.

Modeli BIT nga Holanda (2019)

Neni 17(1): Zgjidhja Alternative e Kontesteve

"Çdo kontest duhet, për aq sa është e mundur, të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes negociatave, pajtimit ose ndërmjetësimit. Një zgjidhje e tillë mund të arrihet në çdo kohë, edhe pasi të kenë filluar procedurat sipas këtij Seksioni. Një palë në kontest duhet të merrë parasysh një kërkesë për negociata, pajtim ose ndërmjetësim të parashkruar nga pala tjetër në kontest".

Derisa klauzolat e traktateve mbi ndërmjetësimin variojnë nga ato inkurajuese në të detyrueshme, ato e trajtojnë universalisht ndërmjetësimin si një metodë të përshtatshme për zgjidhjen e kontesteve.

Fuqizimi i legjislacionit të brendshëm për ndërmjetësimin

Edhe pas ndërmarrjes së angazhimeve ndërkombëtare, ndërmjetësimi kërkon gjithashtu legjislacion të fortë vendas për të funksionuar në mënyrë efektive. Ekziston një gamë e gjerë e qasjeve që mund të merren në konsideratë, duke filluar nga procedurat lokale që ofrojnë rregulla bazë për fillimin deri në finalizimin e ndërmjetësimit, dhe standarde bazë për të rregulluar praktikën e ndërmjetësimit, deri te Konventa e Singaporit për Ndërmjetësim. Një legjislacion i tillë duhet:

- Të përcaktojë fushëveprimin dhe parimet e ndërmjetësimit
- Të mbrojë autonominë e palës dhe të sigurojë që asnjë palë të mos detyrohet të ndërmjetësojë;
- Të dallojë qartazi rolet e gjyqtarëve dhe ndërmjetësve, duke parandaluar që vendimmarrësit të ndërmjetësojnë rastet e tyre.
- Të përcaktojë zbatueshmërinë e marrëveshjeve të ndërmjetësuar
- Të sigurojë mekanizma të llogaridhënies, siç janë kodet e mirësjelljes, proceset e ankesave dhe përkufizimet e qarta të gjurmimit të suksesit dhe rezultateve.

Legjislacioni i brendshëm për ndërmjetësimin përfshin gjithnjë e më shumë modele ndërmjetësimi të detyrueshëm dhe vullnetarë, me shumë juridiksione që miratojnë kërkesa ligjore për referim të detyrueshëm ose për ndërmjetësim para ndërmarrjes së ndonjë veprimi. Në të njëjtën kohë, mekanizmat e fuqishëm për të vendosur për të mos marrë pjesë (opt-out) brenda këtyre kornizave mbeten thelbësorë për të mbrojtur autonominë e palëve dhe për të ruajtur besimin në skemën legjislative. Në praktikë, juridiksionet shpesh fillojnë me ndërmjetësim vullnetar dhe gradualisht eksperimentojnë me skema të synuara të detyrueshme, për sa kohë që palët ruajnë të drejtën për të zgjedhur të mos marrin pjesë, për të shmangur perceptimet e shtrëngimit.

Gjyqësori: Sfidat dhe si mund të ndihmojë ndërmjetësimi

Sistemi gjyqësor në mbarë botën përballlet me sfida të vazhdueshme që pengojnë qasjen në ZAK dhe drejtësinë efikase. Arsyet janë si në vijim:

- Numër i madh i rasteve të pazgjidhura dhe varësi e tepruar tek gjyqtarët

- ➔ Njohuri të kufizuara me konceptet e ndërmjetësimit
- ➔ Mekanizma të pamjaftueshëm formalë për të referuar rastet në ndërmjetësim
- ➔ Shqetësime në lidhje me legjitimitetin ose besueshmërinë e rezultateve të ndërmjetësuar për shkak të mungesës së mekanizmave për të finalizuar marrëveshjet ose për të siguruar zbatueshmërinë e tyre.

Megjithatë, ndërmjetësimi mund të jetë një nga mjetet më efektive për zvogëlimin e presionit ndaj gjyqësorit. Kur përdoret siç duhet:

- ➔ Programet e ndërmjetësimit të lidhura me gjykatën zvogëlojnë ngarkesën e rasteve, duke u mundësuar gjyqtarëve të përqendrohen në rastet që kërkojnë vendimmarrje gjyqësore.
- ➔ Sistemet e referimit i fuqizojnë gjykatat të ridrejtojnë rastet e përshtatshme në ndërmjetësim, duke përshpejtuar afatet kohore të zgjidhjes.
- ➔ Rrugët e qarta të zbatimit të marrëveshjeve të arritura përmes ndërmjetësimit rrisin besimin e gjyqësorit në referimin e rasteve për ndërmjetësim.

Përvoja ndërkombëtare, siç është suksesi në zvogëlimin e rasteve të pazgjidhura nga gjykatat e Singaporit nëpërmjet investimeve në infrastrukturën e ndërmjetësimit dhe partnerëve të besuar institucionalë tregon se një gjyqësor i harmonizuar me ndërmjetësimin mund të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin e sistemit dhe konkurrueshmërinë e juridiksionit në zgjidhjen e kontesteve.

RAST STUDIMOR:

Ndërmjetësim për të zbutur numrin e lëndëve të pazgjidhura në gjykata

Sfida

Gjyqësori i një vendi partner të CLDP-së po përballej me një numër të lartë prej më shumë se 3.5 milion raste të pazgjidhura, duke rezultuar në vonesa të mëdha dhe duke gërryer besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Në gjykatat civile, koha mesatare për të zgjidhur një kontest bazik i tejkalonte 10 vite. Gjyqtarë individualë mbanin rregullisht raste në punë që tejkalonin mijëra raste, duke krijuar një ngarkesë të pamundur pune - një gjyqtar vuri në dukje se edhe nëse gjykonin 100 raste në ditë, ata megjithatë nuk do të ishin në gjendje të zvogëlonin ndjeshëm grumbullimin e rasteve. Sistemi ishte në fakt i bllokuar, pa mekanizma proceduralë lehtësues dhe me qasje të kufizuar të publikut në drejtësi me kohëzgjatje të arsyeshme.

Zgjidhja

CLDP krijoi partneritet me gjyqësorin kombëtar për të futur në përdorim qendrat e ndërmjetësimi të lidhura me gjykatën si një alternativë e shkallëzueshme ndaj procedurave gjyqësore tradicionale. Së bashku me këshillin gjyqësor, CLDP ndihmoi në hartimin e një kornizë për të identifikuar dhe referuar kategoritë e duhura të rasteve për ndërmjetësim, duke hequr mijëra konteste nga gjykatat e mbingarkuara. CLDP bashkëpunoi gjithashtu me akademinë gjyqësore, shoqatat e avokatëve dhe institucionet lokale të ZAK-së për të ofruar programe gjithëpërfshirëse të trajnimit për aftësitë e ndërmjetësimi dhe trajnim për trajnerët, duke siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të iniciativës. Si rezultat, gjyqësori është në rrugën e duhur për të ndryshuar qëndrimet kulturore ndaj ZAK-së dhe po ndërton një ekosistem ndërmjetësimi të vetëqëndrueshëm, të aftë për të trajnuar vazhdimisht ndërmjetësuesit dhe për të zvogëluar ngarkesën e rasteve, duke rivendosur efikasitetin, qasjen dhe besimin e publikut në procesin e drejtësisë.

Prandaj, është e rëndësishme që gjyqtarët ta shohin ndërmjetësimin jo si konkurrencë, por si një mekanizëm plotësues që ruan rolin e tyre të domosdoshëm gjyqësor, duke rritur njëkohësisht qasjen në drejtësi.

Ndërgjegjësimi i përdoruesve fundorë

Në thelb, sistemet e ndërmjetësimi kanë sukses vetëm kur hisedarët komercialë, investitorët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe avokatët i besojnë procesit dhe i kuptojnë përfitimet e tij. Përdoruesit fundorë janë treguesi kryesor i gjendjes së ekosistemit të ndërmjetësimi.

Pranimi i ndërmjetësimit nga përdoruesit fundorë	Përdoruesit fundorë do të marrin pjesë në ndërmjetësim kur ai perceptohet si: • Zvogëlim i pasigurisë • Sigurim i konfidencialitetit • Ruajtje e marrëdhënieve të biznesit • Kursim i kohës dhe kostos • Sigurim i zbatimit, dhe rezultateve të qëndrueshme
Ngurrimi i përdoruesve fundorë për të përdorur ndërmjetësimin	Përdoruesit fundorë ngurrojnë të marrin pjesë në ndërmjetësim nëse: • Ka mungesë të ndërgjegjësimit për ndërmjetësimin si një mundësi për të pasur qasje në drejtësi • Ka keqkuptime se ndërmjetësimi është shenjë dobësie • Ka mungesë të udhëzimeve nga praktikuesit ose të klauzolave kontraktuale që promovojnë ndërmjetësimin • Ka procese të paqarta ose cilësi të paqëndrueshme të ndërmjetësuesit, dhe mungesë të aftësisë
Masat që mund të rrisin ndërgjegjësimin e përdoruesit fundor dhe të çojnë në pranimin e ndërmjetësimit:	Rritja e ndërgjegjësimit të përdoruesve kërkon përpjekje të koordinuara: • Institucionet që ofrojnë trajnime, akreditime, publikojnë standarde praktike dhe krijojnë rregulla transparente • Avokatët që i udhëzojnë klientët në mënyrë realiste dhe dekurajojnë negociatat pozicionale që e bëjnë ndërmjetësimin jo-funksional • Iniciativa për edukimin publik që shpjegojnë se si ndërmjetësimi përshtatet në planifikimin komercial dhe menaxhimin e rrezikut

Tabela 7.1: Përmbledhje për ndërgjegjësimin e përdoruesve fundorë lidhur me alternativat

Kur palët e interesit si qeveria, gjyqësori, ndërmjetësuesit, institucionet dhe aktorët tregtarë janë të bashkuar dhe punojnë së bashku për të mbështetur ekosistemin e ndërmjetësimit, kjo dërgon një sinjal të fuqishëm

se juridiksioni mund ta menaxhojë konfliktin në mënyrë të besueshme pa procese gjyqësore të tejzgjatura ose ndërhyrje të politizuar. Ky besim forcon klimën e biznesit dhe konkurrencën ekonomike, si dhe mbështet investimet e qëndrueshme.

Fuqizimi i ekosistemeve të arbitrazhit

Një ekosistem funksional i arbitrazhit ka shumë veçori të ngjashme me atë që nevojitet për të siguruar një ekosistem të fuqishëm të ndërmjetësimit. Në themel të, ai kërkon një kornizë ligjore moderne që njuh marrëveshjet e arbitrazhit, kufizon ndërhyrjen e panevojshme të gjykatës dhe siguron zbatimin efektiv të vendimeve të arbitrazhit.

Megjithatë, një ekosistem arbitrazhi që *lulëzon* shtrihet përtej dispozitave statutore. Varet nga një konstelacion më i gjerë i aktorëve si qeveria, legjislacioni i përparuar, një gjyqësor i aftë dhe pro-arbitrazhit, institucionet e arbitrazhit, arbitrat dhe avokatët e kualifikuar, universitetet dhe programet akademike juridike, shoqatat e avokatëve dhe përdoruesit fundorë komercialë që punojnë së bashku. Kur këto elementë vijnë në një linjë, arbitrazhi bëhet një mekanizëm i besueshëm, efikas dhe i parashikueshëm për zgjidhjen e kontesteve tregtare, duke rritur besimin e investitorëve dhe duke e pozicionuar juridiksionin si një vend të besueshëm për arbitrazhin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Korniza Ligjore

Një juridiksion i besueshëm dhe miqësor ndaj arbitrazhit fillon me një kornizë ligjore të qartë, moderne dhe të harmonizuar ndërkombëtarisht. Infrastruktura ligjore jo vetëm që duhet të pasqyrojë praktikën më të mira globale, por edhe të ofrojë procedura të parashikueshme, të minimizojë ndërhyrjet e panevojshme gjyqësore dhe të sigurojë hisedarët tregtarë, e në veçanti investitorët e huaj, se vendimet e arbitrazhit do të respektohen dhe zbatohen.

Korniza ligjore përbëhet nga dy shtylla themelore: angazhimet ndaj traktateve ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm për arbitrazh. Së bashku, këto përcaktojnë rregullat e angazhimit për palët që zgjedhin arbitrazhin dhe përcaktojnë rolin e gjykatave, institucioneve dhe arbitrave brenda sistemit të arbitrazhit.

Angazhimet ndaj së drejtës ndërkombëtare

Ratifikimi i Konventës së Nju Jorkut

Konventa e Nju Jorkut mbi Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit është gurthemeli i arbitrazhit tregtar ndërkombëtar. Me ratifikimin e Konventës, shteti zotohet:

- ➔ Të njoh dhe zbatojë vendimet e huaja të arbitrazhit, duke iu nënshtuar vetëm përjashtimeve të kufizuara dhe të përcaktuara ngushtë.
- ➔ T'i jep efekt marrëveshjeve të arbitrazhit duke i referuar palët në arbitrazh kur ekzistojnë marrëveshje të tilla.
- ➔ Të ofrojë një kornizë të unifikuar dhe të parashikueshme, të përafuar me komunitetin global të arbitrazhit.

Pa Konventën e Nju Jorkut, një juridiksion do të ketë vështirësi të bëhet një vend tërheqës për arbitrazh ose një vendndodhje e besueshme për zbatimin e vendimeve të arbitrazhit.

Ratifikimi i Konventës ICSID

Për shtetet që kërkojnë të tërheqin investime të huaja direkte, ratifikimi i Konventës ICSID shton një shtresë të mbrojtjes dhe besueshmërisë. Përfitimet janë si në vijim:

- ➔ Qasje e drejtpërdrejtë për investitorët dhe shtetet në arbitrazhin e ICSID-it
- ➔ Një sitem ligjor unik dhe i pavarur që bën zbatimin e që nuk kërkon që gjykatat kombëtare të shqyrtojnë vendimet e ICSID-it
- ➔ Rritja e besimit të investitorëve për shkak të mekanizmave të parashikueshëm dhe të depolitizuar të zgjidhjes së kontesteve.

Legjislacioni i brendshëm i arbitrazhit

Vetëm angazhimet ndërkombëtare nuk mjaftojnë. Një juridiksion duhet gjithashtu të miratojë legjislacion të brendshëm kombëtar për arbitrazhin, i cili është modern, gjithëpërfshirës dhe koherent, dhe i cili rregullon si arbitrazhin tregtar kombëtar, ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Harmonizimi me Ligjin Model të UNCITRAL-it

Një standard i pranuar gjerësisht është Ligji Model i UNCITRAL-it mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar Komercial, veçanërisht i rishikuar në vitin 2006. Për të siguruar parashikueshmëri dhe përputhshmëri me praktikën ndërkombëtare, ligjet vendase të arbitrazhit duhet:

- ➔ Të jenë në esencë në përputhje me Ligjin Model, idealisht duke miratuar dispozitat kryesore fjalë për fjalë, përveç rasteve kur devijimet janë të nevojshme dhe të justifikuara qartë
- ➔ Përfshirja e parimeve kryesore të Ligjit Model, të tilla si:
 - ▶ Kompetencz-Kompetenz (Neni 16), që lejon gjykatat e arbitrazhit të vendosin mbi juridiksionin e tyre
 - ▶ Ndërhyrje e kufizuar gjyqësore dhe një rol i përcaktuar qartë për gjyqësorin (Neni 5)
 - ▶ Njohja e marrëveshjeve të arbitrazhit dhe kërkesat fleksibile të formës që lejojnë marrëveshjet elektronike
 - ▶ Ekzistenca e një regjimi masash të përkohshme në përputhje me ndryshimet e vitit 2006
 - ▶ Arsytet e qarta për anulimin dhe refuzimin e zbatimit në përputhje me nenet 34 dhe 36.

Kur ligji ekzistues bazohet në Ligjin Model të UNCITRAL-it të vitit 1985, duhet të bëhen ndryshime për të pasqyruar përditësimet e vitit 2006, veçanërisht në lidhje me masat e përkohshme dhe komunikimet elektronike. Të njihet si UNCITRAL.

Në juridiksionin në përputhje me Ligjin Model, shteti duhet të kërkojë konfirmimin e UNCITRAL-it, duke pranuar njëkohësisht se disa dispozita janë të detyrueshme dhe nuk mund të përjashtohen nga to.

Mbyllja e boshllëqeve të brendshme në legjislacion

Shumë juridiksione që zhvillojnë korniza arbitrazhi hasin probleme të ngjashme, duke përfshirë:

- ➔ Mungesa e një legjislacioni gjithëpërfshirës për arbitrazhin lë boshllëqe në paanshmërinë, pavarësinë, konfidencialitetin dhe rregullat procedurale të arbitrave
- ➔ Mungesa e udhëzimeve statutoire mbi imunitetin ose përgjegjësinë e arbitrit potencialisht i pengon praktikuesit e kualifikuar të pranojnë emërimet
- ➔ Dispozitat e paqarta ose ku mungon konfidencialiteti çojnë në pasiguri në lidhje me pritjet e privatësisë në procedurat gjyqësore
- ➔ Mospërputhjet në mes të legjislacionit të arbitrazhit dhe kodit të procedurës civile
- ➔ Mungesa e rregullave të qarta mbi kostot, ndarjen e kostove ose rikuperimin e tyre
- ➔ Qasja e kufizuar publike në legjislacionin kyç — siç janë ligjet që nuk janë përkthyer në gjuhët që më së shumti përdoren në tregti — zvogëlon përdorshmërinë për palët ndërkombëtare

Adresimi i këtyre boshllëqeve është thelbësor për krijimin e një mjedisi arbitrazhi të parashikueshëm dhe tërheqës.

Roli i gjyqësorit

Një kornizë moderne arbitrazhi nuk mund të funksionojë në mënyrë efektive pa një gjyqësor që e kupton, respekton dhe mbështet procesin e arbitrazhit. Gjykatat luajnë një rol të kufizuar, por thelbësor në ruajtjen e integritetit të marrëveshjeve të arbitrazhit, duke ofruar mbështetje gjatë procedurave të arbitrazhit dhe duke siguruar që vendimet e arbitrazhit të njihen dhe të zbatohen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kur gjykatat demonstrojnë parashikueshmëri, neutralitet dhe efikasitet, aktet komercial fitojnë besim se juridiksioni është vërtet miqësor ndaj arbitrazhit.

Megjithatë, shumë sisteme gjyqësore në mbarë botën përballen me kufizime sistematike, duke përfshirë ekspozimin e kufizuar ndaj parimeve të arbitrazhit, zbatimin jokonsistencial të normave ndërkombëtare dhe mbingarkesën e madhe të lëndëve të prapambetura. Adresimi i këtyre sfidave — dhe ndërtimi i një gjyqësori të aftë për të përmbushur rolin e tij në mbështetjen e arbitrazhit — është thelbësor për një ekosistem të fortë të zgjidhjes së kontesteve komerciale.

Veçoritë e një gjyqësori pro-arbitrazhi

Një gjyqësor që mbështet arbitrazhin karakterizohet me:

- ✓ Kuptimin e rolit të të kufizuar, por thelbësor në ekosistemin e arbitrazhit: kryesisht referimi i kontesteve në arbitrazh, zbatimi i marrëveshjeve të arbitrazhit dhe njohja dhe zbatimi i vendimeve të arbitrazhit vendas dhe të huaj
- ✓ Respektimin e Kompetenz-Kompetenz, duke i lejuar gjykatave të arbitrazhit të vendosin mbi juridiksionin e tyre
- ✓ Shpërndarjen në kohë e funksioneve mbështetëse të arbitrazhit dhe mbikëqyrjes, duke përfshirë emërimet, masat e përkohshme dhe kërkesat për zbatim
- ✓ Parashikueshmëri dhe përmbajtje, duke ndërhyrë vetëm aty ku lejohet shprehimisht sipas ligjit vendas ose angazhimeve ndërkombëtare, siç është Konventa e Nju Jorkut
- ✓ Interpretim konsistent dhe i ngushtë i përjashtimit të politikës publike, në përputhje me Nenin V të Konventës së Nju Jorkut
- ✓ Gjykime të qarta, të arsyetuara mirë dhe të arritshme që kontribuojnë në transparencë dhe qëndrueshmëri, si dhe rrisin besimin ndërkombëtar të përdoruesve

Shkurt, gjykatat duhet të veprojnë si roje, jo si mbikëqyrëse, të procesit të arbitrazhit. Këto cilësi mësohen dhe kultivohen; ato nuk lindin automatikisht nga legjislacioni.

Sfidat gjyqësore dhe objektivat kryesore në mbështetjen e një juridiksioni miqësor ndaj arbitrazhit

Në shumë juridiksione, gjykatat përballen me pengesa të konsiderueshme në trajtimin e çështjeve që lidhen me arbitrazhin. Këto sfida zakonisht përfshijnë:



Ekziston një njohuri e kufizuar me parimet thelbësore të arbitrazhit, duke përfshirë Ligjin Model të UNCITRAL-it, Konventën e Nju Jorkut dhe praktikat më të mira ndërkombëtare



Pasiguria në lidhje me fushëveprimin dhe kufijtë e përjashtimit të politikës publike sipas Konventës së Nju Jorkut, nganjëherë, çon në refuzime tepër të gjera për të zbatuar vendimet e arbitrazhit



Arbitrazhi shihet si një mekanizëm i jashtëzakonshëm ose i panjohur dhe jo si një paralele me mekanizmat kryesorë brenda sistemit të zgjidhjes së kontesteve komerciale



Numri i madh i rasteve të pazgjidhura në gjykatë vonon aplikimet që lidhen me arbitrazhin dhe dëmtojnë administrimin në kohë të drejtësisë

Së bashku, këto çështje dobësojnë besueshmërinë e juridiksionit si vend i mbajtjes së arbitrazhit dhe si vend për zbatim. Këto kufizime sistematike theksojnë nevojën për të forcuar kuptimin, kapacitetin dhe efikasitetin procedural gjyqësor.

Një mënyrë për të lehtësuar presionin gjyqësor është përmes mekanizmave të ZAK-së, siç është ndërmjetësimi i lidhur me gjykatën, i diskutuar më sipër, që u lejon gjyqtarëve t'i referojnë kontestet e përshtatshme ndërmjetësimit dhe ta rezervojnë gjykimin për rastet që vërtetë kërkojnë ndërhyrje gjyqësore.

Për të ndërtuar një ekosistem miqësor ndaj arbitrazhit, gjyqësorët mund të ndjekin gjithashtu disa objektiva kryesore:



Përpunim me shpejtësi dhe efikasitet i funksioneve gjyqësore që lidhen me arbitrazhin, duke përfshirë masat e përkohshme, emërimet dhe kundërshtimet e arbitrave, si dhe njohjen dhe zbatimin e vendimeve



Zhvillim i një kornize gjyqtarësh të specializuar ose të divizioneve të dedikuara komerciale me ekspertizë në manovrimin nëpër legjislacionin vendas mbi arbitrazhin dhe lidhjen me arbitrazhin ndërkombëtar



Ofrim i udhëzimeve gjyqësore transparente dhe të parashikueshme, veçanërisht mbi standardet e ekzekutimit dhe zbatimin e përjashtimit të politikës publike të përfshirë në Konventën e Nju Jorkut



Sigurim që vendimet gjyqësore që lidhen me arbitrazhin të jenë të arritshme publikisht, të qëndrueshme dhe t'u mundësojnë përdoruesve ndërkombëtarë të vlerësojnë jurisprudencën dhe besueshmërinë e juridiksionit

Së bashku, këto reforma gjyqësore forcojnë besueshmërinë e juridiksionit, rrisin besimin e investitorëve dhe rrisin atraktivitetin e tij si një vend i besueshëm për arbitrazh dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit.

Masat për të forcuar mbështetjen gjyqësore të ZAK-së

Për t'i përkthyer këto objektiva në reforma praktike, juridiksionet mund të miratojnë një sërë masash të synuara, të hartuara për të rritur kompetencën, efikasitetin dhe parashikueshmërinë gjyqësore në çështjet që lidhen me arbitrazhin.

Hapat në vijim përfaqësojnë një plan për ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pajisur mirë për të mbështetur arbitrazhin — nga zhvillimi i ekspertizës së specializuar gjyqësore deri te përmirësimi i procedurave, përmirësimi i transparencës dhe nxitja e bashkëpunimit me institucionet e arbitrazhit.

Gjyqësorët mund të:

- Përpilojnë lista të specializuara për arbitrazh ose ato komerciale
- Krijojnë programe dhe udhëzues të trajnimit gjyqësor
- Miratojnë protokolle për trajtimin e përshpejtuar të dorëzimeve të parashitësve në arbitrazh
- Publikojnë udhëzime praktike mbi zbatimin dhe politikat publike
- Përmirësojnë menaxhimin e lëndëve dhe përdorimin e teknologjisë
- Krijojnë lidhje gjyqësore me institucionet e arbitrazhit

Kur zbatohen së bashku, këto masa krijojnë një kornizë koherente që forcon rolin e gjyqësorit brenda ekosistemit më të gjerë të arbitrazhit dhe rrit besimin si në mes të përdoruesve vendas ashtu edhe ndërkombëtarë.

Për të mbështetur politikëbërësit në zbatimin e këtyre parimeve, ne ofrojmë rekomandime të konsoliduara që përshkruajnë komponentët kryesorë që

mund të rrisin mbështetjen gjyqësore për ZAK-në, siç detajohet më tej në Shtojcën [A].

Qendrat e Pavarura të ZAK-së: Ndërtimi i besimit, kredibilitetit dhe kapacitetit institucional

Qendrat e pavarura të ZAK-së janë shtylla kritike të një ekosistemi të zgjidhjes së kontesteve që funksionon mirë. Këto qendra drejtohen privatisht, janë të ndara nga gjykatat ose ndonjë entitet shtetëror. Legjitimiteti, profesionalizmi dhe qasshmëria e tyre formësojnë mënyrën se si bizneset, praktikuesit dhe investitorët e huaj e perceptojnë angazhimin e juridiksionit për zgjidhje të drejtë, efikase dhe moderne të kontesteve.

Institucionet e forta shërbejnë si provë e dukshme se ZAK nuk është thjesht teorik, por mbështetet në mënyrë aktive nga një menaxhim i besueshëm i rasteve, neutralë të kualifikuar, rregulla transparente dhe një angazhim për përmirësim të vazhdueshëm. Për politikëbërësit, investimi në një qendër ZAK është ndër reformat më të dukshme dhe me ndikim, pasi u ofron bizneseve një vend të qartë dhe neutral për zgjidhjen e kontesteve.

Kur qendrat e pavarura veprojnë në mënyrë efektive, ato krijojnë një efekt shumëfishues: ato legjitimojnë ZAK-në në sytë e përdoruesve, ofrojnë mundësi trajnimi praktik për studentët dhe praktikuesit e rinj (të tilla si përmes programave përfshirëse të stazhit Vis Moot), organizojnë ngjarje rajonale që rrisin ndërgjegjësimin dhe ndihmojnë në ndryshimin e kulturave që fillimisht mund të jenë skeptike ndaj ZAK-së. Përvojat nga juridiksione të ndryshme tregojnë se edhe aty ku ZAK është pritur fillimisht me dyshime, investimet e qëndrueshme institucionale, të tilla si programet e trajnimit, javët e ndërgjegjësimit për ZAK dhe administrimi transparent i rasteve, mund të rrisin ndjeshëm besimin dhe përdorimin e publikut me kalimin e kohës.

Qendrat e pavarura të ZAK-së janë pra shumë më tepër sesa organe administrative - ato janë motorë të legjitimitetit, inovacionit dhe zhvillimit profesional që forcojnë sundimin e ligjit. Kur qeverisen mirë dhe kanë burime të mjaftueshme, ato mbështesin ekosistemin e arbitrazhit dhe ndërmjetësimit, nxisin besimin e publikut dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në reputacionin e një juridiksioni si një vend i besueshëm për zgjidhjen e kontesteve.

RAST STUDIMOR:

Fuqizimi i qendrave të pavarura të ZAK-së për të tërhequr investimet e huaja

Sfida	Zgjidhja
CLDP punon me një vend të vogël partner që kërkon të rrisë investimet e huaja, por përballet me pengesa të vazhdueshme në fushën e zgjidhjes së kontesteve. Qasja mbizotëruese në mes të bizneseve dhe praktikuesve ishte të mos i drejtoheshin gjykatave vendase në gjyq, dhe kishte një kuptim ose pranim të kufizuar kulturor të mekanizmave të ZAK-së, siç janë ndërmjetësimi dhe arbitrazhi. Kur CLDP filloi angazhimin, qendra e pavarur ZAK e vendit po përpigëj të zgjeronte reputacionin. Qendra trajtoi më pak se pesë raste në vit, i mungonte dukshmëria dhe kishte vështirësi në demonstrimin e vlerës së saj për komunitetin vendas të biznesit, investitorët e huaj dhe juristët. Kjo përfshirje e kufizuar kontribuoi edhe në rezultat të ulët të vendit në treguesit e lehtësisë së të bërit biznes në lidhje me zbatimin e kontratave dhe zgjidhjen e kontesteve. Me një ngarkesë minimale rastesh dhe besueshmëri të kufizuar, qendra u përball me një sfidë të vështirë në pozicionimin e saj si një institucion i besueshëm i aftë për të mbështetur rritjen tregtare.	Gjatë disa viteve, CLDP bashkëpunoi ngushtë me qendrën e pavarur të ZAK-së për të forcuar kapacitetin e saj institucional dhe për të promovuar një kulturë të ZAK-së. CLDP lehtësoi angazhimin e qëndrueshëm rajonal - duke e lidhur qendrën me institucionet dhe ekspertët e vendosur të ZAK - dhe e mbështeti atë në përvetësimin e praktikave më të mira ndërkombëtare. CLDP gjithashtu e ndihmoi qendrën të zgjerojë ndikimin profesional duke organizuar konferenca dhe trajnime gjithëpërfshirëse në ndërmjetësim dhe arbitrazh. Këto programe tërhoqën anëtarë të komunitetit ligjor, studentë të juridikut, homologë rajonalë të ZAK-së dhe përfaqësues nga firma kryesore ligjore globale. Qendra gjithashtu filloi të bashkëpunojë me gjyqtarët e Gjykatës Supreme për integrimin e ZAK-së dhe mbështetjen gjyqësore. Si rezultat i këtij angazhimi afatgjatë, qendra ZAK është shndërruar në një organizator rajonal të respektuar dhe një opsion të besueshëm për zgjidhjen e kontesteve, duke luajtur një rol kyç në përmirësimin e mjedisit komercial të vendit dhe besimit të investitorëve.

Për të mbështetur praktikuesit, politikëbërësit dhe institucionet e reja të ZAK-së në zbatimin e këtyre parimeve, ne ofrojmë rekomandime të konsoliduara që ofrojnë komponentët kryesorë të një qendre të fortë dhe të besueshme të ZAK-së në Shtojcën [B].

Universitetet: Ndërtimi i gjeneratës së ardhshme të praktikuesve të ZAK-së

Universitetet luajnë një rol themelor në formësimin e së ardhmes së ekosistemit të ZAK-së duke edukuar brezin e ardhshëm të avokatëve, arbitrave, ndërmjetësuesve dhe udhëheqësve të politikave. Kapaciteti afatgjatë i një juridiksioni për të mbështetur një mjedis modern arbitrazhi

dhe ndërmjetësimi varet shumë nga forca e sistemit të tij të arsimit ligjor dhe mundësitë që u ofrohen studentëve për t'u kyçur me ZAK-në si në teori ashtu edhe në praktikë.

Integrimi i ZAK-së në kurrikulën juridike

Një juridiksion nuk mund të mbështesë një ekosistem modern të ZAK-së pa një rrjet profesionistësh të trajnuar. Prandaj, universitetet shërbejnë si themeli afatgjatë i sistemit, duke siguruar vazhdimësinë dhe normalizimin kulturor të praktikës së ZAK-së. Një kurrikulë bashkëkohore juridike duhet t'i ekspozojë studentët ndaj spektrit të plotë të mekanizmave të zgjidhjes së kontesteve — arbitrazhit, ndërmjetësimit, negociimit, gjykimit dhe shmangies së kontesteve. Elementet kryesore për integrimin e ZAK-së në kurrikulën universitare përfshijnë:



Kurse të dedikuara për ZAK që mbulojnë arbitrazhin tregtar ndërkombëtar, praktikën e ndërmjetësimit, hartimin e klauzolave të arbitrazhit, strategjinë procedurale dhe mekanizmat e ekzekutimit sipas Konventës së Nju Jorkut.



Mësim i bazuar në simulim, siç janë arbitrazhet, ndërmjetësimet dhe negociatat e simuluar, për të ndërtuar aftësi praktike në avokim, strategji zgjidhjeje dhe analizë të rasteve.



Komponentë ndërdisiplinorë, duke u mbështetur në biznes, psikologji, ekonomi dhe marrëdhënie ndërkombëtare për të ndihmuar studentët të kuptojnë dinamikën tregtare dhe sjelljet konfliktuale.



Ligjërues mysafir dhe punëtori të ofruara nga praktikues, arbitra, ndërmjetësues dhe ekspertë ndërkombëtarë të cilët mund të ofrojnë njohuri mbi praktikën e botës reale.

Fig. 7.1: Elementet thelbësore për integrimin e ZAK-së në një kurrikulë universitare

Duke përfshirë ZAK-në në kurrikulë, universitetet sigurojnë që studentët të diplomohen me një kuptim themelor të proceseve që përdoren më shpesh në tregtinë ndërkombëtare sot, duke mbjellë kështu farat për pranim kulturor dhe ekosisteme me prosperitet për ZAK-në.

Mbështetja për pjesëmarrje në simulimin ndërkombëtar të arbitrazhit tregtar Willem C. Vis dhe gara të tjera ndërkombëtare

Pjesëmarrja në garën e simulimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit Tregtar Willem C. Vis dhe në konkurse të ngjashme të gjykatës simuluese është ndër mënyrat më efektive për të trajnuar studentët e drejtësisë në arbitrazhin ndërkombëtar.

Universitetet duhet të marrin parasysh:

- ➔ Ofrimi i mbështetjes institucionale për ekipet e Vis Moot, duke përfshirë trajnimin, ndihmën me kërkime dhe mbështetjen financiare për të marrë pjesë në raundet gojore
- ➔ Integrimi i përgatitjes për Vis Moot në strukturat akademike të krediteve ose seminareve, duke njohur aftësitë rigoroze të kërkimit ligjor dhe avokimit që zhvillojnë studentët
- ➔ Krijimi i Shoqatave Alumni të Vis Moot në bashkëpunim me ekipe të tjera në të njëjtin vend ose rajon për të siguruar vazhdimësi, mentorim dhe transferim të qëndrueshëm të njohurive në mesin e brezave të studentëve

Në fund të fundit, këta studentë shpesh bëhen brezi i parë i praktikuesve vendas të arbitrazhit — duke mbushur një boshllëk që asnjë legjislacion si i vetëm nuk mund ta zgjidhë.

RAST STUDIMOR:

Ndërtimi i gjeneratës së re të praktikuesve të ZAK-së

Sfida	Zgjidhja
Në shumë juridiksione në zhvillim në Azinë Qendrore, Euroazi, Azinë Jugore dhe Evropën Lindore, ZAK-ja - veçanërisht arbitrazhi tregtar ndërkombëtar - ishte perceptuar prej kohësh si e paarritshme, e panjohur ose e jo e përshtatshme nga aspekti kulturor. Historikisht, praktika e sofistikuar e arbitrazhit ka qenë e përqendruar në qendra globale si Londra, Parisi dhe Nju Jorku, duke i lënë gjykatat dhe praktikuesit vendas pa një ekspozim domethënës ndaj teknikave moderne të ZAK-së. Në shumë vende partnere, nuk kishte një kuadër vendas të praktikuesve të arbitrazhit dhe ZAK hasi në rezistencë brenda komunitetit ligjor dhe në mesin e akterëve tregtarë. Si rezultat, bizneseve u mungonin alternativa të qëndrueshme ndaj sistemeve gjyqësore të ngadalta ose pa përvojë, si dhe vendet luftuan për t'u integruar në mjedisin global të tregtisë dhe investimeve.	Për shumë vite, CLDP ka ndihmuar në transformimin e këtyre fushave të ZAK-së duke mbështetur pjesëmarrjen e studentëve në garën ndërkombëtare të arbitrazhit tregtar Willem C. Vis. Duke punuar me ekspertë kryesorë ndërkombëtarë të arbitrazhit, CLDP ka ofruar kampe intensive për ushtrime, trajnime gjithëpërfshirëse dhe gara rajonale të simulimit para-simulimit të mbajtura direkt në vendet partnere. Këto programe kanë prodhuar grupe studentësh që jo vetëm garojnë me sukses në Vjenë dhe Hong Kong, por që më vonë kthehen si trajnerë, lektorë dhe mentorë, duke ndërtuar një ekosistem kombëtar të vetëmjaftueshëm të ekspertizës në arbitrazh. Sot, shumë vende në këto rajone e kanë institucionalizuar pjesëmarrjen në Vis, kanë formuar shoqata aktive alumni (të ish-studentëve) të Visit dhe madje kanë organizuar kampet e tyre kombëtare dhe rajonale të trajnimit Vis. Ky investim afatgjatë ka katalizuar një ndërrim brezash: juridiksionet që dikur nuk kishin asnjë prani domethënëse të ZAK-së, tani krenohen me praktikues të sofistikuar të arbitrazhit.

Të lartcekurat tregojnë se pjesëmarrja në garën simuluese të Vis dhe gara të ngjashme simuluese forcojnë aftësitë e studentëve në aspektin analitik ligjor, të shkrimit dhe të avokimit, i ekspozon ata ndaj të drejtës ndërkombëtare tregtare dhe i lidh ata me një rrjet global praktikuesish të ardhshëm — duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen afatgjatë të kapacitetit të ZAK-së në juridiksion.

RAST STUDIMOR: Ballkani Perëndimor

Rreth Programit Vis Moot

Programi Vis Moot në Ballkan Perëndimor, i iniciuar dhe i mbështetur nga CLDP që nga viti 2015, tregon një histori të jashtëzakonshme suksesi që ka transformuar fushën ligjore dhe praktikën e ZAK-së në rajon. Që nga nisma, programi ka ofruar trajnime intensive, materiale kërkimore dhe mbështetje nga ekspertë për ekipet dhe trajnerët nga 10 universitete në rajon. Përtej performancave të tyre të shquara në Vis Moot, në kohën e shkrimit të këtij dokumenti, programi ka krijuar 10 breza juristësh shumë të përkushtuar, të trajnuar dhe kompetentë, të cilët tani po lulëzojnë në firma të mëdha ligjore vendase dhe ndërkombëtare, universitete, sisteme gjyqësore, organizata ndërkombëtare dhe institucione qeveritare.

Një dekadë e programit Vis Moot në Ballkan Perëndimor në numra

- 20 programe intensive trajnimi
- 12 gara rajonale të suksesshme para-simulimit
- 250 studentë dhe 57 trajnerë të trajnuar dhe të mbështetur
- 14 kualifikime në raundet eliminatorë, përfshirë gjysmëfinalet në 3 raste
- 18 bursa për diploma Master në juridik, në universitete evropiane dhe amerikane
- Qindra stazhe në firma ligjore kryesore vendase dhe ndërkombëtare

Krijimi i programeve për stazhe të fokusuara në ZAK për studentët e juridikut

Për të kapërcyer hendekun në mes të studimit akademik dhe praktikës profesionale, universitetet duhet të bashkëpunojnë me hisedarët kombëtarë dhe ndërkombëtarë për të krijuar praktika të strukturuar të ZAK-së, për t'u dhënë studentëve përvojë praktike pune në zgjidhjen alternative të kontesteve.

Tre shtigje kryesore të stazhit janë veçanërisht të vlefshme:

- ➔ Stazhi me institucione ndërkombëtare, kombëtare ose rajonale të arbitrazhit
- ➔ Stazhi në firmat ligjore ose departamentet ligjore të korporatave të specializuara në arbitrazh
- ➔ Stazhi në gjykata që merren me arbitrazh ose çështje që lidhen me ZAK-në

Duke integruar thellësisht ZAK-në në arsimin juridik, duke mbështetur gara kryesore si Vis Moot dhe duke ofruar mundësi të strukturuar trajnimi

praktik, universitetet bëhen kontribues thelbësorë në një ekosistem të qëndrueshëm dhe të lulëzuar të ZAK-së. Roli i tyre siguron jo vetëm zhvillimin e ekspertizës teknike, por edhe kultivon një kulturë që çmon zgjidhjen efikase, të drejtë dhe në përputhje me normat ndërkombëtare të kontesteve.

Odat e avokatëve: Formësimi i kulturës dhe praktikës profesionale të ZAK

Odat e avokatëve luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në formësimin e normave dhe qëndrimeve profesionale që përcaktojnë se sa gjerësisht pranohen dhe përdoren në praktikë mekanizmat e ZAK-së - duke përfshirë arbitrazhin dhe ndërmjetësimin. Megjithatë, në disa juridiksione, odat e avokatëve kanë qenë një burim rezistence ndaj reformës së ZAK-së. Kjo rezistencë shpesh buron nga keqkuptimet: disa praktikues e shohin arbitrazhin dhe ndërmjetësimin si procese që shkurtojnë jetëgjatësinë e kontesteve, duke zvogëluar potencialisht orët e faturueshme dhe duke e bërë ZAK-në të duket më pak tërheqës financiarisht sesa proceset gjyqësore tradicionale.

Tejkalimi i këtyre perceptimeve kërkon një përpjekje të qëllimshme për të kultivuar një kulturë profesionale më të informuar. Odat e avokatëve mund të jenë aleatë të fuqishëm në këtë proces duke:



Zhvilluar dhe mandatuar programe të Arsimit të Vazhdueshëm Ligjor (CLE) i fokusuar në arbitrazh, ndërmjetësim, negociim dhe shmangie të kontesteve, duke siguruar që praktikuesit të kuptojnë se si ZAK mund t'u ofrojë vlerë klientëve, të zvogëlojë rrezikun dhe të rrisë besueshmërinë profesionale.



Organizuar punëtori, diskutime në panel dhe trajnime të bazuara në aftësi që i ekspozojnë praktikuesit ndaj realiteteve të zgjidhjes moderne të kontesteve, duke përfshirë kërkesën në rritje në mes të klientëve komercialë për procese efikase dhe të orientuara drejt biznesit.



Partneritet me institucionet e arbitrazhit, universitetet dhe organet e trajnimit gjyqësor për të siguruar dërgimin e mesazheve të qëndrueshme në të gjithë profesionin dhe për të krijuar një rrjet avokatësh të rinj kompetentë në praktikën e ZAK-së.

Fig. 7.2: Metoda të mundshme për ndërtimin e ndërgjegjësimit për ZAK-në

Me mishërimin e këtyre roleve, shoqatat e avokatëve ndihmojnë në korrigjimin e keqkuptimeve, në forcimin e kapacitetit të komunitetit ligjor për t'i shërbyer përdoruesve komercialë dhe në sigurimin që ZAK të bëhet një komponent integral dhe i respektuar i fushës së zgjidhjes së kontesteve. Përfshirja e tyre është thelbësore për ndërtimin e një ekosistemi të qëndrueshëm në të cilin avokatët e shohin ZAK-në jo si një kërcënim për praktikën tradicionale, por si një rrugë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve ligjore në kohë, efektive dhe të përqendruara te klienti.

Ndërgjegjësimi i përdoruesve fundorë komercialë

Një ekosistem i fortë arbitrazhi varet jo vetëm nga ligjet e shëndosha dhe një gjyqësor i aftë, por edhe nga ndërgjegjësimi dhe besimi i bizneseve që mbështeten në këto mekanizma. Në shumë juridiksione, arbitrazhi dhe proceset e tjera të ZAK mbeten të panjohura për palët tregtare - ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) - të cilave shpesh u mungon qasja në udhëzime të specializuara juridike ose ekspozimi ndaj praktikave ndërkombëtare të kontraktimit.

Si rezultat, bizneset mund të dështojnë në përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit në kontratat e tyre, të keqkuptojnë avantazhet e ZAK-së ose të shkojnë me opsionin e procesit gjyqësor edhe kur ekzistojnë mundësi më efikase. Kur bizneset integrojnë klauzolat e ZAK-së në kontrata, mjedisi i zgjidhjes së kontesteve të juridiksionit bëhet më i parashikueshëm, duke ulur primet e rrezikut dhe duke mbështetur drejtpërdrejt investimet dhe rritjen ekonomike.

Por ndërtimi i një kulture në të cilën akterët komercialë e kuptojnë, besojnë dhe e përdorin në mënyrë proaktive ZAK-në kërkon edukim dhe shtrirje të qëllimshme të publikut. Kjo përfshin:



Udhëzues dhe complete veglash praktike - duke përfshirë klauzolat model për zgjidhjen e kontesteve dhe udhëzimet hap pas hapi - të përshtatura për NVM, këshilltarët juridik të brendshëm, zyrtarët e prokurimit dhe entitetet qeveritare.



Ngjarje dhe fushata me publikun, siç është Dita vjetore për ZAK ose Muaji i ndërgjegjësimit për ZAK, punëtori me temë të ZAK-së, simulime të ndërmjetësimit, ditë e institucioneve me dyer të hapura dhe seanca mësimi ndëreveprues.



Iniciativa ndërgjegjësimi në të gjithë vendin që shpjegojnë qartë se si funksionojnë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, përfitimet e tyre dhe shembuj të rezultateve të suksesshme.

Fig. 7.3: Metoda të mundshme për ndërtimin e ndërgjegjësimit për ZAK-në

Kur bizneset — të mëdha dhe të vogla — e kuptojnë se si funksionojnë mekanizmat e ZAK-së dhe si t'i përfshijnë ato në kontrata që nga fillimi, kontestet kanë më pak gjasa të përshkallëzohen në padi të kushtueshme. Kjo rritje e vetëdijës në mesin e përdoruesve fundorë forcon mjedisin e përgjithshëm të zgjidhjes së kontesteve, nxit zgjidhjen e hershme dhe rrit atraktivitetin e juridiksionit për investorët që kërkojnë mënyra të parashikueshme dhe të orientuara komercialisht për të menaxhuar rrezikun.

Burimet e dobishme

Kompleti i veglave të politikave dhe zbatimit

- ➔ UNCITRAL, Draft i setit të veglave mbi parandalimin dhe zbutjen e kontesteve ndërkombëtare të investimeve (A/CN.9/1185) (2024): https://uncitral.un.org/sites/uncitral.un.org/files/media-documents/uncitral/en/toolkit_on_prevention_and_mitigation_for_website_2_2.pdf
- ➔ ICSID, Shënime Praktike për të Anketuarit në Arbitrazhin ICSID (2015): <https://icsid.worldbank.org/sites/default/files/publications/Practice%20Notes%20for%20Respondents%20-%20Final.pdf>
- ➔ Komisioni i ICC-së për Arbitrazhin dhe ZAK, Udhëzues për Menaxhimin Efektiv të Arbitrazhit: Një Udhëzues për Këshilltarët e Brendshëm dhe Përfaqësuesit e Partive të Tjera (2017): <https://iccwbo.org/news-publications/arbitration-adr-rules-and-tools/effective-management-of-arbitration-a-guide-for-in-house-counsel-and-other-party-representatives/>

Edukimi dhe simulimi

- ➔ Willem C. Vis International Commercial Arbitrage Moot (një konkurs studentor në fushën e ligjit tregtar dhe të shitjes së mallrave) (së shpejti, 2026): <https://www.vismoot.org/>
- ➔ Simulimi i Gjykatës së Arbitrazhit të Investimeve në Frankfurt (një garë studentore në fushën e ligjit të mbrojtjes së investimeve) (pa datë): <https://www.investmentmoot.org/>
- ➔ Simulimi i Arbitrazhit Ndërkombëtar për Investimet e Huaja Direkte (një garë studentore në fushën e ligjit të mbrojtjes së investimeve) (2025): <https://fdimoot.org/>
- ➔ Garë e Ndërmjetësimit i Odës Ndërkombëtare të Tregtisë (një garë në ndërmjetësim) (së shpejti, 2026):: <https://iccwbo.org/dispute-resolution/dispute-resolution-services/adr/mediation/mediation-competition-week/>

Konventat kryesore dhe modelet e ligjeve

- Kombet e Bashkuara, Konventa për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (1958): <https://www.newyorkconvention.org/english>
- Kombet e Bashkuara, Konventa mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare të Zgjidhjes që Rezultojnë nga Ndërmjetësimi (2018): https://uncitral.un.org/en/texts/mediation/conventions/inter-national_settlement_agreements
- UNCITRAL, Ligji Model për Arbitrazhin e Tregtisë Ndërkombëtare (1985) (ndryshimet e miratuara në vitin 2006): https://uncitral.un.org/en/texts/arbitration/modellaw/commercial_arbitration
- UNCITRAL, Ligji Model mbi Ndërmjetësimin Tregtar Ndërkombëtar dhe Marrëveshjet Ndërkombëtare të Zgjidhjes që Rezultojnë nga Ndërmjetësimi (2018): https://uncitral.un.org/en/texts/mediation/modellaw/commercial_conciliation

Ligji i butë

- Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (IBA), Udhëzimet mbi Konfliktet e Interesit në Arbitrazh Ndërkombëtar (2024): <https://www.ibanet.org/document?id=guide-lines-on-conflicts-of-interest-in-international-arbitration-2024>
- Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (IBA), Udhëzimet mbi Marrjen e Provave në Arbitrazh Ndërkombëtar (2020): <https://www.ibanet.org/MediaHandler?id=def0807b-9fec-43ef-b624-f2cb2af7cf7b>
- Institut i Çertifikuar i Arbitrave (CIARB), Udhëzimet e Praktikës Profesionale (pa datë): <https://www.ciarb.org/resources/professional-practice-guidelines>

Përfundim

Siç ilustron kapitujt e mëparshëm, ZAK u ofron shteteve një larmi të fuqishme të arkitekturës së politikave dhe funksioneve të menaxhimit të kontesteve. Përfitimi më i dukshëm, sigurisht, është zgjidhja. Megjithatë, kontributi më i thellë është sistemik — rregulla që balancohen me kërkesën, institucione që tërheqin përdoruesit dhe ngjallin besim, si dhe procese që fitojnë legjitimitet përmes transparencës dhe zbatimit të qëndrueshëm e të parashikueshëm.

Dy fusha janë të rëndësishme për t'u marrë në konsideratë nga politikëbërësit shtetërorë: përfshirja e qëllimshme e brendshme e sistemeve të ZAK-së dhe pjesëmarrja e vetë shteteve në ZAK.

Sa i përket të parës, ZAK premton qasje më të madhe në drejtësi për të gjithë, zvogëlon barrën mbi gjyqësorin e mbingarkuar, stabilizon mjedisin e biznesit dhe investimeve dhe u mundëson përdoruesve komercialë të zgjidhin kontestet shpejt, lirë dhe me efikasitet. Për shtetet, inkurajimi i përdoruesve për të zgjidhur kontestet sipas kushteve të tyre është zakonisht qasja më e mirë. Përmes kësaj, përdoruesit privatë fuqizohen me korniza ligjore të besueshme, inovacioni lulëzon dhe mund të tejkalojnë përditësimin ligjislativ. Fleksibiliteti i krijuar me ZAK u lejon përdoruesve të zgjidhin kontestet me zgjidhje të qëndrueshme në mënyrë krijuese. Roli i shtetit, përfshirë gjyqësorin e tij, është plotësues, jo konkurrues. Shteti përcakton politikat dhe siguron mbikëqyrjen e nevojshme, por roli i tij në ZAK nuk është funksional.

Sa i përket kësaj të fundit, shtetet e kanë kuptuar prej kohësh se inkurajimi i investimeve të huaja direkte kërkon përmbushjen e disa pritjeve të investitorëve ndërkombëtarë, por pjesëmarrja e shtetit në metodat ZAK të përfshira në marrëveshjet e investimit ka qenë e përzier. Perceptimet e shtrembëruara në lidhje me sistemin e kontesteve të investimeve dhe praktikën e tij kanë nxitur pabarazi në pjesëmarrje dhe, potencialisht, në rezultate. Përmes pjesëmarrjes së informuar, shtetet mund t'i kuptojnë më mirë pikat e vendimmarrjes në këto konteste, pavarësisht nëse trajtohen nga zyrtarët apo së bashku me këshilltarë të jashtëm, dhe të përfitojnë nga zgjidhja e vetëvendosur e kontesteve.

Në fund të fundit, përdoruesit e zbatojnë ZAK-në për qëllimet e tyre. Siç u shqyrtua në këtë libër, bazohet në idenë e thjeshtë, por të fuqishme, se njerëzit, kur u jepet struktura dhe mbështetja e duhur, mund të hartojnë më së miri zgjidhjet e tyre për konfliktin. Në tregtinë globale, kjo ide merr edhe më shumë rëndësi, derisa pjesëmarrësit veprojnë përtej dallimeve

gjeografike, kulturore dhe ligjore. Krahas secilit prej këtyre dimensioneve, ZAK ofron zgjidhje për të tejkaluar këto dallime, për të zgjidhur në mënyrë paqësore kontestet dhe për të siguruar një rrugë përpara në një botë në ndryshim të vazhdueshëm.

SHTOJCA A:

Udhërrëfytesi i CLDP-së për fuqizimin e mbështetjes gjyqësore për ZAK

Tabela më poshtë përmbledh reformat kryesore gjyqësore të diskutuara në *KAPITULLI 7: Udhërrëfytesi për hartimin e sistemeve efektive dhe efikase të ZAK-së* në një vegël praktike referimi për politikëbërësit, gjyqtarët dhe administratorët e gjykatave. Derisa teksti kryesor përshkruan arsyetimin për forcimin e kompetencës gjyqësore, efikasitetit dhe parashikueshmërisë në çështjet që lidhen me arbitrazhin, kjo shtojcë i përkthen këto koncepte në një sërë të qartë masash të zbatueshme. E paraqitur si një planimetri, tabela nxjerr në pah hapat institucionalë që sistemet gjyqësore mund të ndërmarrin për të mbështetur më mirë arbitrazhin, duke filluar nga krijimi i listave të specializuara deri te përmirësimet në menaxhimin e lëndëve, trajnimin, transparencën dhe bashkëpunimin me institucionet e arbitrazhit.

Duke i organizuar këto rekomandime në një format të strukturuar, shtojca shërben edhe si një udhëzues diagnostikues për vlerësimin e praktikës aktuale gjyqësore, edhe një udhërrëfyes për juridiksionet që kërkojnë të rrisin besueshmërinë dhe efektivitetin e tyre brenda ekosistemit më të gjerë të arbitrazhit.

1. Krijimi i listave të specializuara të arbitrazhit ose komerciale	• Të caktohet një panel gjyqtarësh me trajnim të specializuar në arbitrazh për të trajtuar: - Emërimet dhe kundërshtimet e aplikimeve - Ndihmën e përkohshme në mbështetje të arbitrazhit - Zbatimin dhe procedurat e anashkalimit • Zbatimin e rregullave të përshpejtuara të menaxhimit të lëndëve për çështjet e arbitrazhit
2. Krijimi i programeve të trajnimit dhe udhëzuesve të gjyqtësorit	• Të zhvillohen udhëzues që përshkruajnë qasjen e juridiksionit ndaj arbitrazhit, duke iu referuar: - Kompetenz-Kompetenz - Procedurave të zbatimit - Interpretimit të politikave publike - Obligimeve të Konventës së Nju Jorkut • Të krijohen partneritete me partnerë ndërkombëtarë si UNCITRAL, CIArb, qeveri të huaja ose gjykata të huaja, si dhe institucione arbitrazhi për të ofruar edukim të vazhdueshëm gjyqësor • Trajnimet të përqendrohen në: - Interpretim kufizues të përjashtimit të politikës publike - Shmangie të bazave formale për anulim - Të kuptuarit e arbitrazhit si një mekanizëm standard, jo si një përjashtim
3. Miratimi i protokolleve për trajtimin e përshpejtuar të parashtrësve të arbitrazhit	• Të kërkohen seanca dëgjimore fillestare për zbatimin e vendimeve ose kërkesat për ndihmë të përkohshme brenda 14 ditëve • Të krijohen rregulla të thjeshtuara për provat dhe parashtrimet • Të vendosen afate të qarta kohore për lëshimin e vendimeve

4. Publikimi i udhëzimeve praktike mbi zbatimin dhe politikat publike	• Të publikohen udhëzime me shkrim për: - Kur dhe si gjykatat mund të shqyrtojnë vendimet - Përdorim të kufizuar i bazave të politikave publike - Afatet e pritura për zbatim • Të publikohen vendimet gjyqësore mbi arbitrazhin në një bazë të dhënash të qasshme dhe të inkurajohet anotimi i vendimeve të rëndësishme
5. Përmirësimi i menaxhimit të lëndëve dhe përdorimit të teknologjisë	• Të futen në përdorim: - Parashtrës elektronike të aplikimeve që lidhen me arbitrazhin - Seanca dëgjimore në distancë për çështje urgjente - Regjistër i shpejtë i dedikuar për mbështetjen e arbitrazhit
6. Të krijohet ndërlidhje gjyqësore me institucionet e arbitrazhit	• Të mbahen takime të rregullta në mes të gjyqtarëve të lartë dhe institucioneve të arbitrazhit për të: - Bashkërenditur pritjet - Identifikuar problemet procedurale që përsëriten - Mbështetur zhvillimin e takimeve dhe proceseve të ndihmës emergjente

Shtojca e Tabelës A.1: Udhërrëfyti për fuqizimin e mbështetjes gjyqësore për ZAK

SHTOJCA B:

Udhërrëfytes i CLDP-së për projektimin e institucioneve efektive të pavarura të ZAK

Për të mbështetur praktikuesit, politikëbërësit dhe institucionet e reja të ZAK-së në zbatimin e këtyre parimeve, ne ofrojmë një tabelë të konsoliduar që përshkruan komponentët kryesorë të një qendre të fuqishme dhe të besueshme të ZAK-së.

Tabela më poshtë përmbledh karakteristikat kryesore institucionale të diskutuara në këtë seksion — përfshirë gamën nga menaxhimi lëndëve dhe akreditimi deri te qeverisja, infrastruktura dhe bashkëpunimi rajonal — në një mjet praktik referimi.

Synon të shërbejë si një kornizë diagnostikuese për qendrat që kërkojnë të krahasojnë praktikën e tyre aktuale, por edhe si një udhëzues hap pas hapi për ata që punojnë për të forcuar kapacitetin e tyre operacional dhe pozicionin ndërkombëtar.

1. Ekselencë në menaxhimin e lëndëve	Institucionet efektive të ZAK-së duhet të ofrojnë: • Administrim profesional të lëndëve, me personel të trajnuar që i kupton rrjedhat e punës së arbitrazhit dhe ndërmjetësimit • Sisteme digjitale të menaxhimit të lëndëve që lejojnë parashtrësa të sigurta online, shkëmbime dokumentesh dhe seanca dëgjimore në distancë • Afate të qarta kohore dhe procedura miqësore për përdoruesit që sigurojnë parashikueshmëri dhe efikasitet Menaxhimi i lëndëve me cilësi të lartë rrit besueshmërinë institucionale dhe përforcon besimin në procesin e ZAK-së.
2. Akreditimi dhe listat e ndërmjetësuesve dhe arbitrave	Institucionet duhet të: • Krijojnë procedura transparente emërimi dhe të publikojnë biografitë e arbitrave dhe ndërmjetësuesve • Mbajne një listë të larmishme, me personel të akredituar që pasqyron ekspertizën vendase dhe ndërkombëtare • Zhvillojnë programe certifikimi dhe akreditimi, ideale në partneritet me organizata të tilla si CIArb Listat e akredituara sigurojnë që personat neutralë përmbushin standarde të qëndrueshme të kompetencës, etikës dhe paanshmërisë.
3. Kapaciteti i personelit institucional: Zhvillimi dhe operacionet e biznesit	Qendrat e pavarura të ZAK-së duhet të investojnë në dy funksione paralele të personelit: • Zhvillimi i Biznesit: - Zhvillim i fushatave të ndërgjegjësimit publik në lidhje me shërbimet e ZAK-së - Angazhimi me odat ekonomike, NVM-të dhe komunitetet ligjore për të promovuar pranimin e ZAK-së - Organizimi i javës së ZAK, trajnime për praktikuesit dhe ngjarje në terren për informim

3.

Kapaciteti i personelit institucional: Zhvillimi dhe operacionet e biznesit

- Operacionet e Biznesit:
 - Menaxhimi i modeleve të qëndrueshme financimi — tarifat e lëndëve, anëtarësimet institucionale dhe, kur është e përshtatshme, mbështetje qeveritare që nuk kompromenton pavarësinë
 - Sigurimi i sistemeve administrative efikase, përpunim të sigurt të pagesave dhe pajtueshmëri me qeverisjen institucionale

Këto funksione sigurojnë qëndrueshmërinë operative të qendrës dhe rëndësinë e saj për komunitetin.

4.

Rregulla dhe procedura transparente dhe moderne të arbitrazhit

Rregullat institucionale janë shtylla kurrizore e besimit të përdoruesit. Qendrat duhet të sigurojnë:

- Rregullat të jenë të disponueshme publikisht në uebfaqe, të lehta për t'u kuptuar dhe të qasshme në shumë gjuhë.
- Rishikime të rregullta të rregullave — ideale në baza vjetore — për t'u përshtatur me praktikën globale në zhvillim
- Përditësime për të përfshirë tipare moderne si:
 - Procedura të përsheptuara
 - Dispozita për arbitrin emergjent
 - Konsolidim të kërkesave
 - Seanca dëgjimore digjitale dhe prova elektronike

Institucionet që dështojnë të modernizohen rrezikojnë të perceptohen si të vjetruara ose të paparashikueshme. Përshtatshmëria është një shenjë dalluese e qendrave të besueshme të arbitrazhit.

5.

Shërbimet dhe infrastruktura mbështetëse

Qendrat efektive të ZAK-së ofrojnë ambiente mbështetëse që përforcojnë administrimin profesional, që përfshijnë:

- Dhoma dëgjimi, hapësira të sigurta për seanca të ndara dhe mundësi dëgjimi virtual
- Shërbime përkthimi, transkriptimi dhe interpretimi
- Sisteme të sigurta të ruajtjes së dosjeve të lëndëve dhe komunikimit

Këto karakteristika përmirësojnë përvojën e përdoruesit dhe e përshtatin qendrën me pritjet ndërkombëtare.

6.

Bashkëpunimi rajonal dhe pozicionimi ndërkombëtar

Qendrat e pavarura përfitojnë nga ndërtimi i partneriteteve me institucione të pozicionuara në mënyrë të ngjashme, përfshirë aty përmes:

- MM për bashkëpunim institucional, trajnim reciprok ose lista të përbashkëta të personelit
- Konferenca të përbashkëta rajonale ose javë të ZAK-së, të cilat rrisin dukshmërinë dhe standardizojnë praktikat më të mira
- Promovimi nëpër forume ndërkombëtare, duke inkurajuar palët e huaja që të zgjedhin juridiksionin si seli ose vend për seancë dëgjimore

Bashkëpunimi rajonal zgjeron vëllimin e lëndëve, rrit besueshmërinë dhe përshpejton të nxëniet institucionale.

7.
Qeverisja dhe
pavarësia

Për të zbutur shqetësimet në lidhje me ndikimin e tepruar të shtetit, qendrat e ZAK-së duhet patjetër të:

- Ruajnë strukturat e pavarura të qeverisjes, idealisht me borde të përziera publiko-private
- Miratojnë mbrojtje të brendshme që sigurojnë neutralitet dhe transparencë
- Publikojnë raporte vjetore dhe statistika të anonimizuara të lëndëve — parashtresat, kohëzgjatja, normat e zbatimit dhe kostot

Transparenca ndërton besim dhe e përafron qendrën me pritjet ndërkombëtare të llogaridhënies.

Shtojca e Tabelës B.1: Udhërrëfyesit për projektimin e institucioneve efektive të pavarura të ZAK

Fjalorthi

Vendimmarrje në formë gjykimi (Adjudication): Një metodë e ZAK që përdoret kryesisht në planifikimin ose zbatimin e projekteve të mëdha (veçanërisht në sektorin e ndërtimit) me gjyqtarë të vetëm (ekspertë) ose panele me tre anëtarë (Bordi i Gjykimit të Kontesteve). Shpesh kombinohet me arbitrazhin në klauzolat e zgjidhjes së kontesteve. Gjykimi luan një rol vendimtar në parandalimin e hershëm të kontesteve duke zgjidhur ankesat dhe kontestet ndërsa ato lindin. Tribunalet e arbitrazhit dhe gjykatat mund të përmbysin vendimet e gjykimit, përveç nëse palët i zbatojnë ato vullnetarisht.

Tribunali Ad Hoc: Një panel arbitrash ose gjyqtarësh të emëruar nga palët në kontest për të zgjidhur një kontest, jashtë një kornize formale të një institucioni të ZAK-së. Kompetenca, procedura dhe dinamika e procesit të arbitrazhit i nënshtrohen kryesisht marrëveshjes së palëve dhe së drejtës të vendit të arbitrazhit. Palët mund të zgjedhin rregullat e institucionit specifik të arbitrazhit për të rregulluar procesin, ose t'i drejtohen një institucioni për mbështetje administrative dhe logjistike. Kjo nuk e ndryshon natyrën ad hoc të procesit.

Komunitetet e prekura (Affected Communities): Komunitetet e prekura nga kontestet që përfshijnë burimet natyrore, ndikimin mjedisor ose të drejtat e njeriut/popullatave autoktone. Përfshirja e tyre i ndihmon gjykatat të kuptojnë dimensionet sociale dhe kulturore të kontestit, veçanërisht kur një kontekst i tillë do të kontribuonte në zgjidhjen e kontestit. Përndryshe, komuniteteve lokale zakonisht u mungojnë të drejtat formale procedurale.

Amicus Curiae: Të quajtur edhe “Miq të Gjykatës”. Këto shpesh janë OJQ, organizata akademike ose shoqata të industrisë që ofrojnë njohuri të specializuara mbi politikat ose interpretime ligjore që mund t'u ofrojnë gjykatave një perspektivë përtej asaj që paraqesin palët në kontest. Në kontestet e investimeve, shteti i origjinës së investitorit dhe shtetit palë kundërshtar mund të paraqesin interpretime të njëanshme ose të përbashkëta të traktatit në fuqi, ose ndryshe të paraqesin informata përkatëse në gjykatë në formën e dokumenteve faktuale *amicus curiae*.

Emërimi (Appointment): I njohur edhe si konstituimi i tribunalit. Në shumtën e rasteve, secila palë emëron një arbitër; palët ose arbitrat e emëruar më pas do të përpiqen të arrijnë një marrëveshje për emërimin e kryesuesit të tribunalit të arbitrazhit. Për marrëveshjen mbi konstituimin e tribunalit të arbitrazhit, rregullat e arbitrazhit zakonisht parashikojnë një afat kohor (p.sh. 90 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës për arbitrazh).

Në rastet kur nuk është arritur asnjë marrëveshje, kryesuesi emërohet nga autoriteti emërues (zakonisht institucioni i arbitrazhit, siç janë ICSID ose PCA). Si rregull i përgjithshëm, asnjë arbitër nuk mund të jetë i së njëjtës kombësi me asnjërën nga palët (në varësi të marrëveshjes — Rregulli 1 i ICSID-it).

Autoriteti emërues (Appointing Authority): Një person ose institucion neutral i caktuar nga palët, ligji në fuqi ose rregullat institucionale për të marrë vendime procedurale, emërime ose veprime kur palët në kontest nuk mund të pajtohen. Autoritetet emëruese luajnë një rol kyç në shmangien e bllokimeve ose vonesave të panevojshme duke emëruar arbitra ose duke vendosur mbi kundërshtimet e arbitrave dhe çështje të tjera. Në mungesë të një autoriteti të caktuar emërues, ky rol kryhet automatikisht nga gjykata kompetente sipas ligjit në fuqi.

Arbitri: Vendimmarrësit kryesorë në arbitrazh që nxjerr vendime detyruese që janë të zbatueshme ndërkombëtarisht. Edhe pse emërohen nga palët në kontest, arbitrat janë të detyruar nga të njëjtat detyrime pavarësie dhe paanshmërie si gjyqtarët: të ruajnë legjitimitetin dhe integritetin e procedurës.

Tribunali i Arbitrazhit: Organi që vendos (me shumicë votash) për rezultatin e kontestit. Në rastet që kanë të bëjnë me investimet, tribunalet e arbitrazhit përbëhen pothuajse, pa përjashtim, nga tre arbitra.

Vendimi i Arbitrazhit: Një vendim përfundimtar dhe detyrues i lëshuar nga një tribunal arbitrazhi për të zgjidhur një kontest të paraqitur në arbitrazh.

Arb-Med: Një metodë hibride e ZAK ku një arbitër nxjerr një vendim i cili vulozet dhe më pas zhvillon ndërmjetësimin. Nëse ndërmjetësimi nuk ka sukses, vendimi hapet, duke rezultuar në një vendim të detyrueshëm. Disa palë gjithashtu mund të negociojnë ose ndërmjetësojnë gjatë një arbitrazhi në pritje, të arrijnë një zgjidhje, si dhe më pas t'i kërkojnë arbitrit të kodifikojë kushtet e marrëveshjes së negociuar në një vendim pëlqimi.

Atribuimi (Attribution): Bashkangjitja e një veprimi ose mosveprimi të caktuar një shteti sipas së drejtës ndërkombëtare.

Zbatimi i Vendimit (Award Enforcement): Procesi i regjistrimit në një gjykatë/autoritet përkatës për të detyruar palën kundër së cilës është

dhënë vendimi të procedojë sipas vendimit të tribunalit të arbitrazhit. Pala kundër së cilës kërkohet ekzekutimi mund të kundërshtojë ekzekutimin duke paraqitur prova për njërën nga bazat për refuzimin e ekzekutimit, të cilat janë të listuara në Nenin V(1) të Konventës së Nju Jorkut.

Njohja e Vendimit (Award Recognition): Pas lëshimit të vendimit të arbitrazhit nga gjykata, ai njihet përgjithësisht nga gjykatat lokale, duke konfirmuar kështu efektin e tij ligjor.

Zgjidhje Miqësore (Amicable Settlement): Një metodë zgjidhjeje kontestesh jo-adversariale, konsensuale dhe e bazuar në interes, e cila shpesh i paraprin një procesi adversarial gjyqësor ose arbitrazhit. Prosesi zhvillohet si një negociatë në mes të palëve, me ose pa një palë të tretë neutrale (ndërmjetësues, pajtues, etj). Zgjidhja që rezulton nga marrëveshja nuk është detyruese, por palët mund t'i kërkojnë një gjykatë të vërtetojë marrëveshjen e tyre në një vendim mbi kushtet e përcaktuara, i cili më pas është i zbatueshëm si një vendim arbitrazhi sipas së drejtës kombëtare dhe ndërkombëtare.

Traktati Dypalësh i Investimeve (BIT): Një marrëveshje ndërkombëtare e lidhur në mes të dy shteteve që shërben për të promovuar, mbrojtur dhe rregulluar investimet nga shtetasit dhe kompanitë e një shteti në territorin e shtetit tjetër. Traktate të tilla më shpesh u japin të drejta investorëve të mbrojtur nga pala përkatëse e traktatit për të ndjekur drejtpërdrejt pretendimet e tyre të investimeve në arbitrazhin ndërkombëtar.

Bifurkacion: Ndarja e lëndës në faza të veçanta për të adresuar çështje diskrete që mund të jenë dispozitive. Palët kundërshtare shpesh kërkojnë ndarjen e kontestit në një fazë të juridiksionit dhe meritave, ose në fazën e përgjegjësisë dhe kuantumit (vlerësimit të dëmit). Ndarja mund të kontribuojë ndjeshëm në kohën dhe efikasitetin e kostos së procedurave: mund të shmangë një seancë të plotë dëgjimore për shqyrtimin e meritave nëse tribunali konstaton se nuk ka juridiksion mbi çështjen, ose një periudhë të gjatë vlerësimi të dëmit nëse nuk konstaton përgjegjësi në fazën e përgjegjësisë së ndarë.

Kompetenz-Kompetenz: Tribunali i arbitrazhit ka juridiksionin për të përcaktuar juridiksionin e vet. Nëse një palë pretendon se klauzola e arbitrazhit është e pavlefshme, vetë arbitrat janë të parët që vendosin për këtë çështje. Gjykatat në përgjithësi nuk do të ndërhyjnë derisa tribunali

të ketë dhënë vendimin e vet, por ato do të kenë fjalën e fundit për këtë çështje.

Pajtimi: Një metodë e specializuar për zgjidhjen e kontesteve përmes emërimit të një ose më shumë pajtuesve të cilët ofrojnë një shqyrtim të paanshëm të kontestit, një përpjekje për të përcaktuar kushtet e një zgjidhjeje të pranueshme reciprokisht dhe u ofrojnë palëve çdo ndihmë tjetër të nevojshme për të lehtësuar një zgjidhje.

Pajtuesit: Ata ofrojnë një deklaratë autoritare, por jo detyruese të meritave. Rekomandimet e tyre, ndonëse nuk janë detyruese, shpesh ofrojnë një rrugë të strukturuar drejt kompromisit.

Konfidencialiteti: Ndryshe nga gjykimet në gjykata, arbitrazhi është privat. Megjithatë, konfidencialiteti nuk është automatik në të gjitha juridiksionet. Sipas së drejtës angleze, kjo është një detyrim i nënkuptuar; sipas Rregullave të UNCITRAL-it ose të drejtës amerikane, shpesh duhet të dakordohet në mënyrë të qartë nga palët. Mbulon ekzistencën e arbitrazhit, dokumentet e paraqitura dhe vendimin përfundimtar. Për ndërmjetësimin, kjo do të thotë që deklaratat dhe materialet nuk janë të zbulueshme nëse çështja vazhdon në procese gjyqësore, një shtyllë kyçe e procesit.

Periudha e "pritjes": Periudha e detyrueshme para-arbitrazhit për zgjidhje miqësore (zakonisht 6 muaj), që kërkon që investitori si parashtrues kërkesë të përpiqet të bëjë zgjidhje përpara se të paraqesë kërkesë për arbitrazh. Derisa disa tribunale e shohin këtë si një çështje procedurale dhe të korrigjueshme, të tjerat e konsiderojnë atë një pengesë strikte juridiksionale.

Analiza e krahasueshmërisë: Në arbitrazhin e investimeve, tribunali vlerëson investimin duke iu referuar transaksioneve të fundit të përafërta të pasurive të ngjashme ose vlerësimit të tregut të aksioneve të kompanive të krahasueshme të tregtuara publikisht. Kjo është e zakonshme kur kontesti lidhet me një shkelje të supozuar të standardit kombëtar ose të vendit më të favorizuar sipas traktatit në fuqi.

Arbitrazhi i Kontratave: Buron nga një kontratë specifike midis palëve (qofshin individë privatë, kompani dhe/ose shtete apo ndërmarrje shtetërore) që veprojnë në një kapacitet tregtar.

Jo-nënshkruesit e Kontratës: Hisedarët të cilët, megjithëse nuk janë palë formale në një marrëveshje arbitrazhi, implikohen përmes marrëdhënieve të korporatave, zinxhirëve të kontratave ose veprimeve të lidhura ngushtë me kontratën dhe kontestin. Ata mund të përfshihen në procedura sipas doktrinaeve të tilla si grupi i kompanive, pëlqimi i nënkuptuar ose parimet e barazisë.

Pëlqimi: Marrëveshje për t'iu nënshtruar një mekanizmi ZAK, qoftë e shprehur përpara se të lindë një kontest (siç është përmes një kontrate, traktati ose legjislacioni) ose pasi të ketë lindur një kontest (siç është përmes një marrëveshjeje të veçantë ose kërkesë për arbitrazh). Pëlqimi është një parakusht themelor për ZAK dhe në ndërmjetësim, ai duhet të ekzistojë gjatë gjithë procesit (pëlqim i vazhdueshëm).

Rrjedha e zbritur e parave të gatshme (DCF): Për të vlerësuar brengën e vazhdueshme me shënime të dëshmuara të fitimit, gjykata mund të projektojë fitimet e ardhshme dhe t'i zbresë ato në vlerën e tanishme. Një vlerësim DCF mund të japë vendime të rëndësishme arbitrazhi duke kapur vlerën e plotë ekonomike të rritjes së ardhshme.

Bordet e kontesteve: Palët mund të krijojnë borde kontestesh (ose borde të përhershme të emëruara në fillim të një projekti ose borde ad-hoc të emëruara kur lind një kontest) për të nxjerrë vendime këshillimore ose detyruese mbi çështje teknike dhe kontraktuale.

Palët në kontest: Ata që e drejtojnë procesin, i përcaktojnë pretendimet, zgjedhin forumin, paraqesin provat dhe në fund të fundit bartin pasojat ligjore dhe financiare të vendimit. Kontestet mund të lindin në mes të palëve private, në mes të palëve private dhe të shtetit, si dhe ndonjëherë, në mes të shteteve.

Përcaktimi i Ekspertit: Palët në kontest mund të pajtohen të emërojnë një ekspert të pavarur për të dhënë një mendim detyrues ose jo detyrues, ose për të zgjidhur një kontest që kërkon ekspertizë të specializuar ose teknike.

Dëshmitarë Ekspertë: Ekspertë që ndihmojnë gjyqtarët në kuptimin e çështjeve teknike ose të specializuara që janë thelbësore për një kontest. Dëshmitarët ekspertë ofrojnë analiza të specializuara që mund të ndikojnë në rezultate ose të thjeshtojnë tema komplekse për vendimmarrësit.

Shpronësimi: E drejta ndërkombëtare nuk e ndalon shpronësimin; ajo ndalon shpronësimin pa kompensim. Kjo përfshin si shpronësimin direkt (një transferim i detyrueshëm ligjor i titullit ose sekuestrim të plotë të pasurisë) ashtu edhe shpronësimin indirekt (masa që nuk transferojnë titullin, por e privojnë në mënyrë të konsiderueshme investitorin nga vlera ekonomike, përdorimi dhe gëzimi i investimit të tij, në një mënyrë ekuivalente me një marrje të drejtpërdrejtë).

Dëshmitarë të Fakteve: Japin deklarata faktike që mbështesin çështjen e një pale, siç janë punëtorët ose zyrtarët publikë. Dëshmitarët e fakteve mbështesin argumentet e palës emëruese.

Trajtim i Drejtë dhe i Barabartë (FET): Një mbrojtje me përfshirje të plotë të gjerë dhe gjithëpërfshirëse që kërkon që shteti nikoqir ta trajtojë investitorin në mënyrë të drejtë dhe të barabartë (domethënë, që nuk mund të diskriminojë investitorin ose të imponojë masa të paarsyeshme ose arbitrare). Shpesh e formuluar në mënyrë të përgjithshme, kjo mbrojtje e traktatit ka evoluar për të mbuluar pritshmëritë legjitime, mohimin e drejtësisë, arbitraritetin dhe diskriminimin. Tribunalet e arbitrazhit zakonisht i drejtohen interpretimit të traktateve në kontekstin e fakteve për të dhënë një vendim të përshtatshëm sipas standardit.

Avantazhi i gjykatës vendase: Padrejtësi/paragjykim i perceptuar kundër palëve të huaja në proceset e brendshme gjyqësore.

Këshilltari juridik hibrid: Shteti mund të përfaqësojë veten, por të mbajë një grup të vogël këshilltarësh juridik të jashtëm për ta ndihmuar, duke ndihmuar në ruajtjen e kontrollit mbi kontestet ndërkombëtare.

Agjencitë hibride të koordinimit: Disa shtete miratojnë një qasje hibride koordinimi, duke krijuar një komitet ose komision që përfshin ministri dhe agjenci të specializuara dhe të tjera përkatëse, me një agjenci që shërben si sekretariat.

Proceset hibride: Palët mund të pajtohen për procese hibride që përfshijnë ndërmjetësim dhe arbitrazh, të tilla si “Med-Arb” dhe “Arb-Med”.

Pavarësia: Arbitrat duhet të mbeten të paanshëm ndaj palëve në kontest dhe mund të kundërshtohen për mungesë neutraliteti.

Këshilltari juridik i brendshëm: Këshilltari juridik i brendshëm qeveritar, i punësuar për një rast ose i mbajtur si një ekip që ekziston vazhdimisht.

Kontest për investime ndërkombëtare: Një kontest në mes të një investitori dhe një shteti ose një organizate rajonale të integritit ekonomik (ose çdo nënndarje përbërëse e një shteti ose agjenci e një shteti ose një organizate rajonale të integritit ekonomik) e paraqitur për zgjidhje sipas një instrumenti pëlqimi.

Zgjidhja e kontesteve investor-shtet (ISDS) ose arbitrazhi investor-shtet: Buron nga një traktat dypalësh ose shumëpalësh, një kontratë investimi në mes të një investitori të huaj dhe një qeverie, ose nga ligji i investimeve të huaja ku një shtet sovran ofron pëlqimin e tij të palëkundur për të arbitruar kontestet me investorët e huaj. ISDS është një mekanizëm i rrënjosur në të drejtën ndërkombëtare publike që u lejon investorëve të huaj të ngrenë pretendime drejtpërdrejt kundër një shteti pritës.

Marrëveshjet Ndërkombëtare të Investimeve (IIA): Një kategori e gjerë marrëveshjesh ndërkombëtare të lidhura nga shtetet — duke përfshirë traktatet dypalëshe të investimeve (BIT) dhe kapitujt e investimeve të marrëveshjeve të tregtisë së lirë — të cilat promovojnë, mbrojnë dhe rregullojnë investimet nga shtetasit dhe kompanitë e një shteti në territorin e një shteti tjetër.

Ndërmjetësimi: Ndërmjetësimi është një proces negocimi i lehtësuar në të cilin të gjitha palët takohen me një palë të tretë neutrale (ndërmjetësuesin) i cili është trajnuar për të zgjidhur konfliktet në mënyrë konfidenciale. Karakteristikat kryesore të ndërmjetësimit janë vullnetarizmi, konfidencialiteti dhe vetëvendosja e palëve.

Ndërmjetësuesit: Përqendrohen në lehtësimin e negociatave në mes të palëve në ndërmjetësim. Ata i ndihmojnë palët të kuptojnë gamën e interesave që ndikojnë në qëndrimet e tyre, si dhe ato të palës tjetër. Ata nuk përcaktojnë çështjet faktike ose ligjore në kontest, por përkundrazi i ndihmojnë palët të arrijnë një zgjidhje të informuar mirë dhe të bazuar në interesa.

Med-Arb: Sipas kësaj klauzole kontrate, palët kërkojnë ta zgjidhin kontestin e tyre përmes ndërmjetësimit. Nëse nuk kanë sukses, palët e zgjidhin kontestin me arbitrazh duke përdorur të njëjtin arbitër neutral ose një arbitër tjetër, duke rezultuar në një vendim detyrues.

Vendi më i favorizuar (MFN): Shteti nuk duhet ta trajtojë investitorin ose investimin e huaj në mënyrë më pak të favorshme sesa investitorët ose investimet nga ndonjë vend i tretë. Proceduralisht, pretenduesit ndonjëherë përdorin klauzola MFN për të importuar dispozita më të favorshme nga traktate të tjera që shteti nikoqir ka lidhur.

Agjenci të Shumëfishta Koordinimi: Disa shtete shpërndajnë funksionet e parandalimit dhe zbutjes së kontesteve nëpër agjencitë qeveritare, secila prej të cilave luan një rol specifik ose trajton ankesa të veçanta.

Klauzolat shumështrësore (ose "përshkallëzimi"): Lejimi ose kërkesa që palët të fillojnë me një proces jo-detyrues, konsensual (siç janë negociatat ose ndërmjetësimi) dhe më pas të vazhdojnë me mekanizmat detyrues të zgjidhjes së kontesteve (siç është arbitrazhi).

Trajtimi kombëtar: Shteti nuk duhet ta trajtojë investitorin ose investimin e huaj në mënyrë më pak të favorshme sesa i trajton investitorët ose investimet nga vendet e veta në rrethana të ngjashme.

Neutralët: Individë që kontribuojnë në zgjidhjen e kontesteve në mënyra të dallueshme, shpesh plotësuese, varësisht nga natyra e procesit. Disa i ndihmojnë palët në arritjen e zgjidhjeve të pranueshme reciprokisht përmes negociatave dhe dialogut të lehtësuar (p.sh. ndërmjetësuesit ose pajtuesit), ndërsa të tjerët janë të autorizuar të përcaktojnë rezultatin përmes vendimeve detyruese ose gjetjeve të ekspertëve (arbitra komerciale dhe të investimeve, gjyqtarë ekspertë të bordit).

Vlerësues neutralë: Ofrojnë opinione jo-detyruese ose zgjidhin konteste që kërkojnë ekspertizë të specializuar ose teknike. Inxhinierët, analistët financiarë ose shkencëtarët mjedisorë mund të angazhohen për të vlerësuar rreziqet ose për të propozuar zgjidhje të realizueshme.

Palët jo-kontestuese sipas traktatit: Në arbitrazhin e bazuar në traktat, palët në traktat përveç shtetit të paditur mund të ndërhyjnë për të trajtuar çështje të interpretimit të traktatit që lidhen me kontestin.

Negocimi: Diskutime të drejtpërdrejta në mes të palëve, pa përfshirjen e palëve të treta. Kjo siguron një mjet fleksibil për zgjidhjen e kontesteve pa një strukturë formale. Ka synim të prodhojë një zgjidhje të pranueshme nga të dyja palët, të cilën palët mund ta memorizojnë.

Vlerësimi neutral: Një diagnostikues dhe këshillues më tepër sesa përcaktues. Një palë neutrale, shpesh me përvojë ligjore, rregullatore ose në zgjidhjen e kontesteve, vlerëson pikat e forta dhe të dobëta të lëndëve përkatëse dhe parashikon rezultatet e mundshme nëse gjykohen. Vlerësimi nuk është detyrues.

Këshilltari juridik i jashtëm: Avokatët ndërkombëtarë të cilët shtetet i punësojnë për të menaxhuar çështjet ligjore, të politikave publike dhe financiare të shtetit.

Autonomia e palës: Palët kanë lirinë të hartojnë procesin e tyre, duke përfshirë gjuhën, selinë dhe ligjin e aplikueshëm. Gjykatat në përgjithësi nuk ndërhyjnë përveç nëse procesi shkel ligjin për proces të rregullt ose ligjet e detyrueshme.

Pëlqimi i palës: Shprehet përpara se të lindë një kontest në një klauzolë për zgjidhjen e kontesteve (p.sh. përmes një kontrate, traktati, legjislacioni ose autorizimi investimi), ose pasi të lindë një kontest, si p.sh. përmes një marrëveshjeje të veçantë (*kompromis*).

Kontestet privato-private: Kontestet në mes të dy ose më shumë palëve private.

Kontestet publiko-publike: Për kontestet që përfshijnë të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të shteteve sovrane, ose që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e marrëveshjeve të tyre, institucionet kompetente kyçen në zgjidhjen e kontesteve në mes të tyre.

Kontestet publike-private: Kontestet në mes të palëve private dhe shteteve, të cilat përfshijnë kontest që kanë të bëjnë me punën, mjedisin, investimet dhe madje edhe sektorët penal. Këto konteste përfshijnë investitorë të mbrojtur nga traktate ose kontrata ndërkombëtare investimi, të cilat u lejojnë atyre të padisin drejtpërdrejt shtetin nikoqir për shkelje të të drejtave të tyre të garantuara.

Zgjidhja pas-vendimit: Marrëveshje e ndërsjellë në mes të palëve pasi tribunali i arbitrazhit të ketë marr vendimin e tij, përmes së cilës ato modifikojnë mjetet juridike të dhëna, pajtohen për ekzekutim alternativ ose përndryshe për formën dhe afatin kohor të zbatimit të vendimit të arbitrazhit.

Jurisdiksioni *Ratione Materiae*: Autoriteti i tribunalit mbi një kontest bazuar në lëndën e kontestit, siç janë "investimet" e mbuluara në arbitrazhin ndërkombëtar të investimeve.

Juridiksioni *Ratione Personae*: Autoriteti i tribunalit mbi një kontest bazuar në personat ose subjektet e përfshira, siç janë "investitorët" e mbuluar në arbitrazhin ndërkombëtar të investimeve.

Juridiksioni *Ratione Temporis* : Autoriteti i gjykatës mbi një kontest bazuar në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet ose veprimet që kanë çuar në kontest.

Juridiksioni *Ratione Voluntatis* : Autoriteti i gjykatës mbi një kontest bazuar në pëlqimin për arbitrazh, gjegjësisht ofertën e shtetit nikoqir dhe pranimin e investitorit.

Selia e Arbitrazhit: Selia është selia ligjore e arbitrazhit, që do të thotë e drejta kombëtare që rregullon kornizën procedurale. E drejta e selisë gjithashtu i jep kompetenca gjykatës dhe, më e rëndësishmja, përcakton se cilat gjykata kombëtare mund ta konfirmojnë ose anulojnë vendimin ose të ndërhyjnë në procedurat e arbitrazhit. Edhe pse terminologjia që i referohet selisë mund të ndryshojë (disa i referohen "vendi i arbitrazhit"), selia nuk është domosdoshmërisht sinonim i vendit gjeografik ku zhvillohen seancat dëgjimore. Për shembull, një arbitrazh me "seli" në Londër i nënshtrohet mbikëqyrjes së gjykatave angleze, edhe nëse seancat dëgjimore mbahen fizikisht në Paris ose Singapor.

Mundësia e Ndarjes së Marrëveshjes së Arbitrazhit: Ndarja e një marrëveshjeje të arbitrazhit do të thotë që marrëveshja për arbitrazh trajtohet si një kontratë e pavarur, e ndarë nga kontrata kryesore në të cilën është përfshirë. Edhe nëse kontrata kryesore kontestohet, anulohet ose pretendohet të jetë e pavlefshme, marrëveshja e arbitrazhit do jetë ende e vlefshme. Kjo siguron që një arbitër, jo një gjykatë, vendos për çështjet në lidhje me vlefshmërinë e kontratës (dhe juridiksionin e vet — Kompetenz-Kompetenz).

Procedurat e anashkalimit: Kundërshtimi i vendimit të arbitrazhit në gjykatën e selisë së arbitrazhit. Nëse ka sukses mbi baza të kufizuara sipas legjislacionit kombëtar (bazuar në Ligjin Model të UNCITRAL-it), një kundërshtim i tillë mund ta bëjë vendimin plotësisht ose pjesërisht të pazbatueshëm sipas Nenit V të Konventës së Nju Jorkut.

Agjenci të Vetme Koordinimi: Për të parandaluar dhe menaxhuar kontestet investitor-shtet, shtetet mund të krijojnë një agjenci të vetme koordinimi, qoftë si një organ autonom ose brenda një ministrie ekzistuese ose një agjencie qeveritare, siç është një avokat i popullit ose agjencitë e promovimit të investimeve.

Kostot e pakthyeshme (Sunk Costs): Shpenzimet dhe kapitali aktual i bërë nga një investitor i huaj që mund të jepen nga një tribunal arbitrazhi, në vend të aplikimit të metodave më spekulative. Kjo metodë është e përshtatshme për projekte në fazë të hershme, siç është një minierë që ende nuk ka filluar nxjerrjen.

Financuesit Palë të Treta (TPF): Subjektet e speciale që financojnë shpenzimet ligjore të një pale (zakonisht paditësit) në këmbim të një pjese të shpërblimit përfundimtar. Financues të tillë janë bërë akterë të rëndësishëm në arbitrazhin ndërkombëtar, duke ndikuar në strategjinë e çështjeve dhe duke kërkuar zbulim specifik në lidhje me konfliktet e interesit.

Shkurtesat

AAA — Shoqata Amerikane e Arbitrazhit

AAA-ICDR — Shoqata Amerikane e Arbitrazhit - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve

ZAK — Zgjidhja Alternative e Kontesteve

ART — Vegël Kërkimore për Arbitra

AS — Zgjidhja e Marrëveshjes

BIT — Traktate Dypalëshe Investimesh

CEDR — Qendra për Zgjidhjen Efektive të Kontesteve

CEPA — Marrëveshja Gjithëpërfshirëse e Partneritetit Ekonomik

CIArb — Instituti i Certifikuar i Arbitrave

GJEU — Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

CLDP — Programi për Zhvillimin e të Drejtës Tregtare

CLE — Arsimitim i Vazhdueshëm Ligjor

CPR — Rregullat e Procedurës Civile

DAB — Bordet e Gjykimit të Kontesteve

DCF — Rrjedha e Zbritur e Parave të Gatshme

TKE — Traktati i Kartës së Energjisë

E.U. — Bashkimi Evropian

EUR — Evropian

IHD — Investime të Huaja Direkte

FET — Trajtim i Drejtë dhe i Barabartë

FIDIC — Federation Internationale des Ingenieurs-Conseils (Federata Ndërkombëtare e Inxhinierëve Konsulentë)

MTL — Marrëveshja e Tregtisë së Lirë

GAR — Rishikimi Global i Arbitrazhit

GAFTA - Shoqata e Tregtisë së Grurit dhe Ushqimit

HKIAC — Qendra Ndërkombëtare e Arbitrazhit të Hong Kongut

IBA — Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve

ICC — Oda Ndërkombëtare e Tregtisë

ICCA — Këshilli Ndërkombëtar i Arbitrazhit Ndërkombëtar

ICSID — Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve

IIA — Marrëveshjet Ndërkombëtare të Investimeve

ILC — Komisioni i së Drejtës Ndërkombëtare

IP — Pronësia Intelektuale

ISDS — Zgjidhja e Kontesteve
Investitor-Shtet

IVS — Standardet Ndërkombëtare
të Vlerësimit

JAMS — Shërbime Arbitrazhi
Gjyqësor dhe Ndërmjetësimi

LAS — Komuniteti i Ndihmës
Juridike

LCIA — Gjykata e Arbitrazhit
Ndërkombëtar të Londrës

MFN — Vendi Më i Favorizuar

MIT — Traktati Shumëpalësh i
Investimeve

MOU — Memorandum i
Mirëkuptimit

NAFTA — Marrëveshja e Tregtisë
së Lirë të Amerikës së Veriut

OJQ — Organizatat Joqeveritare

NYC — Konventa e Nju Jorkut

NYPD — Departamenti i Policisë
së Nju Jorkut

PCA — Gjykata e Përhershme e
Arbitrazhit

PO1 — Urdhri procedural numër 1

SC — Gjykata Supreme

SCC — Instituti i Arbitrazhit të
Odës së Tregtisë së Stokholmit

SDNY — Distrikti Jugor i Nju
Jorkut

SIAC — Qendra Ndërkombëtare e
Arbitrazhit në Singapor

SIDRA — Akademia
Ndërkombëtare e Zgjidhjes së
Kontesteve në Singapor

SIMC — Qendra Ndërkombëtare e
Ndërmjetësimi në Singapor

NVM — Ndërmarrjet e Vogla dhe
të Mesme

NSH — Ndërmarrjet Shtetërore

U.K. — Mbretëria e Bashkuar

U.S. — Shtetet e Bashkuara të
Amerikës

UKSC — Gjykata Supreme e
Mbretërisë së Bashkuar

OKB — Kombet e Bashkuara

UNCITRAL — Komisioni i
Kombeve të Bashkuara për të
Drejtën Tregtare Ndërkombëtare

UNCSI — Konventa e Kombeve
të Bashkuara mbi Imunitetet
Juridiksionale të Shteteve dhe
Pronës së Tyre (2004)

UNCTAD — Konferenca e
Kombeve të Bashkuara për
Tregtinë dhe Zhvillimin

USD — Dollari i Shteteve të
Bashkuara

VCLT — Konventa e Vjenës mbi të
Drejtën e Traktateve

Udhëzuesi për këtë libër

Për kë është ky libër?

Ky libër është për ata që kërkojnë të përcaktojnë se si t'i zgjidhin më mirë kontestet pa iu drejtuar procedurave gjyqësore, duke përdorur Zgjidhjen Alternative të Kontesteve (ZAK). Pavarësisht nëse po e shqyrtoni ZAK-në nga një perspektivë qeveritare, akademike apo industriale — si një entitet shtetëror, organizatë e komunitetit, investitor apo ofrues shërbimesh — ky udhëzues ofron kontekst, thekson opsionet dhe përcakton pritjet për procesin e ZAK-së. Politikëbërësit dhe rregullatorët nga ekonomitë në zhvillim, në veçanti, do të përfitojnë nga perspektivat e këtij udhëzuesi mbi hartimin e sistemeve të ZAK-së, përfshirjen e ZAK-së për të arritur qëllimet e politikave dhe pjesëmarrjen në ZAK. Studentët dhe praktikuesit ligjorë do ta gjejnë të dobishme gjithashtu përmbledhjen e kornizës së ZAK-së, referencat dhe citimet, si dhe studimet e rasteve me ndikim.

Cili është fushëveprimi i këtij libri?

Ky udhëzues i njofton lexuesit me ZAK-në, duke përfshirë një përmbledhje të detajuar të ndërmjetësimit dhe arbitrazhit, si dhe perspektiva mbi hartimin e sistemeve të ZAK-së për politikëbërësit. Vëmendje e veçantë i kushtohet ZAK-së si një mjet në tregtinë ndërkombëtare, si dhe për investimet ndërkombëtare. Megjithatë, ky libër i qaset ZAK-së nga parimet e tij themelore - autonomia e palëve, fleksibiliteti procedural dhe zgjidhja e problemeve — duke ofruar kuptim të thellë e të vlefshëm edhe për akterët e tjerë. Ky libër nuk mbështet ndonjë metodë të caktuar, por më parë thekson avantazhet dhe disavantazhet e ZAK-së nga dizajni i sistemit dhe perspektivat praktike.

Kush e shkroi këtë libër?

Autorët janë një ekip i larmishëm ekspertësh të ZAK-së, duke përfshirë zyrtarë qeveritarë, avokatë, ekspertë të politikave publike dhe akademikë. Ky udhëzues synon të kapë përvojën e tyre kolektive praktike dhe njohuritë aktuale.

Megjithatë, nuk përfaqëson qëndrimet politike të organizatave, institucioneve, vendeve dhe/ose kompanive me të cilat autorët individualë janë ose kanë qenë të lidhur. Për pikëpamje të tilla, ju lutemi referojuni botimeve dhe uebfaqeve të organizatave, institucioneve, vendeve dhe/

ose kompanive përkatëse. Autorët shpresojnë që ky udhëzues do të çojë përpara zhvillimin dhe zbatimin global të ZAK-së.

Si u zhvillua ky libër?

Ky libër është kulminacion i viteve të tëra pune në zhvillimin e ZAK-së në Programin e Zhvillimit të së Drejtës Tregtare (CLDP) dhe produkt i seancave të përqendruara të hartimit në *Deutsche Institution für Schiedsgerichtsbarkeit* (DIS) në Bonn, Gjermani. Autorët më pas e ndanë dorëshkrimin me redaktorët e Fakultetit Juridik të Kolumbias dhe Fakultetit Juridik të Durhamit para botimit.

Autorët falënderojnë Specialistët e Programit Ndërkombëtar të CLDP-së, Erna Hrstic dhe Ivan Gubarev, Karin Walker, Stefan Kröll, dhe të gjithë ekipin e DIS për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre. Autorët dëshirojnë gjithashtu të falënderojnë Zyrën e Koordinatorit të Ndihmës Amerikane për Evropën dhe Euroazinë të Departamentit të Shtetit të SHBA-së për mbështetjen e tyre në zhvillimin ligjor tregtar, përfshirë aty ZAK-në, pa të cilin ky punim nuk do të ishte i mundur.

Ky libër u prodhua duke përdorur metodën Book Sprints, e cila lehtëson hartimin, redaktimin dhe dizajnin e librit brenda pesë ditësh. Autorët përziemërisht falënderojnë lehtësuesen tonë të Book Sprint, Alys Khouiri, për udhëzimin e saj të duruar dhe udhëheqjen e palëkundur gjatë gjithë procesit intensiv të hartimit. Autorët falënderojnë gjithashtu Lennart Wolfert që i shndërroi shkrimet tona të nxituara në ilustrime të bukura dhe kuptimplote, si dhe Agathe Baëz për dizajnimin e librit. Gjithashtu, do të donim të vlerësonim punën e palodhur të redaktoreve të Book Sprints, Raewyn Whyte dhe Christine Davis.

Si mund ta përdor këtë libër?

Ky udhëzues shërben si referencë dhe pikënisje për diskutime të mëtejshme, zhvillim politikash dhe punë shkencore. Mund të lexohet në mënyrë sekuenciale, veçanërisht për ata me një përvojë të kufizuar në ZAK. Për lexuesit e interesuar në aspekte specifike të procesit të ZAK-së, referojuni drejtpërdrejt Kapitujve 3, 4, 5 dhe 6, gjegjësisht, për ndërmjetësimin, arbitrazhin dhe zbatimin. Politikëbërësit mund t'i shfletojnë shpejt kapitujt e parë dhe pastaj të lexojnë Kapitullin 7 dhe Përfundimin me interes të veçantë.

Ky udhëzues është publikuar sipas licencës ndërkombëtare Creative Commons Attribution Non-NonCommercial-ShareAlike 4.0 (CC BY-NC-SA). Duke zgjedhur këtë licencë publikimi, kushdo është i mirëpritur të kopjojë, të nxjerrë fragmente, të ripërpunojë, të përkthejë dhe të ripërdorë tekstin për çdo qëllim jo-komercial pa kërkuar leje nga autorët, për sa kohë që vepra që rezulton është bituar gjithashtu sipas një Licencë 'Creative Commons'. Udhëzuesi u botua fillimisht në gjuhë angleze. Është i disponueshëm si në format elektronik ashtu edhe në atë të shtypur në <https://cldp.doc.gov/resources>

Me sinqeritet, Autorët Kontribues



- | | |
|-----------------|---|
| Emad Hussein | — Dr, LLM, Akademia Ndërkombëtare e Zgjidhjes së Kontesteve në Singapor |
| Eric Ives | — Jd, Programi për Zhvillimin e të Drejtës Tregtare, Departamenti Amerikan i Tregtisë |
| Erna Hrstic | — Specialiste e Programeve Ndërkombëtare |
| Fahira Brodlija | — LLM, Universiteti Ndërkombëtar i Sarajevës |
| Ivan Philippov | — LLM, Ekspert i Arbitrazhit Ndërkombëtar |
| Jeremy K Sharpe | — JD, LLM, Arbitër i Pavarur |
| Matthew Drossos | — JD, White dhe Case LLP |
| Raquel Sloan | — JD, Programi për Zhvillimin e të Drejtës Tregtare, Departamenti Amerikan i Tregtisë |
| Rebecca Price | — JD, Gjykata e Qarkut të SHBA-së për Qarkun Jugor të Nju Jorkut |
| Ylli Dautaj | — Dr, Fakulteti Juridik në Durham |
| Kabir Duggal | — Dr, Fakulteti Juridik në Kolumbia |

Rreth Autorëve

Ekipi i CLDP-së



Eric Ives është Specialist i Lartë në Ekipin e Evropës me Programin e Zhvillimit të së Drejtës Tregtare (CLDP) në Zyrën e Këshillit Ligjor të Përgjithshëm të Departamentit të Tregtisë të SHBA-së. Z. Ives drejton një ekip profesionistësh të zhvillimeve juridike që punojnë në nivel bilateral në Ukrainë, Bjellorusi, Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Shqipëri, si dhe në nivel multilateral në të gjithë Evropën. Z. Ives më parë ka shërbyer si Avokat-Këshilltar për ekipin e Azisë

Qendrore dhe Pakistanit, ku ai drejtoi portofolin dypalësh të zhvillimit ligjor të agjencisë me Uzbekistanin dhe portofolet e saj të zgjidhjes alternative të kontesteve në Pakistan dhe në të gjithë rajonin MENA. Z. Ives fitoi diplomën e juridikut nga Fakulteti Juridik i Kolumbias, ku ai ishte një Bursant James Kent, Davis Polk Leadership Fellow dhe redaktor i Journal of Transnational Law. Ai ka leje të ushtrisë profesionin e avokatit në shtetin e Nju Jorkut.



Raquel Martinez Sloan është Avokate-Këshilltare (Ndërkombëtare) me Programin e Zhvillimit të së Drejtës Tregtare (CLDP) në Zyrën e Këshillit të Përgjithshëm të Departamentit të Tregtisë të SHBA-së, ku punon në programe në të gjithë Evropën Lindore, Azinë Qendrore dhe Amerikën Latine. Përpara se t'i bashkohej CLDP-së, znj. Sloan ishte një Bashkëpunëtoare e Lartë në grupin e Arbitrazhit Ndërkombëtar të White & Case LLP, ku përfaqësoi sovranë të huaj dhe palë private në çështje

komplekse të arbitrazhit të investimeve para Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID) dhe institucioneve të tjera të mëdha të arbitrazhit në përputhje me traktatet dypalëshe të investimeve (BIT) dhe marrëveshjet shumëpalëshe, siç është Traktati i Kartës së Energjisë (ECT). Ajo është e përfshirë në mënyrë aktive në komunitetin ndërkombëtar të arbitrazhit dhe është Kryetare e Komunikimit për botimin tremujor të Institutit të Arbitrazhit Transnacional, 'ITA in Review'. Znj. Sloan fitoi diplomën në jurisprudence nga Universiteti i Kalifornisë, Berkeley, Shkolla e Drejtësisë. Ajo gjithashtu ka diploma BA dhe MA nga Universiteti i Nju Jorkut, ku u diplomua me magna cum laude. Znj. Sloan

flet rrjedhshëm spanjisht dhe ka licencë për të ushtruar profesionin e avokates në Kaliforni, Nju Jork, Uashington DC dhe para Gjykatës Supreme të SHBA-së.

Ekspertët Ndërkombëtarë



Fahira Brodlija është këshilltare për të drejtën e investimeve dhe zgjidhjen e kontesteve në një program rajonal të GIZ në Ballkanin Perëndimor. Puna e saj përfshin mbështetje këshillimore për qeveritë në Ballkanin Perëndimor dhe jashtë vendit në lidhje me hartimin e traktateve dhe politikave të investimeve; mbështetje në hartimin dhe zhvillimin e mekanizmave për parandalimin dhe menaxhimin e kontesteve; dhe zhvillimin e kapaciteteve, duke përfshirë trajnimin praktik dhe simulimet.

Fahira është ligjëruese në Universitetin Ndërkombëtar të Sarajevës dhe shkruan e flet shpesh mbi reformën ISDS, të drejtën e investimeve dhe zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare në përgjithësi. Ajo është tutore për programin e Diplomës CiArb dhe lektore për programin e Akademisë së Arbitrazhit Afrikan. Ajo ka marrë pjesë si ligjëruese e ftuar në universitete të njohura në Evropë, SHBA, Afrikë dhe Azi. Fahira është autore e mbi 50 artikujve, të botuar së fundmi në revistën Penn State Law dhe në European Investment Law and Arbitration Review, si dhe të tjerë në revista universitare dhe në platforma online si Kluwer Arbitration Blog. Përveç kësaj, ajo ka qenë bashkëredaktore e tre librave mbi arbitrazhin ndërkombëtar tregtar dhe të investimeve dhe ka kontribuar me kapituj në të tjerë. Ajo është anëtare e Shoqatës ARBITRI dhe themeluese e programit të diversitetit dhe mentorimit GEM, i cili mbështet akademikët dhe praktikuesit e rinj në arbitrazhin ndërkombëtar.



Dr. Ylli Dautaj është Profesor i Asociuar në të Drejtën Tregtare dhe Arbitrazhin Tregtar në Fakultetin Juridik të Durhamit, Mbretëria e Bashkuar. Dr. Dautaj është gjithashtu Partner me DER Disputes, Stokholm, Suedi. Dr. Dautaj përfaqëson klientët kryesisht në procese gjyqësore dhe arbitrazh, në nivel vendor dhe ndërkombëtar, tregtar dhe të investimeve. Ai përfaqëson individë, ndërmarrje private, ndërmarrje shtetërore dhe

shtete në konteste të ndryshme, duke përfshirë çështje të rastësishme ose ndihmëse të arbitrazhit. Librat dhe artikujt në revista të botuara të Dr. Dautaj përfshijnë *Marrëveshjet Tregtare Ndërkombëtare* (Kluwer International, botimi i 7-të, 2023) dhe *Imuniteti Sovran nga Ekzekutimi dhe Arbitrazhi Ndërkombëtar: Teori dhe Praktikë* (Kluwer International, 2025).



Matthew Drossos është partner në Praktikën Ndërkombëtare të kontesteve dhe Këshillimit në White & Case LLP, dhe ka selinë në Uashington, DC. Z. Drossos këshillon klientët mbi çështje të arbitrazhit ndërkombëtar dhe ndërkufitar, mbrojtjes së investimeve, menaxhimit të krizave dhe shmangies së kontesteve. Gjatë dekadës së fundit, praktika e tij ka përfshirë çështje që rrjedhin nga ose përfshijnë Amerikën Qendrore, Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore. Ai ka përfaqësuar si korporata

ashtu edhe shtete sovranë në planifikimin ndërkombëtar të investimeve dhe në konteste para Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve (ICSID), Odës së Tregtisë së Gjenevës, Gjykatës së Arbitrazhit për Sport, Odës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) dhe gjykatave federale të SHBA-së. Çështjet përfaqësuese kanë përfshirë konteste që kanë të bëjnë me metalet dhe minierat, ndërtimin, tekstilet dhe instrumentet financiare sovranë. Z. Drossos gjithashtu drejton rregullisht trajnime mbi të drejtën ndërkombëtare, zgjidhjen alternative të kontesteve dhe hartimin e kontratave. Në Qendrën Juridike të Universitetit Georgetown, ai shërbeu si Kryeredaktor i Georgetown Journal of International Law dhe mbetet anëtar i Bordit Këshillimor të Revistës.



Dr. Kabir Duggal është një praktikues i shquar i arbitrazhit ndërkombëtar dhe i së drejtës ndërkombëtare publike, duke shërbyer si Partner në zyrën e Akin Gump në Nju Jork dhe si Bashkëpunëtor i Lartë dhe Këshilltar në Qendrën për Arbitrazh Ndërkombëtar Tregtar dhe Investimesh (CICIA) të Fakultetit Juridik të Kolumbia. I njohur si “Arbitër i Certifikuar” dhe Ndërmjetës i Certifikuar, ai ka shërbyer si arbitër në mbi 70 konteste komplekse investitor-shtet dhe

tregtare në juridiksione dhe industri të shumta, duke vepruar shpesh si ekspert në arbitrazhin ndërkombëtar dhe çështjet e së drejtës ndërkombëtare

publike, dhe ka kontribuar në formësimin e standardeve globale të arbitrazhit. Ai është ligjërues i Drejtësisë në Universitetin e Kolumbias, profesor i asociuar në Fordham dhe Drejtor i Lëndës mësimore CIArb–Lënda Gjithëpërfshirëse mbi Arbitrazhin Ndërkombëtar të Fakluteit Juridik të Kolumbias. Puna e Dr. Duggal përfshin mbi 60 botime, libra të shumtë — duke përfshirë *Evidence in Investment Arbitrage* (Oxford), *Parimet e Provave në të Drejtën Ndërkombëtare Publike* (Brill), dhe *Rishikimi (Juris) Pro-Arbitrazhit* — dhe më shumë se 400 angazhime si folës në të gjithë botën. Dr. Duggal këshillon gjithashtu Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë të OKB-së për Vendet më pak të zhvilluara, për LDC Programin e Mbështetjes së Investimeve, punon me iniciativat CLDP të Departamentit të Tregtisë të SHBA-së, ka kryer trajnime të gjera globale për qeveritë dhe institucionet dhe shërben në komitete të shumta këshillimore dhe drejtuese për organet ndërkombëtare të arbitrazhit. Ai vazhdimisht gjendet i renditur nga Lexology, Chambers Global, Chambers USA, Legal500 dhe Lawdragon. Puna e tij është njohur me çmime të shumta, duke përfshirë Çmimin Hind Rattan, Çmimin Smit-Lowenfeld, çmimin “Kampion për Ndryshim” nga ArbitralWomen, çmimet “40 nën 40 Rising Star” të Legal Era dhe Praktikuesi i Vitit në fushën e Zgjidhjes së Kontesteve — të Americas and Global. Ai ka diploma nga Universiteti i Mumbait (Medalja Universitare), Universiteti i Oksfordit (DHL-Times of India Scholar), NYU (Hauser Global Scholar) dhe Leiden (Çmimi Akademik CEPANI), aktualisht po ndjek një diplomë në SJD në Fakultetin Juridik të Harvardit dhe është i pranuar të ushtrojë profesionin në Nju Jork, Distriktin e Kolumbias, Angli dhe Uells, si dhe Indi.



Dr. Emad Husein është një arbitër ndërkombëtar, ndërmjetësues i akredituar (CEDR, SIMI dhe IMI) dhe një akademik i zellshëm. Ai është Zëvendëspresident i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Qendrës së Arbitrazhit të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik (OIC-AC) dhe Këshilltar i Lartë për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut, në Akademinë Ndërkombëtare të Zgjidhjes së Kontesteve të Singaporit (SIDRA). Ai është gjithashtu një ligjërues i Asociuar në Universitetin e Newcastle. Ai është i punësuar si arbitër me disa institucione ndërkombëtare arbitrazhi, duke përfshirë ICC, DIAC, ADCCAC, arbitrateAD, HKIAC, QICCA, CRCICA, SCCA, AAA-ICDR, LCICA dhe SIAC. Ai është gjithashtu një ndërmjetësues i emëruar me CAO në Bankën Botërore. Ai

është një anëtar fakulteti i miratuar (AFL) me CI Arb dhe ka trajnuar disa arbitra dhe ndërmjetësues në kuadër të rrugës së bursave në bashkëpunim me SCCA. Ai gjithashtu zhvillon trajnime të rregullta për ndërtimin e kapaciteteve në fushën e ASR-së për anëtarët e gjyqësorit në Arabinë Saudite, Marok dhe Irak, në partneritet me SCCA-në, Programin e Zhvillimit të së Drejtës Tregtare (CLDP SHBA) dhe UNCITRAL. Në këto kapacitete, ai drejton kërkimin mbi avancimin e ZAK-së në rajonin MENA. Për më tepër, ai është Këshilltar i Lartë në CIMAC dhe anëtar i bordeve këshillimore të LCIC, OIC-AC, InnovADR dhe Universitetit Britanik në Dubai. Ai ka një doktoraturë në arbitrazh tregtar ndërkombëtar nga SOAS, Universiteti i Londrës, Mbretëria e Bashkuar, një doktoraturë në Menaxhim nga ISM, SHBA; një LLM në arbitrazh ndërkombëtar nga Universiteti Queen Mary i Londrës, Mbretëria e Bashkuar, dhe një LLM në ndërmjetësim dhe zgjidhje të kontesteve tregtare ndërkombëtare nga Universiteti i Newcastle, Mbretëria e Bashkuar.



Ivan Filippov është një avokat i zgjidhjes së kontesteve ndërkombëtare. Ai ka përvojë të gjerë në këshillimin e shteteve, subjekteve shtetërore, korporatave private dhe individëve për kontest komplekse. Praktika e Ivanit përfshin një gamë të gjerë industrish, me një fokus të veçantë në naftë dhe gaz, miniera, ndërtim, transport dhe shërbime financiare. Ai ka vepruar në çështje që përfshijnë klientë dhe projekte në të gjithë Amerikën Latine, Azinë Jugore dhe Juglindore, Azinë Qendrore,

Evropën Lindore dhe Lindjen e Mesme. Ivani ka leje të ushtrisë profesionin në Angli dhe Uells. Ai ka diploma në të drejtën ruse dhe ndërkombëtare nga Universiteti MGIMO dhe në zgjidhjen e kontesteve ndërkombëtare nga Universiteti Queen Mary i Londrës. Ai gjithashtu diplomoi në studimet e tij për drejtësi në Universitetin e Drejtësisë dhe BPP.



Rebecca Price është Drejtoreshë e Programit të Zgjidhjes Alternative të Kontesteve (ZAK) në Gjykatën e Qarkut të SHBA-së për Qarkun Jugor të Nju Jorkut. Përpara kësaj pozite, ajo drejtoi Klinikën e Ndërmjetësimit në Fakultetin Juridik të Bruklinit, ishte Avokate Mbikëqyrëse në Klinikën e Ndërmjetësimit në Fakultetin Juridik të CUNY dhe ligjëroi për ZAK-në në Shkollën e Studimeve Profesionale të Vazhdueshme të Universitetit të Nju Jorkut. Rebecca ka dhënë gjithashtu lëndët

puna e avokatisë/shkrim ligjor, intervistimi dhe këshillim në Fakultetin Juridik Cardozo dhe ka shërbyer si avokate mbikëqyrëse në Programin e Drejtësisë Ekonomike në Fakultetin Juridik të CUNY. Rebecca është ish-Koordinatore e Programeve të Arsimit Special/Ndërhyrjes së Hershme dhe Ndërmjetësimit ACCES VR për Programin e Ndërmjetësimit Safe Horizon (tani Instituti i Paqes i Nju Jorkut). Përpara se të përqendrohej te ZAK-ja, Rebecca ishte Ndihmëse Drejtoreshë e 'Visual AIDS', krijoi dhe mbikëqyri Projektin e Shëndetit Mendor të Fëmijëve në 'New York Lawyers for the Public Interest' dhe ishte Avokate e Lartë në Njësinë e Çështjeve Speciale Gjyqësore dhe të Ankesave të Shërbimit Ligjor të Higjienës Mendore. Rebecca është e certifikuar si Trajnere për nivelin Fillestar të Ndërmjetësimit për Programin e Qendrave të Zgjidhjes së Kontesteve Komunitare të Sistemit të Unifikuar Gjyqësor të Shtetit të Nju Jorkut. Rebecca aktualisht jep mësim mbi Anketën e ZAK-së në Shkollën e Drejtësisë të Universitetit të Nju Jorkut dhe është një folëse dhe trajnere e shpeshtë rreth ndërmjetësimit, zgjidhjes së konflikteve dhe komunikimit. Në pranverën e vitit 2023, ajo u emërua ligjeruese e Drejtësisë në Fakultetin Juridik të Kolumbias, duke mbikëqyrur programet klinike të ndërmjetësimit për atë semestër. Rebecca u nderua në vitin 2017 për Lidërsip të Shquar si pjesë e Çmimeve të Ekselencës Profesionale të New York Law Journal, u shpall Kampione e Vijës së Parë nga Shoqata për Zgjidhjen e Konflikteve të Nju Jorkut të Madh për Ditën e Zgjidhjes së Ndërmjetësimit 2019 dhe u vlerësua me çmimin Charles Newman nga Shoqata e Avokatëve të Shtetit të Nju Jorkut në vitin 2025.



Jeremy K. Sharpe është një arbitër ndërkombëtar; Anëtar i Bordit të Regjistrit të Dëmeve të Kombeve të Bashkuara (UNRoD), ligjerues i Drejtësisë dhe Bashkëpunëtor i Lartë në Fakultetin Juridik të Kolumbias, dhe redaktor i ICSID Review — Foreign Investment Law Journal. Më parë, ai ishte partner në praktikat e arbitrazhit ndërkombëtar dhe të së drejtës publike ndërkombëtare të Shearman & Sterling në Londër dhe Paris, Shef i Arbitrazhit të Investimeve në Zyrën e Këshilltarit Ligjor në Departamentin e Shtetit të SHBA-së, Këshilltar Ligjor në Ambasadën e SHBA-së në Bagdad, Avokat-Këshilltar në Zyrën e Çështjeve Afrikane dhe të Lindjes së Afërt dhe në Zyrën e Kërkesave Ndërkombëtare dhe Kontesteve të Investimeve të Departamentit të Shtetit, dhe nëpunës ligjor në Tribunalin e Kërkesave Iran-Shtetet e Bashkuara në *Hagë*.